

PLANI VENDOR PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE NË BASHKINË SHIJAK



Të nderuar banorë të Bashkisë Shijak,

Me kënaqësi dua të prezantoj përpara jush Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane për Bashkinë Shijak, dokument ky me vlera tepër të rëndësishme për 5 vitet e ardhshme. Nevoja e këtij plani erdhi si rezultat i prioriteteve të identifikuara nga vetë ju përgjatë 2015 në planifikimin për Zonat Funktionale. Së bashku me stafin tim e jetësuam këtë prioritet përgjatë periudhës shkurt – dhjetor 2016. Me mbështetjen e programit të decentralizimit dhe zhvillimit lokal (dldp) dhe ekspertizën e ofruar u arrit që jo vetëm të hidheshin piketat e planifikimit për vitet në vijim, por edhe u mundësua investimi në infrastrukturën bazë, kontenierë të llojeve dhe madhësive të ndryshme, të cilat do të përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e ofrimit të shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin e Bashkisë Shijak.

Procesi i hartimit të këtij plani ishte në të njëjtën kohë dhe një mundësi e mire për rritjen e kapaciteteve të stafit në analizën e problemit, identifikimin e mangësive dhe formulimin e vizionit në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha grupet e interesit që veprojnë në territorin tonë, por edhe në shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave pozitive edhe me njësi të tjera të qeverisjes vendore.

Shpreh gadishmërinë e administratës së bashkisë për t'u angazhuar në monitorimin dhe zbatimin e plotë të aktiviteteve dhe detyrave të identifikuara në këtë plan dhe në cilësinë e kryetarit do të bëjë përpjekjet e mia maksimale për të siguruar përfshirjen dhe kontributin e komunitetit për një Shijak të Pastër!

Së fundmi, dua të falenderoj të gjithë ata që bënë të mundur përgatitjen e këtij dokumenti dhe i ftoj që së bashku ta jetësojme atë.

Kryetari

Ardian Kokomani

Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në Bashkinë Shijak

Ky studim është përgatitur nga organizata Milieukontakt Shqipëri me mbështetjen e programit dldp e Intercooperation përmes fondeve të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim përgjatë periudhës Shkurt – Dhjetor 2016.

www.milieukontakt.org

© Gjithë të drejtat janë të rezervuara. Materiali në këtë studim mund të citohet lirisht, pasi të sigurohet autorësia. Çdo përdorim tjetër komercial ose për qëllime të tjera përfituese duhet të marri aprovimin paraprak nga Milieukontakt Shqipëri, dhe dldp.

Ekipi që përgatiti Planin Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane për Bashkinë Shijak përbëhej nga Valbona Mazreku, Lindita Oshafi, Rrezearta Ago, Andrian Vaso dhe Arion Sauku në bashkëpunim me grupin e punës të koordinuar nga Ervis Xhafa

Milieukontakt Shqipëri (MiA) pjesë e rrjetit Milieukontakt International, ka më shumë se 16 vjet eksperiencë me organizatat e shoqërisë civile në fushën e mjedisit, natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm si dhe me autoritetet vendore që mbulojnë këto çështje.

Në të gjitha programet e zbatuara tre janë shtyllat kryesore: ngritja e kapaciteteve, përfshirja e publikut dhe zgjidhja e problemeve mjedisore. Strategjia e Milieukontaktit bazohet në zhvillimin e dialogut dhe partneritetit mes gjithë aktorëve kyç të fushës. Ne ofrojmë trajnime, këshillime, mbështetje për organizatat. Ne kemi stimuluar dhe mbështetur përfshirjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes qytetare në procesin e vendimmarrjes. Ne i ndërlikojmë këto procese me zgjidhje konkrete të problemeve mjedisore.

Ekspertiza e MiA përfshin jo vetëm mbështetjen e proceseve nga poshtë lart por edhe ekspertizën në një numër të madh të çështjeve mjedisore dhe kuadrit ligjor përkatës me fokus të veçantë në grupet vulnerabël.

SHKURTIMET

| | |
|---------|---|
| DLDP | - Programi i Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal, |
| DPTSHIP | - Drejtoria e planifikimit të territorit shërbimeve dhe infrastrukturës publike |
| EZ | - Ekipi i zbatimit |
| GP | - Grupi i punes |
| MBZHRAU | - Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave |
| MEI | - Ministria e Energjisë dhe Industrisë |
| MF | - Ministria e Financave |
| MIA | - Milieukontakt International Shqipëri |
| MM | - Ministria e Mjedisit |
| MSH | - Ministria e Shëndetësisë |
| MTI | - Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës |
| MZHU | - Ministria e Zhvillimit Urban |
| NJA | - Njësia Administrative |
| PGM | - Pika të grumbullimit mbetjeve |
| PVMMU | - Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane |
| PKMM | - Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve |
| PRMM | - Plani Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve |
| RrC | - Rregjistri Civil |
| SKM | - Strategjia Kombëtare e Mbetjeve |
| VGM | - Vendi i grumbullimit të mbetjeve |
| ZAM | - Zona e Administrimit të Mbetjeve |

PERMBAJTJA:

| | |
|--|-----------|
| I. HYRJE | 6 |
| 1.1 Çfarë është plani lokal i menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake?..... | 6 |
| 1.2 Nevoja për hartimin e një plani lokal për mbetjet..... | 7 |
| II. KUADRI LIGJOR DHE POLITIKA KOMBËTARE E RAJONALE | 10 |
| 2.1 Përmbajtja e legjislacionit shqiptar..... | 10 |
| 2.2 Politikat kombëtare..... | 12 |
| 2.3 Politikat sipas planit rajonal..... | 13 |
| III. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME | 14 |
| 3.1 Profili i Bashkisë..... | 14 |
| 3.1.1 Pozita gjeografike e Bashkisë..... | 14 |
| 3.1.2 Demografia..... | 15 |
| 3.1.3 Bizneset dhe Institucionet..... | 17 |
| 3.1.4 Rrjeti rrugor..... | 18 |
| 3.1.5 Gjëndja e përgjithshme mjedisore..... | 18 |
| 3.2 Aspektet institucionale në menaxhimin e mbetjeve..... | 20 |
| 3.2.1 Organizimi në nivel qendror..... | 20 |
| 3.2.2 Organizimi në nivel rajonal..... | 21 |
| 3.2.3 Organizimi në nivel lokal..... | 22 |
| 3.2.4 Struktura e Bashkisë për mbetjet..... | 23 |
| 3.2.5 Rregulloret lokale dhe marrëveshjet për mbetjet..... | 25 |
| 3.3 Analiza e mbetjeve (prodhimi, përbërja)..... | 25 |
| 3.3.1 Shërbimet e mbetjeve..... | 27 |
| 3.3.2 Mbledhja dhe grumbullimi i mbetjeve..... | 28 |

| | |
|--|------------|
| 3.3.3 Pastrimi i rrugëve | 33 |
| 3.3.4 Depozitimi | 34 |
| 3.3.5 Riciklimi | 35 |
| 3.4 Ekonomia dhe financimi..... | 36 |
| 3.5 Performanca aktuale e administrimit të mbetjeve vendore..... | 43 |
| 3.5.1 Analiza e indikatorëve të performancës..... | 43 |
| 3.5.2 Vlerësimi i performancës përmes kënaqësisë së banorëve | 46 |
| 4 PLANIFIKIMI I ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE..... | 48 |
| 4.1 Vizioni..... | 48 |
| 4.2 Objektivat | 48 |
| 4.3 Objekti i Planit | 50 |
| 4.4 Evidentimi i alternativave për administrimin e mbetjeve..... | 52 |
| <u>V. PERSPEKTIVA FINANCIARE</u> | 90 |
| 5.1 Çështja e financimit dhe Strategjia e “mbulimit të kostos” | 90 |
| <u>VI. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL</u> | 96 |
| 6.1 Rregullore vendore | 96 |
| 6.2 Detyrimet dhe sanksione | 97 |
| 6.3 Licencimi mjedisor . | 99 |
| 6.4 Pjesëmarrja e sektorit privat | 100 |
| 6.5 Mbështetja politike | 101 |
| <u>VII. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK</u> | 103 |
| <u>VIII. PLAN VEPRIMI</u> | 106 |
| <u>IX. MONITORIMI</u> | 111 |

HYRJE

1.1 Çfarë është plani vendor i menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake?

Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane (PVMMU) është një dokument udhëzues dhe planifikues, i cili mundëson zbatimin e politikës kombëtare dhe rajonale të mbetjeve në nivel vendor, pra, mundëson orientimin strategjik të Bashkisë Shijak drejt një menaxhimi të integruar e të qëndrueshëm të mbetjeve.

Qëllimi i këtij plani është të parashtrojë një përfaqje të qartë të politikave të menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor, duke tentuar drejt një harmonizimi sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës të interesave dhe qëndrimeve të përbashkëta midis aktorëve të ndryshëm të interesuar në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve.

PVMMU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Më konkretisht, PVMMU përcakton mënyrën sipas të cilës do të manaxhohen mbetjet në Bashkinë Shijak dhe ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- ✓ Përputhshmëri me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj, duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve;
- ✓ Të ndërtojë dhe krahasojë skenarët specifikë të menaxhimit të mbetjeve për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Plani identifikon dhe rekomandon teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjesimin) final të mbetjeve;
- ✓ Të propozojë dhe rekomandojë hartimin e instrumentave të rëndësishëm institucionale, organizativ dhe financiar. Plani mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij;
- ✓ Të parashikojë koston operative të shërbimit dhe nevojat financiare për investime, duke përshkruar dhe argumentuar këto nevoja të lidhura me zbatimin e skemave efektive të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve;
- ✓ Të ndërtojë instrumentat për informimin, komunikimin dhe monitorimin e planit në përgjithësi dhe treguesve të shërbimit në vecanti.

Ky është plani i parë për menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Shijak.

1.2 Nevoja për hartimin e një plani lokal për mbetjet

Që prej vitit 1994 grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve lokale duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për menaxhimin e tyre dhe njëkohësisht duke u siguruar financimin nga qeverisja qendrore me anë të “granteve të pakushtëzuara”.

Bashkia Shijak tashmë përfshin një territor të zgjeruar me zona urbane dhe rurale, ku prezantohen sisteme menaxhimi të ndryshme dhe mungesë e shërbimit në të gjithë territorin. Sistemet kryesore për menaxhimin e mbetjeve kanë konsistuar vetëm në grumbullimin miks të mbetjeve të ngurta urbane dhe transportimin e tyre drejt vendeve të grumbullimit nën administrimin e vetë njësisive lokale, por mungojnë nismat dhe politikat vendore, për të zvogëluar dhe diferencuar sasinë e mbetjeve në burim.

Në përgjithësi, problematika në sektorin e mbetjeve lidhet ngushtë me mungesën e instrumenteve të duhura për menaxhimin mjedisor të tyre, mungesën e teknologjive dhe investimeve dhe kapacitetet e pamjaftueshme në burimet njerëzore dhe financiare. Për më tepër, përpjekjet e deritanishme për të adresuar këtë problematikë kanë qenë të pa koordinuara, të fragmentarizuara dhe joefikase.

Detyrimi dhe mbështetja ligjore për hartimin e planit

Politika kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, përfshin edhe detyrimin ligjor për hartimin e një plani të menaxhimit të mbetjeve urbane, (SKMM, PKMM, neni 12 i ligjit 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”), që çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve¹; (neni 4 i ligjit 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”), ku mbrojtja e mjedisit nga ndotja përbën përparësi dhe është e detyrueshme edhe nga bashkia².

Hartimi i Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve³, planit rajonal dhe lokal është një detyrim, që rrjedh nga direktivat e Këshillit të Evropës që Shqipëria duhet të zbatojë si një vend potencial për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian⁴.

¹ Bashkia përgatit planin vendor të menaxhimit të mbetjeve konform kërkesave të nenit 10 të ligjit 10463/2011.

² Sipas nenit 11 të ligjit 10431/2011, Bashkia brenda kompetencave të saj, harton planin përmes bashkëpunimit me personat fizikë dhe juridikë, privatë, me qëllim arritjen e objektivave për mbrojtjen e integruar të mjedisit.

³ Miratuar: VKM nr.175, datë 19.1.2011

⁴ Në qershor 2006 është firmosur Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit dhe rrjedhimisht Qeveria Shqiptare ka marrë një seri angazhimesh që janë përqendruar në arritjen e pranimit në BE.

Qarku i Durrësit ka përgatitur Planin Rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve (PRMM) që në vitin 2010⁵, por ai nuk është miratuar ende nga Këshilli i Qarkut, por objektivat e tij mund të shërbejnë si referencë për planin vendor të menaxhimit të mbetjeve.

Në kuadër të projektit “Hartimi i politikave vendore për Menaxhimin e Mbetjeve në Shijak”, Bashkia Shijak me mbështetjen e Programit të Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal (DLDP), dhe asistencën teknike të Milieukontakt Shqipëri (MiA), mundësoi hartimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve.

Procesi i hartimit, konsultimit dhe pjesëmarrjes

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në mirëqeverisjen vendore të bashkisë Shijak në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane duke ngritur kapacitetet e administratës dhe përmirësuar kuadrin rregullator të menaxhimit të mbetjeve urbane. Nëpërmjet këtij projekti përpjekjet tona më të mëdha u fokusuan në promovimin e përjasjes gjithëpërfshirëse, transparencës në hartimin e planit vendor si një ndër treguesit kryesor të mirëqeverisjes dhe demokracisë si dhe në dëshirën që procesi i hartimit të PVMMU në Shijak të mirëpritet si model edhe për pushtetet e tjera vendore në vend. Për herë të parë PVMMU është bazuar mbi indikatorë të performancës duke synuar monitorimin e cilësisë së shërbimit si edhe përfshirjen e publikut në proces.

Pjesë e rëndësishme e mbështetjes teknike ofruar bashkisë Shijak është edhe asistenca në ciklin e menaxhimit të projektit. Grupi i punës (GP) u mbështet që nga identifikimi i problematikës, vendosja e synimeve, shkrimi i projektit, realizimi i tij dhe në fund raportimi e transparenca e të gjithë procesit. Kjo do të shërbejë stafit bashkiak si guidë për procese të tjera vendore apo dhe monitorimin e zbatimit të PVMMU.

Procesi i hartimit të PVMMU në Bashkinë Shijak filloi në shkurt të 2016 dhe kaloi në 5 faza kryesore (figura 1).




Figura 1 Hapat e hartimit të planit

⁵ Hartimi i planit rajonal detyrohet nga neni 12 i ligjit 10463/2011.

Gjatë fazës së parë u ngrit GP që punoi në mënyrë aktive përgjatë gjithë procesit me përfaqësues nga administrata e Bashkisë Shijak dhe ekspertë të fushës. Vlerësimi i situatës ekzistuese për menaxhimin e mbetjeve urbane u realizua nëpërmjet hulumtimit dokumentor në Bashki dhe duke mbledhur perceptimin e publikut nëpërmjet plotësimit të 260 pyetësorëve në 4 njësitë administrative. U zhvilluan takime dhe komunikime të vazhdueshme me bashkinë dhe grupin vullnetar të të rinjve që u bashkua për plotësimin e pyetësorëve dhe zhvillimin e aktiviteteve të pastrimit.

Tre fazat e fundit të procesit u zhvilluan në një bashkëpunim të ngushtë midis ekspertëve dhe grupit të punës në administratën e bashkisë Shijak. Ata punuan dhe diskutuan sëbashku përgjatë takimeve të ndryshme, workshop-eve dhe trajnimeve, çdo element të planit. Sugjeruan dhe komentuan mbi draftet e përgatitura nga ekspertët dhe përfshinë në komunikime edhe aktorë të tjerë të interesuar sikundër është shoqëria civile dhe bizneset vendase.

Përgjatë gjithë procesit të hartimit të PVMMU në Bashkinë Shijak element shumë i rëndësishëm ishte hartimi dhe zbatimi i një strategjie të gjerë të pjesëmarrjes dhe informimit të publikut. Në këtë kuadër Bashkia Shijak dhe grupi i punës realizoi takime konsultuese me publikun në 4 njësitë administrative, realizoi aktivitete ndërgjegjësimi dhe demonstrimi me nxënësit e shkollave 9-vjeçare në çdo NJA, projektin pilot dhe promovim në sheshet kryesore të qytetit e punë kryesisht me mediat lokale. Komentet, sugjerimet dhe diskutimet e publikut të cilat u panë të përshtashme u morën në konsideratë në versionin përfundimtar të planit.

Përgjatë periudhës së përgatitjes së PVMMU, Bashkia Shijak ishte dhe pjesë e projektit për Hartimin e Planit Vendor të Shijakut si pjesë e zhvillimit Durrës-Shijak-Vorë. Objektivi kryesor i të këtij plani është për t'u përballur me problemet e territorit duke funksionalizuar pasuritë dhe të ofrojë një lexim të ri të territorit duke vënë në pah potencialet ekzistuese dhe duke i bërë ato forca lëvizëse për një vizion të ri, duke nxitur zhvillimin e ekonomisë, turizmit dhe bujqësisë. Midis dy projekteve ka patur konsultime në lidhje me shkëmbimin e informacionit por edhe me vizionin e zhvillimit të zonës në përgjithësi dhe menaxhimin e mbetjeve në veçanti.

II. KUADRI LIGJOR DHE POLITIKA KOMBËTARE E RAJONALE

2.1 Përmbajtja e legjislacionit shqiptar

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Mjedisit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit Shqiptar në përputhje me instrumentet legjislativë të BE.

Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore të punës së Ministrisë së Mjedisit. Ndarja e mbetjeve në burim, rritja e nivelit të riciklimit, forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e mbetjeve, asimilimi i plotë i hedhjes së mbetjeve në vendgrumbullime të pasigurta dhe asimilimi i plotë i djegies së mbetjeve, ndërtimi i landfillleve sipas standardeve të BE-së, sigurimi i lehtësive për mbetjet e rrezikshme, mjekësore ose ndërtimore, si dhe sigurimi i investimeve të reja për sa i përket ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve, janë disa nga prioritetet kryesore në këtë fushë.

LMIM adapton shumicën e direktivave, vendimet dhe rregulloret e BE-së, dhe parashikon prioritetet dhe hierarkinë për menaxhimin e mbetjeve që paraprihet nga: (1) parandalimi; (2) ripërdorim; (3) riciklimi; dhe (4) alternativa të tjera, si burim energjie; dhe (5) asgjësimin përfundimtar".

Ligji përcakton njëherazi dhe hierarkinë e autoriteteve në menaxhimin e mbetjeve, ndër të tjera pushteti vendor duhet të hartojë, miratojë dhe zbatojë PVMM.

Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve plotësohet me Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili në nenin 23, përcakton që mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, është tërësisht një përgjegjësi funksionale dhe organizative e bashkisë.

Ligji për koncesionet dhe PPP 125/2013 i miratuar nga Parlamenti më 25/04/2013, lehtëson njësitë e qeverisjes vendore në përfshirjen e kapitalit privat përmes zhvillimit të programeve të PPP.

Më poshtë pasqyrohet përmbledhja ligjore në fushën e mbetjeve:

| | |
|--------------------------------------|--|
| Ligjet kryesore në fushën e mbetjeve | Ligji nr.10463 , datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar me ligjin nr.156, date 10.1 2013. |
| | Ligji nr. 8094 , datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbetjeve". |
| | Ligji nr. 9537 , datë. 18.5.2006 "Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme", i azhornuar me ligjin nr.9890, datë 20.03.2008. |
| | VKM 117/2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje" |

Ligjet dytësore në fushën e mbetjeve

VKM 175/2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”

VKM 418/2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”

VKM 798/2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”

VKM 641/2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte”

VKM nr.687, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”.

VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

VKM nr.608, datë 17.09.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”.

VKM Nr. 866 datë 04.12. 2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”.

VKM Nr. 705 datë 10.10. 2012 “Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës”

VKM nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”

VKM Nr. 178, datë 06.03.2012 “Për Incinerimin e mbetjeve”

VKM nr. 177, datë 6.3.2012 “Për amballazhet dhe mbetjet e tyre, ndryshuar me vkm nr.52, date 5.2.2014”.

VKM Nr. 765 datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorur”

VKM nr. 333 datë 26.01.2011 “Për administrimin e venddepozitimeve rajonale të mbetjeve urbane”.

Rregullore nr. 1, datë 30.3.2007 “Për trajtimin e mbetjeve nga ndërtimet dhe shkatërrimet, nga krijimi, transporti dhe deri tek trajtimi përfundimtar”

Rregullore nr. 6, datë 30.11.2007 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”

Udhëzues nr. 6, datë 27.11.2007 “Për aprovimin e rregullave, përmbatjes

| | |
|--|---|
| | dhe afatave për skicimin e planeve për menaxhimin e mbetjeve” |
| Akte të tjera ligjore që lidhen direkt apo indirekt edhe me menaxhimin e mbetjeve | Ligji nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. |
| | Ligji nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncensionet”, të ndryshuar me ligjin 10157, date 15.10.2009 |
| | Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” |
| | VKM nr.247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”. |
| | Vendimi nr. 103, datë 31.03.2002 “Në lidhje me monitorimin mjedisor në Republikën e Shqipërisë” |
| | Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" |
| | Ligji nr.10081, datë 23.02.2009 “Mbi licensimin, autorizimin dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. |

Tabela 1. Përmbledhja e kuadrit ligjor shqiptar për mbetjet

2.2 Politikat kombëtare

SKMM përcakton drejtimin e politikës së Qeverisë Shqiptare për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve deri në vitin 2025 e ndarë në 3 faza operationale me nga 5 vjet secila.

Objektivat e kësaj strategjie janë:

- ✓ Deri në vitin 2015 synon riciklimin/kompostimin e 25% të mbetjeve bashkiake;
- ✓ Deri në vitin 2015 synon prezantimin e metodës së rikuperimit të plotë të kostos;
- ✓ Deri në vitin 2015 planifikimin dhe zbatimin e fushatave për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut në të gjitha zonat e mbetjeve;
- ✓ Deri në fund të vitit 2018 zbatimin e sistemit të grumbullimit të mbetjeve me tre kosha në të gjitha zonat e mbetjeve;
- ✓ Deri në vitin 2020 synon të ndalojë rritjen e mbetjeve bashkiake të prodhuara; Riciklimin/kompostimin 55% të mbetjeve bashkiake;
- ✓ Deri në vitin 2020 mbylljen dhe monitorimin e vendeve bashkiake të grumbullimit të mbetjeve në të gjitha zonat e mbetjeve;
- ✓ Deri në 2025: Rikuperimin e energjisë nga 15% e mbetjeve bashkiake. Reduktimin e mbetjeve bashkiake në lëndfill nga 90% që është aktualisht, në rreth 30%;

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (2015-2020) fokusohet midis të tjerave edhe në politikat e menaxhimit të integruar të mbetjeve me fokus përmbushjen e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, trajtimin e mbetjeve brenda këtyre standardeve dhe rritjen e ndërgjegjes sociale mbi efektet e dëmshme të mbetjeve në mjedis.

2.3 Politikat sipas planit rajonal

Ministri i Mjedisit ka nxjerrë udhëzimin “Për rregullat, përmbajtjen dhe afatet e aprovuara që janë përcaktuar për përgatitjen e planeve të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, nr. 6, datë 27.11. 2007. Sipas Udhëzimit, brenda një viti nga miratimi i Planit Kombëtar, duhet të hartohen planet rajonale në përputhje me parimet dhe objektivat e Planit Kombëtar (neni 8).

Planet rajonale përcaktojnë masat që duhen ndjekur nga autoritetet e qeverisë vendore për zbatimin e objektivave të PKMM të ngurta (neni 10).

Qarku i Durrësit ka përgatitur PRMM të tij, për periudhën deri në vitin 2025, por ai nuk është miratuar ende nga Këshilli i Qarkut. Projekt plani nuk përcakton në mënyrë të detajuar zgjidhjet teknologjike të nevojshme (impiantet ekzistuese, nevojat dhe specifikimet lokale, mundshmëria ekonomike dhe zhvillimet teknologjike). Megjithatë, ai ka përcaktuar këto objektiva të përgjithshme që lidhen me:

- reduktimin për njësi të gjenerimit të mbetjeve;
- grumbullimin e ndarë të mbetjeve, që do të finalizohet me riciklimin, deri në masën 45% të mbetjeve urbane të prodhuara;
- menaxhim të integruar të mbetjeve;
- një sasi shumë e kufizuar e mbetjeve do të asgjësohet në vendndodhje.

Objektivat e përcaktuara në këtë projekt PRMM⁶ për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në Rajonin e Durrësit janë:

- të bëhet grumbullim i diferencuar për 20% të mbetjeve brenda 4 viteve që nga miratimi i planit, pra deri në vitin 2015
- të bëhet grumbullim i diferencuar për 30% të mbetjeve brenda 7 viteve që nga miratimi i planit, pra deri në vitin 2018.
- të bëhet grumbullim i diferencuar për 50% të mbetjeve brenda 10 viteve që nga miratimi i Planit, pra deri në vitin 2021.

⁶ Referuar “Gjetjet dhe propozimet e studimit të dldp për Zonën Funktionale Shijak”

III. Përshkrimi i situatës së përgjithshme

3.1 Profili i Bashkisë

3.1.1 Pozita gjeografike e Bashkisë

Bashkia Shijak bën pjesë në Qarkun Durrës⁷ dhe përbëhet nga 4 Njësi Administrative: Shijak, Xhafzotaj, Maminas dhe Gjepalaj. Bashkia ka një qytet dhe 25 fshatra.

| Qendra e Bashkisë | Njësitë Administrative | Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre |
|-------------------|------------------------|--|
| Shijak | Shijak | Qyteti Shijak |
| | Xhafzotaj | 8 Fshatra: Xhafzotaj, Pjezë, Rreth, Sallmone, Koxhas, Borake, Guzaj, Vllazërimi; |
| | Maminas | 8 Fshatra: Maminas, Karreç, Vlashaj, Karpen, Bodinak, Metallë, Bilalas, Rubjek; |
| | Gjepalaj | 9 Fshatra: Gjepalaj, Hardhishtë, Çizmeli, Eminas i Vogël, Likesh, Kënetë, Shtrazë, Shahinaj, Shetel; |

Tabela 2. Ndarja sipas njësive administrative dhe përbërja në qytete dhe fshatra

Bashkia ka një pozitë mjaft të favorshme në komunikimin e afërt dhe të largët me qendrat e tjera urbane të vendit falë pozicionit në lidhje me rrjetin rrugor kombëtar dhe rajonal ndër më kryesoret në vend.

Bashkia shtrihet në një zonë fushore dhe kodrinore përgjatë lumit Erzen dhe kufizohet në veri, perëndim dhe jug nga Bashkia Durrës (vetëm 10 km larg qendrës së Durrësit) dhe në lindje nga Bashkitë Vorë dhe Tiranë (35 km larg Tiranës). Gjithë territori përshkohet nga lumi i Erzenit në një gjatësi prej 10 km.

Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Shijakut i organizuar në tre lagje, përkatësisht lagjia Popullore në pjesën më veriore të qytetit, lagjia Erzen në pjesën lindore të qytetit ku ka ekzistuar një liqen që me kalimin e kohës është zhdukur dhe në pjesën më të madhe të tij është zënë nga ndërtime informale dhe lagjia Kodra që pozicionohet në pjesën jugore të qytetit.

Bashkia ka një sipërfaqe prej 92.19 km², nga të cilat 3,5 km² e përbën qyteti i Shijakut.

Shijaku është një qytet i pasur me burime ujore, por furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujrave të zeza përfaqësojnë një nevojë emergjente për përmirësim. Në Bashkinë Shijak furnizohet me ujë afërsisht 35% e popullsisë, mesatarisht 1,5 orë në ditë. Me përjashtim të popullsisë në qytetin

⁷ Ligji nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

Shijak, në të cilën furnizohet me ujë rreth 76% e popullsisë, në njësitë e tjera furnizohet me ujë më pak se ¼ e popullsisë.

Ekonomia në vend është e orientuar kryesisht te tregtia, industria fasone dhe ajo përpunuese e prodhuese. Këto biznese operojnë kryesisht në fushën e shërbimeve, tregtisë dhe me pak në fushën e prodhimit dhe ndërtimit. Remitancat e emigrantëve kanë luajtur një rol të madh në zhvillimin e zonës, kryesisht në Shijak dhe Xhafzotaj.

Bujqësia është orientuar drejt produkteve me vlerë të lartë të shtuar si kultivimi i perimeve dhe foragjereve, mbarështimi i bagëtive dhe pemëtarisë. Megjithë potencialin e lartë të zhvillimit të këtij sektori, ai ka hasur probleme të shumta. Pra, një pjesë e tokës bujqësore ka mbetur e papunuar ndërsa shumë toka janë të rrezikuara nga lumi Erzen, të cilit i janë marrë sakaq pjesa më e madhe zhavorrit duke hequr për rrjedhojë edhe barrierën natyrore të tokave në të dy krahët e lumit.




Figura 2. Harta sipas Njësi Administrative, Bashkia Shijak

3.1.2 Demografia

Bashkia Shijak sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 27,861 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil të këtij viti ka 44,103 banorë. Ka densitet prej 302 banorë/km² sipas censurit dhe 478 banorë/km² sipas rregjistrimit civil.

Në të kaluarën e largët emigracioni i popullsisë boshnjake ndikoi në rritjen e popullsisë së zonës, ndërsa pas viteve 90-të, emigracioni i popullsisë shqiptare jashtë vendit ndikoi në ndryshimin e numrit dhe strukturën e forcave të punës. Duke parë ndryshimin e madh midis popullsisë rezidente dhe asaj prezente në rregjistrat civilë vihet re se zona është e prekur ndjeshëm nga emigracioni. Sot, pra në vitin 2016, numurohen rreth 44,676 banorë ose 12,439 familje. Pjesa më e madhe e popullsisë së bashkisë, rreth 70% është popullsi rurale. Vetëm Njja Xhafzotaj zë 41% të totalit të popullsisë ose 59% të popullsisë rurale.

Tabela 3. Popullsia për çdo NjA dhe rritja mesatare e popullsisë

| Popullsia | Zona | Census 2011 | Sipas Rregjistrimit Civil | | | |
|--------------------|--------|---------------|---------------------------|---------------|---------------|----------------------|
| | | | v.2014 | v.2015 | v.2016 | % mesatare e rritjes |
| Shijak | Urbane | 7,568 | 13,099 | 13,207 | 13,218 | 0.5% |
| Xhafzotaj | Rurale | 12,381 | 18,283 | 18,294 | 18,397 | 0.3% |
| Maminas | Rurale | 4,463 | 7,099 | 7,099 | 7,114 | 0.1% |
| Gjepalaj | Rurale | 3,449 | 5,768 | 5,868 | 5,947 | 1.5% |
| Totali | | 27,861 | 44,249 | 44,468 | 44,676 | 0.5% |
| Urbane | | 7,568 | 13,099 | 13,207 | 13,218 | 0.5% |
| Rurale | | 20,293 | 31,150 | 31,261 | 31,458 | 0.5% |
| % e rritjes | | | | 0.5% | 0.5% | 0.5% |

Burimi: Instat dhe Zyra e Gjëndjes Civile

Bashkia Shijak është një zonë që ka patur rritje të popullsisë gjatë dekadave të fundit si pasojë e migrimit nga zonat veri-lindore të Shqipërisë. Sipas Rregjistrimit Civil (RrC) rritja mesatare në tre vitet e fundit 2014-2016 është rreth 0.5%, dhe rritjen më të madhe të popullsisë e ka NjA Gjepalaj me 1.5%.

Ndër problemet kryesore ekonomike dhe sociale me të cilat përballet sot bashkia mund të përmendim papunësinë, janë rreth 2517 të papunë⁸. Gjithashtu janë rreth 177 familje që bashkia i trajton me ndihmë ekonomike, të cilët përbëjnë rreth 1.5% të totalit të familjeve. Ka gjithashtu dhe rreth 1,437 individë që janë me aftësi të kufizuara, invalidë, të verbër etj.

Tabela 4. Familjet me probleme ekonomike e aftësi të kufizuara, Bashkia Shijak

| NjA | Familje gjithsej | Familje me ndihmë ekonomike | | Me aftësi të kufizuara |
|-----------|------------------|-----------------------------|-------------------|------------------------|
| | | Numri | Në % ndaj totalit | Numri |
| Shijak | 3,703 | 88 | 2% | 586 |
| Xhafzotaj | 5,320 | 41 | 1% | 428 |
| Maminas | 1,900 | 11 | 1% | 189 |

⁸ Burimi: Census 2011; Të dhëna administrative nga qarku dhe NjQV, Statistika 2014

| | | | | |
|--------------|---------------|------------|-------------|--------------|
| Gjepalaj | 1,516 | 37 | 1% | 234 |
| Shuma | 12,439 | 177 | 1.5% | 1,437 |

Burimi: Zyra e Ndhmave Ekonomike të Bashkisë

3.1.3 Bizneset dhe Institucionet

Numërohen rreth 827 biznese dhe 61 institucione që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Shijak. 638 janë biznese të vegjël dhe përbëjnë 77% të totalit. Pjesa më e madhe e bizneseve të vegjël, rreth 81% janë përqëndruar në Shijak dhe Xhafzotaj. Ndërsa biznesi i madh është përqëndruar kryesisht në Xhafzotaj. Në këtë NjA veprojnë rreth 114 biznese ose 60% e totalit të bizneseve të mëdhenj. Mbi 25% e institucioneve veprojnë në Shijak,.

Të gjitha bizneseve dhe institucioneve iu është ofruar shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbetjeve, përveç atyre që kanë aktivitet në NjA Gjepalaj. Që nga shkurti 2016 ky shërbim i ofrohet të gjithë bizneseve dhe institucioneve të tjera publike.

Tabela 5. Numri i Bizneseve sipas natyrës dhe NjA, Bashkia Shijak

| Nr | Bizneset sipas xhiros dhe aktivitetit | Totali | Sipas Njësive Administrative | | | |
|----------|---|------------|------------------------------|------------|------------|-----------|
| | | | Shijak | Xhafzotaj | Maminas | Gjepalaj |
| A | Biznesi i Vogël | 638 | 250 | 267 | 109 | 12 |
| 1 | Njësi tregëtare për artikuj industrial | 148 | 52 | 85 | 11 | 0 |
| 2 | Njësi Shërbimi | 192 | 76 | 68 | 48 | 0 |
| 3 | Aktivitet Shëndetsor (stomatolog, farmaci) | 27 | 12 | 6 | 9 | 0 |
| 4 | Tregëtim artikuj ushqimorë, fruta perime | 114 | 39 | 46 | 22 | 7 |
| 5 | Bar, Restorant, Kafe, Piceri fast food | 90 | 30 | 38 | 19 | 3 |
| 6 | Pikë tregëtimi Karburant | 4 | 0 | 3 | 0 | 1 |
| 7 | Furra buke | 10 | 4 | 5 | 0 | 1 |
| 8 | Transport mallra ,udhëtarë | 53 | 37 | 16 | 0 | 0 |
| B | Biznesi i Madh | 189 | 40 | 114 | 32 | 3 |
| 1 | Fonderi, përpunim metale etj | 5 | 0 | 5 | 0 | 0 |
| 2 | Subjekte përpunim inerte ,beton etj | 7 | 0 | 7 | 0 | 0 |
| 3 | Shërbime, tregtim, magazinim, banka, farmaci, loja fati | 86 | 37 | 32 | 14 | 3 |

| | | | | | | |
|-----------|---------------------------------------|------------|------------|------------|------------|-----------|
| 4 | Fabrika përpunim, prodhim | 40 | 0 | 32 | 8 | 0 |
| 5 | Blegtori | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| 6 | Kompleks, hotel, restorant, karburant | 15 | 0 | 6 | 9 | 0 |
| 7 | Subjekte ndërtimi, fabrika | 5 | 0 | 4 | 1 | 0 |
| 8 | Shitje hekur, inerte, cimento | 7 | 1 | 6 | 0 | 0 |
| 9 | Përpunim plastike, letër, druri | 4 | 1 | 3 | 0 | 0 |
| 10 | Karburante | 19 | 1 | 18 | 0 | 0 |
| I | Totali Bizneseve | 827 | 290 | 381 | 141 | 15 |
| II | Institucionet | 61 | 15 | 18 | 11 | 17 |

Burimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashki, Shkurt 2016

3.1.4 Rrjeti rrugor

Rrugët e qytetit vlerësohen të jenë në nivelin mesatar. Gjithsej Bashkia Shijak ka një gjatësi rrugësh urbane prej 35 km, të cilat janë të asfaltuara dhe 128 km rruge rurale, ku 46 km janë të asfaltuara dhe një sipërfaqe prej 17500 m² trotuare.

Tabela 6. Rrjeti rrugor në Bashkinë Shijak

| NjA | Rrugë | | | Trotuare | | | Sheshe | |
|----------------|------------|----------------|-------------------------------|---------------|----------------|------------------------|----------------|-----------------------------|
| | Total | | Nga këto: të asfaltuara | Total | | Nga këto: me pllaka | Total | Nga këto: të shtruara |
| | km | m ² | | km | m ² | | m ² | |
| Shijak | 35 | 48,215 | 35 | 11,000 | | 2,275 | 2275 | |
| Xhafzotaj | 46 | 140,000 | 32 | 3,500 | 1.1 km | 3,000 | 3000 | |
| Maminas | 26 | 21,300 | | 3,000 | | 2,900 | 2900 | |
| Gjepalaj | 56 | 20,000 | 14 | - | | - | | |
| Bashkia | 163 | 229,515 | 81 | 17,500 | 1.1 | 8,175 | 8175 | |

Burimi: Bashkia Shijak

3.1.5 Gjëndja e përgjithshme mjedisore

Cilësia e lumit Erzen sipas raportit të gjendjes së mjedisit për vitin 2014 në pikën monitoruese të Sallomes rezulton me përmbajtje të lartë të amoniakut për shkak edhe të mungesës së

kanalizimeve apo shkarkimeve urbane të patrajtuara. Ndotja vjen si pasojë e ndikimit të shkarkimeve urbane dhe industriale. Përcjellshmëria elektrike është në vlera të larta gjë që tregon që ujrata e Erzenit janë nën ndikim të vazhdueshëm të shkarkimeve të lëngëta urbane dhe industriale.

Ndërhyrjet e shumta në Lumin Erzen kanë çuar në ngushtimin e shtratit të tij për shkak të erozioni fundor dhe shfrytëzimit të inerteve në disa pika të tij. Disa shtëpi banimi janë ndërtuar mbi kolektor duke e vështirësuar gjendjen. Ndërhyrjet për shfrytëzim inertesh, bashkë me hedhjen e mbetjeve nga familje dhe biznese në shtratin e Erzenit janë një nga faktorët që kanë çuar në përmbytjet 2-3 herë në vit dhe sidomos në vitin 2016. Ky është kthyer në një fenomen shqetësues kryesisht për banorët e lagjes Erzen në qytetin e Shijakut dhe fshatit Gjepalaj.

Furnizimi me ujë të pijshëm në disa fshatra bëhet me burime natyrore, (kroje dhe puse) dhe banorët përballen me probleme serioze të furnizimit me ujë dhe higjienës. Vetëm 35% e familjeve janë të lidhura me rrjetin e furnizimit me ujë, përkatësisht në Shijak 75%, në Maminas 25%, në Gjepalaj 16% dhe në Xhafzotaj 20%.

Mënyra më e përhapur për sistemimin e ujërave të zeza në fshatra është ajo me gropa septike individuale, mosfunksionimi i të cilave shpesh sjell rrjedhjen e tyre duke shkaktuar probleme me mjedisin. Pra, mungon sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza dhe të bardha.

Përgjatë rrugëve, sidomos në zonat rurale nuk gjenden kosha metalik dhe banorët e zonës i depozitojnë mbetjet në vende ilegale. Numurohen rreth 10 vende ilegale mbetjesh. Depozitimi i mbetjeve në fushat e improvizuara përbën një rrezik të mundshëm për shëndetin e njeriut, burimet natyrore (tokën, ujin, ajrin) si dhe për zhvillimin e turizmit.

Riciklimi i mbetjeve është në fazën fillestare, më shumë nga komuniteti rom jo i zonës dhe disa kolektorë të vegjël. Llojet kryesore që grumbullohen janë kanaçe, plastikë, letër, karton, plastmas dhe hekur. Pjesa më e madhe e mbetjeve të riciklueshme vjen nga mbetjet urbane dhe nga industria. Nuk ka impiant të kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme dhe të djegies së mbetjeve urbane (të pa riciklueshme) si dhe mbetjeve industrial për qëllime ngrohje/prodhim energjie. Në planin e zhvillimit vendor parashikohet një pikë bashkiake të grumbullimit të plehrave për kompostim në mbështetje të bujqësisë (plehra organike të kërkuara për prodhime organike me cilësi të lartë).

Pikat e dobëta në menaxhimin e mbetjeve lidhen kryesisht me moszbatimin e planeve në nivel rajonal dhe vendor dhe shkallën shumë të ulët të riciklimit. Vitet e fundit numri i popullsisë ka ardhur duke u rritur dhe bashkia në disa zona të qytetit përballen me pamundësinë për mbulimin me kontenierë, ndërsa në njësitë e tjera administrative ka mungesë kontenierësh. Edhe prania e mbetjeve jashtë kontenierëve, duke shkaktuar probleme në ndotjen e mjedisit, shkaktimin e erërave të rënda në zonën përreth ka nevojë të plotësohet me ndërgjegjësimin e banorëve dhe të bizneseve mbi problematikën e mbetjeve.

3.2 Aspektet institucionale në menaxhimin e mbetjeve




Figura 3. Skema e organizimit institucional në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor

3.2.1 Organizimi në nivel qendror

Aktorët kryesorë përgjegjës, në nivel kombëtar, në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë Ministria e Mjedisit (MM), Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU), Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI), Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave (MBZHRAU), si dhe Ministria e Financave (MF).

MM është institucioni i specializuar dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e politikës së menaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve dhe rregulloreve dhe zbatimin në nivel qendror me anë të dy autoriteteve të specializuara në varësi të saj: Inspektorati Mjedisor (IM) dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM).

MZHU zbaton politikat kombëtare dhe rajonale në planifikimin e territorit për depozitimin e mbetjeve të zonave urbane dhe rajonale përkatëse për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

MTI ka si mision të udhëheqë, të planifikojë, të koordinojë dhe të monitorojë aktivitetin e trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe mbetjeve të ndërtimit në të gjitha fazat e zhvillimit, si projektimi, zbatimi i punimeve dhe shfrytëzimi i lëndësve dhe impianteve të incenerimit të mbetjeve urbane.

MSH harton rregullore për menaxhimin e mbetjeve dhe zbaton rregulloren për mbetjet spitalore.

MEI është përgjegjëse për hartimin e rregulloreve për (i) Mbetjet industrial, (ii) Mbetjet minerale. Të dyja nuk janë hartuar ende; si dhe rehabilitimin e venddepozitimeve.

MBZHRAU është përgjegjëse për hartimin e rregullores për mbetjet bujqësore dhe shtazore. Rregullorja nuk është hartuar ende.

MF është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për taksat e ndryshme mjedisore. Deri tani janë paraqitur dy taksat e para mjedisore (taksa e gjelbër dhe taksa e ambalazhimit mbi pijet).

3.2.2 Organizimi në nivel rajonal

Inspektorati Mjedisor është përgjegjës për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor. Ai vendos penalitete për shkeljet administrative apo mund të pezullojë aktivitete që nuk janë në përputhje me legjislacionin mjedisor; informon rregullisht autoritetet lokale për gjendjen e mjedisit, aktet ligjore dhe projektet e miratuara; kontrollon regjistrin e ndotësve, rregulloret teknike dhe teknologjitë.

Agjencitë Rajonale të Mjedisit janë autoritete të specializuara për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel rajonal. Kanë përgjegjësi në miratimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve dhe japin, në bashkëpunim me autoritetet vendore, lejet mjedisore për impiantet lokale të mbetjeve apo aktivitete të tjera lokale.

Këshilli Kombëtar për Rregullimin e Territorit, miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit për objektet (si rrjedhë edhe për *landfill*-et) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

Inspektorati Sanitar Shtetëror ka për detyrë të kontrollojë dhe ndërmarrë veprime për të siguruar kushtet e nevojshme higjieno-sanitare për aktivitetet e ndryshme. Ai ka për detyrë të vendosë gjopa për probleme që lidhen me mospastrimin e zonave urbane apo kur grumbullimi dhe depozitimi janë jo të përshtatshëm dhe bëhen të rrezikshëm për popullsinë.

3.2.3 Organizimi në nivel lokal

Detyrat dhe përgjegjësitë: bazuar në ligjin nr. 139/2015, ligjin 8094/1996, dhe në ligjin nr. 9010/2003, NJQVtë janë përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit,

trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar. Bashkia përcakton:

- i. Strukturat bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban;
- ii. Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për menaxhimin e mbetjeve bashkiake në territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publikë apo privatë që t'i grumbullojnë ato;
- iii. Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë menaxhimi për mbetjet duke zbatuar rregulloret "tip" të miratuara nga ministrinë respektive;
- iv. Harton planet e menaxhimit të mbetjeve bashkiake në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje;
- v. Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
- vi. Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese.

Në përputhje me legjislacionin mjedisor për mbetjet, bashkitë kanë si detyrime si më poshtë:

- i. Të kujdesen për higjienën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo atyre të braktisura;
- ii. Të zbatojnë projekte dhe investime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen e mbetjeve;
- iii. Të monitorojnë dhe inspektojnë të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në depozitimin përfundimtar në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualët lokale;
- iv. Të inspektojnë "zotëruesin e mbetjeve" për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standardeve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh;
- v. Të bashkëpunojë me ARM për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e menaxhimit të mbetjeve;

- vi. Të bashkëpunojë me Inspektoratin Mjedisor, ARM si dhe inspektoriate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal.
- vii. Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoritet kontraktues për koncesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe, si rrjedhojë, edhe për koncesionin e projekteve mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

3.2.4 Struktura e Bashkisë për mbetjet


Diagrama më poshtë ilustron strukturën e bashkisë në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, duke filluar nga përfaqësuesit në nivel Këshilli Bashkiak, Kryetar Bashkie, drejtuesit e shërbimeve dhe njësitë administrative.

Këshilli Bashkiak: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave bashkiake për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për mbetjet e rrezikshme (Ligjit 9537).

Policia e bashkiake: ushtron funksionin e saj bazuar në ligjin nr. 8224/1997, është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

Sipas organogramës së mëposhtme bashkia ka në strukturën e saj Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike, ku përfshihet sektori i Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike me 16 punonjës. Sektori mbulon disa shërbime publike si pastrimi, gjelbërimi, varrezat, dekori, mirëmbajtje e institucioneve publike dhe rrugët dhe ka në përbërje 1 përgjegjës sektori, një specialiste, një supervizore të shërbimit të pastrimit, gjelbërimit dhe varrezeve, 13 punëtorë mirëmbajtje dhe pritet të rekrutohet një inxhinier ndërtimi. Dy prej të cilëve janë të lidhur drejtpërdrejt ose pjesërisht me menaxhimin e mbetjeve urbane: një specialist dhe supervizori. Pra bashkia nuk ka strukturë të ndarë të administrimit të mbetjeve të ngurta, ndaj krijimi i një sektori të veçantë mundet dhe duhet vlerësuar. Sektori i Shërbimeve koordinon me NjA nëpërmjet administratorëve, të cilët monitorojnë direkt në terren ofrimin e shërbimit të mbetjeve urbane. Por edhe NjA kanë kapacitete njerëzore të limituara, të pa-trajnuara për ofrimin e një shërbimi sipas standardeve, për monitorimin dhe parandalimin e ndotjes urbane nga mbetjet.

Figura 4 Organograma e Bashkisë



Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Bashkia Shijak

3.2.5 Rregulloret lokale dhe marrëveshjet për mbetjet

Ligji i instrukton qeveritë vendore të hartojnë dhe miratojnë kuadrin e nevojshëm rregullator lokal. Kuadri lokal përfshin rregulloret e ndryshme që përcaktojnë proceset e menaxhimit të mbetjeve dhe objektin, përshkruajnë indikatorët, specifikojnë kriteret dhe instruktojnë strukturat lokale në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve si dhe në zgjidhjen e problemeve që mund të dalin. Kuadri rregullator lokal duhet të përfshijë:

- **Rregulloren bashkiake për menaxhimin e mbetjeve:** e cila përcakton metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit të qytetit dhe menaxhimin të mbetjeve brenda territorit administrativ të bashkisë, të hartojë procedura për ankesat e banorëve, gjithashtu edhe kapitullin për aplikimin e sanksioneve. Rregullorja duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak. Bashkia Shijak nuk ka një rregullore të tillë.
- **Rregulloren bashkiake për tarifën e mbetjeve:** ka për qëllim të krijojë një sistem efektiv për mbulimin e kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Rregullorja e tarifave të mbetjeve përfaqëson një politikë bashkiake afatgjatë për mbulimin e kostos, nivelin e tarifave dhe sistemin e mbledhjes së tyre dhe vendos rregulla specifike për autoritetet lokale si dhe për komunitetin lokal dhe biznesin. Deri më sot Bashkia Shijak nuk ka hartuar një rregullore të tillë.
- **Formën e menaxhimit të shërbimit:** e përcakton Këshilli i Bashkisë. Sido që të ofrohet shërbimi, nga kompani private apo institucion publik, bashkia ka përgjegjësinë për mbledhjen dhe depozitimin e mbetjeve të ngurta, pra garanton që ky shërbim ofrohet dhe përmbush standardet e kërkuara për besueshmërinë, efikasitetin, marrëdhëniet me publikun dhe mbrojtjen e mjedisit. Bashkia Shijak deri në fund të vitit 2015 përdorte forma të ndryshme, si më poshtë:
 - NjA Shijak, pra qendra e Bashkisë dhe NjA Xhafzotaj, ku banojnë rreth 70% e popullsisë, e realizojnë shërbimin nëpërmjet kontratave të sipërmarrjes. Ofrimi i shërbimit konsiston në: pastrimin e rrugëve të qytetit, shesheve, mbledhjen dhe transportin e mbetjeve.
 - NjA Maminas ofronte shërbimin vetë, pra me një strukturë punëtoresh dhe mjetesh në vartësi të sektorit të shërbimeve publike (përdorej një kamion i hapur dhe grumbullimi i mbetjeve bëhej me qese).
 - NjA Gjepalaj nuk e ofronte fare këtë shërbim dhe nuk kishte as kontroll mbi territorin, ku mbetjet nga familjet dhe bizneset hidheshin në vende ilegale.

3.3 Analiza e mbetjeve (prodhimi, përbërja)

Një nga pengesat kryesore për zhvillimin e çdo plani menaxhimi mbetjesh në Shqipëri është mungesa e të dhënave të besueshme statistikore për popullsinë dhe prodhimin e mbetjeve. Nuk ka të dhëna të matura për normën e gjenerimit të mbetjeve dhe sasinë e gjeneruar nga çdo subjekt. Aktualisht përdoren normat e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve (SKMM, 0.7 kg/banor/ditë në zonën urbane dhe 0.4 kg/banor/ditë për zonën rurale).

Me qëllim parashikimin e administrimit të mbetjeve në të ardhmen në Bashkinë Shijak, është e rëndësishme të llogarisim prodhimin aktual të mbetjeve si dhe të parashikojmë zhvillimin për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Këto të dhëna janë shumë të rëndësishme për hartimin e këtij plani dhe mundësojnë llogaritjen e situatës aktuale dhe përcaktimin e objektivave si dhe procesin e monitorimit.

Prodhimi i mbetjeve në nivel rajonal: Sipas drafteve përfundimtare të SKM dhe PKM, Bashkia Shijak është pjesë e Zonës së Mbetjeve të Qarkut Durrës.

Prodhimi i mbetjeve në nivel vendor: Të dhënat zyrtare nga Bashkia Shijak në lidhje me prodhimin e mbetjeve janë ende të debatueshme dhe bazohen vetëm në vlerësime të përgjithshme duke u bazuar në numrin e popullsisë të qytetit, kapacitetet e kontenerëve që makina teknologjike mbledh gjatë ditës, sasia e mbetjeve të riciklueshme që mund të grumbullohen. Makina që transporton mbetjet për në vend depozitim nuk peshohet dhe nuk është bërë asnjë përpjekje për të numëruar ngarkesat e makinave dhe për të llogaritur vëllimin e mbetjeve në vend depozitim. Sipas të dhënave nga bashkia, sasia mesatare e mbetjeve të prodhuara që do të grumbullohen dhe transportohen gjatë vitit 2016 është rreth 7,939 ton mbetje/vit dhe nuk përfshin mbetjet nga ndërtimet. Sipas bashkisë në të gjithë zonën janë rreth 100-120 ton mbeturina të krijuara në kohë. Nga studimet paraprake të bëra në terren rezulton se trendi i mbeturinave inerte të krijuara nga ndërtimet është në rënie për shkak të bllokimit të lejeve të ndërtimit, megjithatë me zhblokimin e tyre mendohet se mbeturinat inerte do vijnë gjithmonë në rritje dhe do të krijojnë mjaft probleme në zonë.

Tabela 7. Prodhimi i mbetjeve në nivel vendor

| Viti 2016 (Sipas Shërbimit aktual që ofrohet) | | | | | | |
|---|------------------|--------------------------------|--------------------------------|----------------------------------|---|--|
| NJA | Numri i banorëve | Mbetje që grumbullohen kg/ditë | Mbetje që grumbullohen ton/vit | Prodhimi për banor kg/banor/ditë | Mbetje ndërtimi që grumbullohen ton/vit | Prodhimi mbetjeve ndërtimit për banor kg/banor/vit |
| Shijak | 13,218 | 9,245 | 3,374 | 0.70 | | |
| Xhafzotaj | 18,397 | 7,318 | 2,671 | 0.40 | | |
| Maminas | 7,114 | 2,840 | 1,037 | 0.40 | | |
| Gjepalaj | 5,947 | 2,347 | 857 | 0.39 | | |
| Totali | 44,676 | 21,750 | 7,939 | 0.49 | | |

Sipas tabelës së mësipërme vihet re që bashkia nuk ka bërë matje në terren për të përcaktuar normën e gjenerimit të mbetjeve për banor, por i është referuar normave sipas PKMM, ndërsa për mbetjet nga ndërtimet nuk llogariten fare.

3.3.1 Shërbimet e mbetjeve

Shërbimet e mbetjeve përfshijnë të gjitha aktivitetet lokale që lidhen me ofrimin e shërbimit të pastrimit apo elementë të tjerë të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shijak. Ky seksion merr në konsideratë dhe përshkruan të gjithë shërbimet e pastrimit, infrastrukturën aktuale për kryerjen e shërbimeve nga sistemi aktual të kontenerëve deri në impiantet e grumbullimit apo depozitimit përfundimtar të mbetjeve, zonën e shërbimit, volumet e punës dhe frekuencat e shërbimeve, rrymat e mbetjeve që administrojnë sot bashkia dhe konsumatorëve të cilëve u shërbehet. Gjithashtu në këtë seksion identifikohen dhe vlerësohen të gjitha problematikat aktuale të sistemit të menaxhimit të mbetjeve apo shërbimeve të veçanta, si dhe jepen arsyet apo faktorët kryesorë që impaktojnë këtë gjëndje.

Si bazë të dhënash shërbeu informacioni i marrë nga Bashkia si dhe nga grupi i punës i ngritur në funksion të këtij plani⁹, dokumentacioni i vënë në dispozicion¹⁰, dhe informacioni i grumbulluar gjatë vizitave në terren.




Figura 5. Skicat për çdo NjA nga diskutimet me grupin e punës

Foto nga takimet me grupin e punës



Shërbimet e mbetjeve përfshijnë:

- Shërbimin ditor të pastrimit të rrugëve (fshirje dhe larje e rrugëve kryesore dhe 2 shesheve (vetëm në 5 muaj);

⁹ Konkluzionet nga seminari me me grupin e punës nga cdo NjA e Bashkisë Shijak në 2 tetor 2015.

¹⁰ Kontratat dhe veprimet për organizimin e shërbimit të Pastrimit, Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë (2008-2015), Studimi “Gjetjet dhe propozimet e studimit të dldp për Zonën Funktionale Shijak”, etj.

- Shërbimin e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane (nga pikat e grumbullimit të tyre si dhe rreth tyre) për në landfillin e Porto Romanos;
- Shërbimin e grumbullimit të mbetjeve voluminoze;

Në fundin e vitit 2015 si në rastin kur shërbimi ishte kontraktuar nga NjA me firma private dhe kur ofrohej nga NjA vetë, ai përfshinte jo vetëm shërbimet e mësipërme, por edhe shërbime të tjera si gjelbërimi, mirëmbajtja e varrezave dhe në ndonjë rast edhe mirëmbajtja e rrugëve. Stafet menaxhuese që e ofronin vetë shërbimin e kishin të vështirë të veçonin aktivitetet dhe kostot e lidhura vetëm me shërbimin e pastrimit dhe largimit të mbetjeve.

NjA Shijak, për shkak të përfundimit të afatit të kontratës në fund të vitit 2015, ka lidhur për vitin 2016 kontratën e re me firmën Albgarden shpk për të gjithë territorin e bashkisë për një periudhë 1 vjeçare, deri në hartimin e planit të menaxhimit të mbetjeve 2017-2021.

Shërbimet e pastrimit shtrihen brenda kufijve administrativë të Bashkisë.

Tabela 8. Ofruesit e shërbimit

| Ofruesit e Shërbimit 2015-2016 | | | | | |
|--------------------------------|-----------|-------------------|---------------------|------------------|---|
| | NjA | Viti 2015 | | Viti 2016 | |
| | | Ofruesit | Periudha | Ofruesit | Periudha |
| 1 | Shijak | “Enzo 96”shpk | Deri 04.02.2016 | “Albgarden”shpk | 04.02.2016-03.02.2017 |
| 2 | Xhafzotaj | “Albgarden”shpk | 06.2011- 07.2016 | “Albgarden”shpk | Pas 07/2016 futet në skemën e NjA Shijak |
| 3 | Maminas | Vetë NjA | | “Albgarden” shpk | 04.02.2016-03.02.2017 |
| 4 | Gjepalaj | Nuk ofron shërbim | | “Albgarden” shpk | 04.02.2016-03.02.2017 |

Burimi: Bashkia Shijak

3.3.2 Mbledhja dhe grumbullimi i mbetjeve urbane

Shërbimi i mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve konsiston në mbledhjen e mbetjeve urbane të depozituara nga qytetarët, bizneset dhe institucionet brenda kontenierëve publik si dhe rreth tyre, dezinfektimi i kontenierëve dhe vendit përreth me gëlqere dhe klor, transportimi i mbetjeve urbane me makinën teknologjike deri në pikën përfundimtare të depozitimit. Ky shërbim që ofrohet gjatë gjithë vitit 2015 përfshin tre NjA (rreth 84%)¹¹, kryesisht në akset kryesorë të

¹¹ Sipas të dhënave të bashkisë, viti 2015.

rrugëve ku janë të pozicionuar pjesa më e madhe e kontenierëve. Ndërsa në vitin 2016 shërbimi mbulon të gjitha familjet, bizneset dhe institucionet në të 4 NJA.

| Mbulimi me shërbimin e pastrimit dhe largimit të mbetjeve, viti 2015 – 2016 | | | | | | | | | | | | | |
|---|----------------|-----------------------|---------------|--------------|-------------|-----------------------|------------|--------------|-------------|----------------------------|-----------|--------------|-------------|
| N r. | NjA | Familje | | | | Biznese | | | | Institucione | | | |
| | | Familje që përfitojnë | | % e mbulimit | | Biznese që përfitojnë | | % e mbulimit | | Institucione që përfitojnë | | % e mbulimit | |
| | | v.'15 | v.'16 | v.'15 | v.'16 | v.'15 | v.'16 | v.'15 | v.'16 | v.'15 | v.'16 | v.'15 | v.'16 |
| 1 | Shijak | 3,700 | 3,703 | 100% | 100% | 290 | 290 | 100% | 100% | 15 | 15 | 100% | 100% |
| 2 | Xhafzotaj | 4,761 | 5,320 | 90% | 100% | 343 | 381 | 90% | 100% | 16 | 18 | 90% | 100% |
| 3 | Maminas | 1,896 | 1,900 | 100% | 100% | 141 | 141 | 100% | 100% | 11 | 11 | 100% | 100% |
| 4 | Gjepalaj | 0 | 1,516 | 0% | 100% | 0 | 15 | 0% | 100% | 0 | 17 | 0% | 100% |
| | Bashkia | 10,357 | 12,439 | 84% | 100% | 774 | 827 | 94% | 100% | 42 | 61 | 69% | 100% |

Tabela 9. Mbulimi me shërbimin e largimit të mbetjeve


Sistemi aktual i pikave të grumbullimit të mbetjeve (PGM) përbëhet nga kontenierë metalik me rrota me volum 1.1 m³, të pozicionuar në anë të rrugëve në pika të përbashkëta publike miratuara paraprakisht nga autoritet bashkiake. Largësitë mesatare midis PGM variojnë nga çdo 200 m në zonën e qendrës ku është e përqëndruar pjesa më e madhe e bizneseve, institucioneve dhe banorëve si dhe zonat e tjera të qytetit kryesisht zona banimi në 1 km.

Mënyra kryesore e grumbullimit të mbetjeve realizohet nëpërmjet qeseve dhe vetëm në Shijak qendër mbetjet grumbullohen në rreth 26 kontenierë të cilët janë në gjendje të keqe.

Është e rëndësishme të përmendet që Gjepalaj nuk ka qenë e mbuluar me PGM duke sjellë që qytetarët t'i hedhin mbetjet në pika informale, të paautorizuara. Këtu grumbullohen si mbetjet urbane ashtu dhe inerte dhe voluminoze që nuk mblidhen për ditë me radhë, duke u kthyer në problematikë të ndotjes urbane, si nga ana vizive ashtu dhe në lidhje me shëndetin publik dhe mjedisin përreth. Që nga shkurti 2016 janë vendosur 6 kontenierë në disa rrugë kryesore të Gjepalaj.

Figura e mëposhtme tregon sistemin aktual të shpërndarjes së PGM.

Figura 6 Pikat e grumbullimit të mbetjeve në Shijak



Njëkohësisht ekzistojnë dhe pika individuale ku kontenierët janë të pozicionuar brenda territoreve të institucioneve, shkollave apo subjekteve private/familjeve.




Figura 7. Pika individuale të grumbullimit të mbetjeve

Gjendja aktuale PGM nuk paraqitet e pranueshme, ekzistojnë një seri problemesh si për sa i përket dëmtimeve (100% e kontenierëve janë të dëmtuar), higjenës së tyre dhe numrit të pamjaftueshëm të kontenierëve. Kontenierët janë shpesh objekt pune për kërkuesit informale

të materialeve të riciklueshme të cilët, përveç faktit që rrezikojnë marrjen e sëmundjeve të ndryshme, janë edhe një nga shkaktarët e ndotjes së vendit rreth tyre.

| Kontenierë, mjete dhe frekuenca viti 2015 | | | | | | | | | | | |
|---|-----------------------------------|--------------|--------|--------------|---------|--------------|---------|--------------|-------|--------------|-----------|
| NjA | Kontenierët (metalik/plasticë) | | | | Mjete | | | | | | Frekuenca |
| | 1.1 m ³ | | 100 kg | | 3.5 ton | | 4-5 ton | | 7 ton | | |
| | Nr. | Viti blerjes | Nr. | Viti blerjes | Nr. | Viti blerjes | Nr. | Viti blerjes | Nr. | Viti blerjes | |
| Shijak | 25 | 2014 | 18 | | 1 | 2007 | 1 | 2007 | | | 6 |
| Xhafzotaj | - | - | - | | | | | | 1 | 2009 | 2 |
| Maminas | 7 | 2011 | - | | | | 1 | 2011 | | | 2 |
| Gjepalaj | - | - | - | | | | | | | | - |
| Shuma | 32 | | 18 | | | | | | | | |
| Gjendja fizike | Të dëmtuara | | | | | | | | | | |

Tabela 10. Infrastruktura e grumbullimit të mbetjeve, numri, lloji, viti i blerjes dhe gjendja

Rrjeti aktual i PGM në qytetin e Shijakut përbëhet nga 19 pika të përbashkëta për grumbullimin e mbetjeve në të cilën janë shpërndarë 26 kontenierë metalikë, në pika me 1, apo 2 kontenierë në cdo pikë.

Në kontratën aktuale (2016) aktivitetet e mbledhjes dhe transportit të mbetjeve lidhen me procesin e zbrazjes së kontenierëve me anë të 4 makinave teknologjike (2 makina vetëshkarkuese me kompaktor të tipit Benz 7 ton të vitit 2007 dhe 2008 dhe dy kamioncina të vogla po vetëshkarkuese 3.5 tonë të vitit 2004) dhe grumbullimit të mbetjeve përreth kontenierëve. Intinerari dhe frekuenca e përzgjedhur për grumbullimin e mbetjeve urbane për vetë specifikën e tipologjisë të qytetit, ndryshon sipas zonave. Në NjA Shijak, ku janë të pozicionuar rreth 26 kontenierë kryehet shërbim ditor për mbledhjen e mbetjeve, ndërsa në NjA Gjepalaj janë vendosur 6 kontenierë dhe shërbimi ofrohet 6 ditë në javë.

Në bashkinë Shijak shërbimi aktual i pastrimit, i grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve është një shërbim i cunguar dhe jo i plotë në të gjithë territorin. Në kontratën e pastrimit për vitin 2016 nuk ka të dhëna të hollësishme për metodologjinë e kryerjes së këtij shërbimi apo rregulla bazë për shërbimin, mungojnë standarte specifike për kryerjen e këtij shërbimi. Mbledhja e

mbetjeje voluminoze nuk është një shërbim i parashikuar në kontratën me kompaninë sipërmarrëse. Nuk ka të dhëna zyrtare mbi mbetjet voluminoze që bashkia vetë ose përmes firmës kontraktuese largon nga territori i saj. Për këtë qëllim gjenerimi, mbledhja dhe depozitimi i mbetjeje voluminoze duhet të adresohet si një çështje e rëndësishme për menaxhimin e mbetjeje në Bashkinë e Shijakut. Problem janë dhe mbetjet e gjelbra (zona ka aktivitet të zhvilluar bujqësor) sidomos në qytet ku familjarët i hedhin këto mbetje në kontenerët publik, ndërsa në zonat rurale në përgjithësi përdoren për kompostim individual.

Siç u nënvizua më lart, numri i pamjaftueshëm i kontenerëve, depozitimi i mbetjeje jashtë kontenerëve dhe kultura e ulët qytetare në lidhje me mbetjet dhe mjedisin urban mbeten problematika kryesore e këtij shërbimi si në drejtim të cilësisë ashtu dhe në lidhje me efektivitetin dhe efikasitetin e tij.

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeje, në sajë të infrastrukturës të dëmtuar (pika të hapura apo të pa standardizuara të grumbullimit të mbetjeje) nuk është as efikas dhe as efektiv.

Mbledhja e miksuar e të gjitha rrymave të mbetjeje sidomos me rrymat e mbetjeje të rrezikshme rrit më shumë probabilitetin e përhapjes së ndotjes. Shpesh këto mbetje hidhen të përziera me mbetje urbane duke ndikuar cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve.

Në çdo njësi administrative gjenden pika ilegale të depozitimit/hedhjes së mbetjeje sidomos përgjatë shtratit të Erzenit, apo dhe në territore të tjera bujqësore (sidomos në Gjepalaj). Vazhdimi i depozitimit të mbetjeje në fushat e improvizuara përbën një rrezik të mundshëm për shëndetin e njeriut, burimet natyrore (toka, uji, ajri) si dhe për zhvillimin e turizmit në të gjitha njësitë vendore të zonës.



Figura 8. Pika ilegale të hedhjes së mbetjeje

Kështu, gjatë vitit 2016, u investuan në blerjen e 237 kontenerëve të rinj, 40 kontenerë të vegjël që do të vendosen në shëtitoren e qytetit dhe 3 pika grumbullimi mbetjesh të ndara në burim në një nga zonat e qytetit dhe në çdo godinë të NJA të Shijakut, me anë të të cilëve synohet të ndryshojë tërësisht performanca lokale për shërbimet e mbetjeje. Kontenerët janë

në pronësi të bashkisë dhe i janë dhënë në përdorim kompanisë sipërmarrëse të pastrimit. Është kjo kompani pastrimi që do të kujdeset për mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

3.3.3 Pastrimi i rrugëve

Nga 255,190 m² sipërfaqe rruge, trotuare dhe sheshe, fshihen dhe pastrohen 65,490 m² ose 26% e totalit. Fshirje dhe pastrim të plotë përfitojnë rrugët, sheshet dhe trotualet e NjA Shijak (61490 m²), pjesërisht Maminasi (4000 m² shesh), ndërsa NjA Xhafzotaj dhe NjA Gjepale nuk e përfitojnë këtë shërbim.

| NjA | Rrugë | | Trotuare | | Sheshe | | TOTALI | | % e ofrimit shërbimit |
|----------------|----------------------------|---------------------------|----------------------------|---------------------------|----------------------------|---------------------------|----------------------------|---------------------------|-----------------------|
| | Gjithsej m ² | Fshihen m ² | Gjithsej m ² | Fshihen m ² | Gjithsej m ² | Fshihen m ² | Gjithsej m ² | Fshihen m ² | |
| Shijak | 48,215 | 48,215 | 11,000 | 11,000 | 2,275 | 2,275 | 61,490 | 61,490 | 100% |
| Xhafzotaj | 140,000 | - | 3,500 | - | 3,000 | - | 146,500 | - | - |
| Maminasi | 21,300 | 4,000 | 3,000 | - | 2,900 | - | 27,200 | 4,000 | 15% |
| Gjepale | 20,000 | - | - | - | - | - | 20,000 | - | - |
| Bashkia | 229,515 | 52,215 | 17,500 | 11,000 | 8,175 | 2,275 | 255,190 | 65,490 | 26% |

Tabela 11. Sipërfaqet e rrugëve dhe shesheve që fshihen dhe pastrohen

Procesi i fshirjes lidhet me aktivitetet e fshirjes me fshesë xanë, kruajtje e mbetjeve të vogla prej balte në mënyrë manuale të rrugës, trotuareve dhe shesheve kryesore të qytetit, grumbullimi i mbetjeve dhe transportimi i tyre me karrocë dore në vendgrumbullimin e tyre më të afërt.

Gjithashtu bashkia për periudhën e verës (1 Maj- 30 Shtator) ofron shërbimin e larjes 2 herë në ditë gjatë ditëve të javës (07.00 – 9.00 dhe 14.30 – 16.30) dhe një herë në ditë në fundjavë (07.00 – 9.00) me makinë larëse të rrugës kryesore me sipërfaqe 2275 m². Fshirja e rrugëve kryhet nga ora 02.00 deri në 07.00. Ndërsa pjesa e qendrës së qytetit mirëmbahet nga pastrues që punojnë gjatë ditës nga ora 07:00 deri në orën 14:00.



Figura 9 Momente nga larja e rrugëve

Për të përmbushur detyrimet, për kryerjen e këtyre shërbimeve janë të angazhuar me kohë të plotë 39 punëtorë, që punojnë 6 ditë të javës, dhe 5-6 punëtorë me kohë të pjeshme (për periudhën e verës) një shofer për larjen e rrugëve. Megjithëse bashkia dhe kompania e pastrimit organizojnë aksione për pastrimin e rrugëve të tjera apo të hapësirave të tjera urbane (me infrastrukturë të dëmtuar), këto zona mbeten të pambuluara me shërbim periodik dhe të pa përcaktuara në kontratën e pastrimit.

3.3.4 Depozitimi

Është parashikuar që mbeturinat të shkarkohen në VGM-në e Porto Romanos, Durrës, si pika më e afërt nga Bashkia Shijak për depozitimin e mbetjeve. Kjo distancë është 16 km nga qendra e qytetit Shijak.

Evadimi i mbetjeve për në VGM është i përditshëm dhe përballohet nga 2 kamionë me kapacitet mbajtës 3.5 ton dhe dy të tjerë me kapacitet 7 ton. Deri dje nuk ka patur fond të dedikuar për depozitimin e mbetjeve në landfillin e Durrësit. Tashme në çmim është e përfshirë edhe tarifa që do të paguhet për depozitimin e mbetjeve në VGM, tarifë kjo e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr.169/2013 (101 lekë/m³).

| Vend depozitimet e mbetjeve | | | | |
|-----------------------------|---------------------|----------|---------------------|----------|
| NJA | Viti 2015-2016 | | Pritet në vazhdim | |
| | Vendi i depozitimit | Largësia | Vendi i depozitimit | Largësia |
| Shijak | Porto Romano | 16 km | Rade -Manëz | |
| Xhafzotaj | Porto Romano | 14 km | | |
| Maminas | Porto Romano | 22 km | | |
| Gjepalaj | Porto Romano | 21 km | | |

Tabela 12. Mbi vend depozitimet e mbetjeve

Bashkia depoziton mesatarisht çdo ditë rreth 20-22 ton mbetje, të natyrës urbane (si dhe skeletike, bimore), mbeturinat e tregjeve, dhe mbeturinat industriale. Në situatën aktuale funksionojnë pikat e grumbullimit të përkohshëm të mbetjeve dhe më pas ato transferohen për në venddepozitimin e mbetjeve rajonale të Durrësit.

Porto Romano është i vetmi vend i hapur i asgjësimit të mbetjeve në Durrës, i amortizuar, i cili për shkak të rrezikut shumë të lartë të ndotjes ishte parashikuar të mbyllej në vitin 2015. Në datën 18.11.2014 MM ka nisur një procedurë të dhënies me koncesion të Landfillit për Qarkun e Durrësit në Radë, Manëz. Ndërkohë në listën prej 10 pikash si më të përshtatshme për ndërtimin e landfillit rajonal, një nga pikat (e renditur e treta) ishte në zonën e Shijakut (1.1 km në verilindje të Shijakut dhe 300 m nga fshati Koxhas) dhe përmbushte kriteret për të qënë një vend i përshtatshëm. Bashkia mund ta shohë këtë pikë si landfill (në rast të mbylljes së Porto Romanos) apo për të projektuar një vendgrumbullim për mbetjet inerte dhe ato voluminoze

Gjithashtu Porto Romano nuk ka një sistem për administrimin e mbetjeve të rrezikshme (atyre të prodhuara nga industrinë dhe ato voluminoze shtëpiake) të cilat janë një rrezik potencial për shëndetin e njeriut.



Figura 11 Vend-depozitimi aktual i Porto Romanos

3.3.5 Riciklimi

Në Bashkinë e Shijakut nuk ka ekzistuar ndonjëherë një sistem për mbledhjen në mënyrë të diferencuar të mbetjeve të riciklueshme apo praninë e qendrave për grumbullimin e tyre. Ekzistojnë aktivitete të vogla informale për mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme nga kontenerët publikë, të cilët gjëmojnë për materiale të ricikluara (kryesisht metale, lëndë plastike dhe plastikë LD) në pikat e grumbullimit (brenda kontenerëve metalikë apo në vendet ilegale të depozitimit të mbetjeve).

Në Bashkinë Shijak ekzistojnë disa aktivitete të industrisë së riciklimit si firma riciklimi AME Ambient që mbledh (plastikë, plastmas, letër, karton, etj) dhe riciklon vetëm plastikën HDP dhe PP si dhe është në proces të riciklimit të kartonit. Në zonë operojnë dhe grumbullues të fraksioneve të mbetjeve (letra/ karton, hekur, alumin, kanace) që mblidhen nga rrjeti i kolektorëve individual dhe 2 grumbullues të mëdhenj në Xhafzotaj, 1 ushqimore në Gjepalaj, 1 në Shkozet por që mbledh edhe nga Gjepalaj. Në zonë operon dhe një Biznes i madh riciklues hekuri (Kompania Schultz). Kontrata aktuale e bashkisë Shijak me subjektin që bën menaxhimin e mbetjeve për 2016 nuk ka parashikuar procesin e ndarjes në burim dhe arritjen e targetit të riciklimit.

3.4 Ekonomia dhe financimi

3.4.1 Buxheti vjetor dhe investimet

Çdo fillim viti, Bashkia Shijak në zbatim të funksioneve ligjore dhe administrative, përcakton dhe miraton buxhetin vjetor ku përfshihen edhe shpenzimet e parashikuara për pastrimin e qytetit. Duke iu referuar të dhënave mbi buxhetet e realizuara të bashkisë dhe të shpenzimeve për menaxhimin e mbetjeve, rezultojnë se buxheti për pastrimin përbën rreth 8-9 % të buxhetit total.

| NJA | Viti 2015 | | | Viti 2016 | | |
|---------------|---------------------------|--------------------------------|--|---------------------------|--|--|
| | Buxheti total 000/lekë | Buxheti për shërbimin e ofruar | % e buxhetit të shërbimit ndaj totalit | Buxheti total 000/lekë | Buxheti për shërbimin e ofruar (000/lekë) | % e buxhetit të shërbimit ndaj totalit |
| Shijak | 72,530 | 8,183 | 11% | 169,290 | 13,081 | 8% |
| Xhafzotaj | 112,868 | 6,030 | 5% | 162,868 | 8,209 | 5% |
| Maminas | 28,345 | 3,400 | 12% | 30,345 | 5,977 | 20% |
| Gjepalaj | 12,070 | 400 | 3% | 12,277 | 4,970 | 40% |
| Totali | 225,813 | 18,013 | 8% | 374,780 | 32,237 | 9% |

Tabela 13. Mbi buxhetin vjetor të shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve

Megjithatë, duke iu referuar të dhënave paraprake dhe intervistave me GP, rezultojnë se buxhetet e deritanishme për menaxhimin e mbetjeve, kanë qenë të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit, apo përmbushjen e investimeve e infrastrukturës së mbetjeve. Analiza e mëtejshme e skemës optimale dhe kostos së plotë të këtij shërbimi do të mundësojë një pamje më të qartë të nevojave dhe mundësisë së bashkisë për të realizuar qëllimet e veta.

Objektivat për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve të përcaktuara nga Strategjia dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të mbetjeve vazhdojnë akoma të mbeten të pazbatueshme për shkak të mungesës të financimeve dhe kapaciteteve të nevojshme. NjQV-të nuk kanë aplikuar për të

përfitur nga fondet e zhvillimit të rajoneve, të akorduara nga qeverisja qendrore në fushën e investimeve për menaxhimin e mbetjeve.

3.4.2 Ndarja e kostove

Megjithëse autoritetet lokale marrin në analizë shpërndarjen e buxhetit për pastrimin sipas nevojave dhe kostove të shërbimeve, një analizë e hollësishme e kostove dhe shpërndarjes së buxhetit bëhet vetëm gjatë përgatitjes së dokumentacionit për organizimin e tenderit të pastrimit gjatë analizës së çmimit të kontratës apo në rastet kur parashikohet në kontratë rishikim i këtij çmimi. Bashkia Shijak në tetor të vitit 2015 përgatiti dokumentat e tenderit për kontratën 1 vjeçare të vitit 2016, ku vihet re që kosto e pastrimit dhe largimit të mbetjeve trajtohet bashkë me kostot e shërbimeve të tjera si gjelbërimi dhe mirëmbajtja e varrezave.

Duke iu referuar analizës së fundit të çmimit të kontratës, dhe duke veçuar shërbimet e tjera, shpërndarja e shpenzimeve të pastrimit dhe largimit të mbetjeve ilustron në tabelën e mëposhtme:

Tabela 14. Kosto e shërbimit sipas zërave të kostos

| Zërat e buxhetit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve Lekë | Sipas Njësive Administrative | | | | | Totali | Në% |
|--|------------------------------|--------------|--------------|--------------|--|---------------|-------------|
| | Shijak | Xhafzotaj | Maminas | Gjepalaj | | | |
| Pagat&sigurimet shoqërore | 6,945 | 3,016 | 1,938 | 985 | | 12,884 | 40% |
| Shpenzimet e materialeve | 3,160 | 122 | 90 | 34 | | 3,406 | 11% |
| Shpenzime për mirëmbajtje | 150 | 2,244 | 1,122 | 1,122 | | 4,638 | 22% |
| Shuma | 10,255 | 5,382 | 3,150 | 2,141 | | 20,928 | |
| Shpenzime administrative | 289 | 290 | 290 | 290 | | 1,159 | 4% |
| Qera VGM | 318 | 318 | 318 | 319 | | 1,273 | 4% |
| Te tjera, fitim, tvsh | 2,219 | 2,219 | 2,219 | 2,220 | | 8,877 | 28% |
| Totali (000 lek) | 13,081 | 8,209 | 5,977 | 4,970 | | 32,237 | 100% |
| Lekë/banorë sipas RrC | 990 | 446 | 840 | 836 | | 722 | |

Burimi: Specifikimet analitike të kontratës 1 vjeçare të pastrimit

Për vitin 2016 Bashkia Shijak ka kontraktuar 32,237 mijë lek ose 722 lekë/banor dhe kosto përfshin ofrimin e shërbimit për të gjitha familjet dhe bizneset në territorin e saj. Një Shijak do të shpenzojë për pastrimin dhe largimin e mbetjeve 13,081 mijë lek ose 41% të totalit të shpenzimeve për këtë shërbim në gjithë bashkinë. Pjesë e rëndësishme e koston së llogaritur janë pagat dhe sigurimet shoqërore të cilat zenë 40% të totalit.

Sipas çdo aktiviteti, kosto e shërbimit (pa tatimet) paraqitet si më poshtë:

Tabela 15. Kosto e shërbimit sipas aktiviteteve

| Kosto e shërbimit sipas çdo aktiviteti dhe NjA | | | | | | | | | | |
|---|--------|----------------|--------|----------------|-----------|----------------|---------|----------------|----------|----------------|
| Aktivitetet kryesore | Totali | | Shijak | | Xhafzotaj | | Maminas | | Gjepalaj | |
| | Sasi | Kosto 000/L | Sasi | Kosto 000/L | Sasi | Kosto 000/L | Sasi | Kosto 000/L | Sasi | Kosto 000/L |
| Pastrim/Fshirje rrugë, sheshe (m ²) | 65,490 | 5,083 | 61,490 | 4,621 | | | 4,000 | 462 | | |
| Lagje rrugë (maj – shtator) m ² | 47,370 | 1,210 | 47,370 | 1,210 | - | | - | | - | |
| Mbledhje dhe transport mbetje (ton) | 7,938 | 14,635 | 3,374 | 4,424 | 2,671 | 5,382 | 1,037 | 2,688 | 856 | 2,141 |
| Totali 000/lek | | 20,928 | | 10,255 | | 5,382 | | 3,150 | | 2,141 |

Burimi: Kontrata e shërbimit viti 2016

- Shërbimi i pastrimit dhe fshirjes së rrugëve, trotuareve dhe shesheve zë 24% të koston dhe përfshin aktivitetet si më poshtë:
- Largimi çdo ditë i 21,750 kg/mbetje/ditë (sipas kontratës) nga pikat e grumbullimit dhe transportimi i tyre në fushën e grumbullimit zë pjesën më të madhe të koston (70%). Aktivitetet përfshijnë:
 - Automjetet e transportit sipas destinacionit të caktuar kryejnë transportin e mbetjeve në landfillin e Porto Romanës;
 - Punëtorët e transportit kanë për detyrë të heqin të gjitha mbetjet urbane nga pikat e grumbullimit, të bejnë fshirjen me fshesë dhe dezinfektimin me gëlqere të vend grumbullimit me një rreze prej 3m.
- Lagija e rrugëve dhe shesheve kryesore të qytetit realizohet me autobot për periudhën Maj –Shtator, lagen rreth 47,370 m² sipërfaqe.

3.4.3 Tarifat dhe realizimi i të ardhurave

Tarifat e pastrimit për nivele të ndryshme të konsumatorëve, si familjet, bizneset dhe insitucionet, caktohen dhe propozohen nga bashkia dhe miratohen çdo vit nga Këshilli Bashkiak bashkë me taksat dhe tarifat e tjera lokale. Nuk rezulton të jetë kryer ndonjë studim i mirëfilltë për nivelet e tarifave për secilin konsumator në funksion të gjenerimit të mbetjeve apo të shërbimeve që përfitojnë. Tarifa familjare e pastrimit është një shumë e caktuar vjetore për t'u paguar nga familjet pavarësisht madhësisë së tyre, por që klasifikohet/kufizohet nga niveli i të ardhurave: familje në ndihmë ekonomike ose jo.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten nivelet e tarifave dhe të ardhurat e planifikuara për vitin 2016. Duhet të sqarojme që niveli i tarifës së pastrimit sipas paketës fiskale përfshin jo vetëm shërbimin e pastrimit por edhe shërbime të tjera si gjelbërimin, por ne për efekt të politikave të mëtejshme do ta konsiderojmë nivelin si tarifë vetëm për pastrimin.

Tabela 16. Niveli i tarifave dhe të ardhurat për vitin 2016

| Të ardhurat nga tarifat | | | |
|--|------------------|------------------------|------------------------------------|
| NjA | Viti 2016 | | |
| | Numri | Tarifa mesatare | Plani i të ardhurave (lekë) |
| Familjet | | | |
| Shijak | 2,795 | 1,500 | 4,192,500 |
| Xhafzotaj | 4,288 | 1,500 | 6,432,000 |
| Maminas | 1,000 | 1,500 | 1,500,000 |
| Gjepalaj | 873 | 800 | 698,400 |
| Shuma 1 | 8,956 | 1,432 | 12,822,900 |
| Familje me ndihmë ekonomike, invalidë | | | |
| Shuma 2 | 1,515 | 300 | 454,500 |
| Kryefamiljarë pensionistë të vetëm | | | |
| Shuma 3 | 150 | 200 | 30,000 |
| Biznesi i madh | | | |
| Shijak | 30 | 39,833 | 1,195,000 |
| Xhafzotaj | 78 | 43,782 | 3,415,000 |

PLANI VENDOR I MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE - BASHKIA SHIJAK

| | | | |
|------------------------|------------|---------------|-------------------|
| Maminas | 23 | 41,522 | 955,000 |
| Gjepalaj | 3 | 30,000 | 90,000 |
| Shuma 4 | 134 | 42,200 | 5,655,000 |
| Biznesi i Vogël | | | |
| Shijak | 250 | 9,964 | 2,491,000 |
| Xhafzotaj | 267 | 9,981 | 2,665,000 |
| Maminas | 109 | 10,000 | 1,090,000 |
| Gjepalaj | 12 | 10,000 | 120,000 |
| Shuma 5 | 638 | 10,000 | 6,366,000 |
| Institucionet | | | |
| Shijak | 15 | 0 | - |
| Xhafzotaj | 18 | 0 | - |
| Maminas | 11 | 0 | - |
| Gjepalaj | 17 | 0 | - |
| Shuma | 61 | - | - |
| TOTALI (Lekë) | | | 25,328,400 |

Burimi: Paketa fiskale dhe buxheti i vitit 2016

Sipas tabelës së mësipërme, bazuar në të ardhurat dhe nivelin e miratuar nga këshilli i bashkisë, konstatojmë që bashkia ka planifikuar për pagimin e detyrimeve 10,621 familje, duke përjashtuar nga pagesa e detyrimit për shkak të emigrimit 15% të popullsisë dhe 772 biznese, dhe rreth 7% të biznesit për shkak të mbylljes apo largimit nga territori.

Nivelet e tarifave nga viti në vit nuk kanë pësuar ndryshime të ndjeshme. Kështu, në vitin 2015, tarifa e mbetjeve për familjet rezultonte në nivelin e 1000 lekë/vit, ndërsa sot për vitin 2016, kjo tarifë varion nga 800-1,500 lek/familje/vit. Në përgjithësi politikat e NjQV janë drejtuar drejt niveleve të larta të tarifave për biznesin. Kriteri i parë për vendosjen e tyre është klasifikimi i aktivitetit (psh biznes i madh, apo i vogël), ndërsa kriteri i dytë që aplikohet është lloji i aktivitetit (ushqimore, restaurant, rrobaqepësi, klub kafe, etj).

Duke iu referuar një analizë të bërë në të gjithë NjA të Bashkisë Shijak, vihet re që mbi bazën e planifikimit minimalist të të ardhurave, pra me një ulje prej 15-30% të familjeve sipas RrC në vitin 2015 dhe 2016, të ardhurat në total kanë një performacë të mirë në mbledhje, pra janë realizuar mesatarisht rreth 109% për vitin 2015. Rritja vjen nga NjA Xhafzotaj. Por, vihet re që në NjA Gjepalaj dhe NjA Shijak të ardhurat realizohen përkatësisht vetëm 13% dhe 68%.

Edhe krahasuar me vitin 2015, të ardhurat në vitin 2016 planifikohen me rritje të ndjeshme ndaj planit (me +107%). Gjithashtu plani i të ardhurave në vitin 2016 është gati 2 herë më i lartë se realizimi i tyre në vitin 2015 (+90%).

Tabela 17. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave 2015-2016

| Të ardhurat e realizuara nga tarifa e pastrimit | | | | | | | |
|---|---------------------------|--------------------|-----------------------|-------------------------|---------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|
| NjA | Viti 2015 | | | | Viti 2016 | | |
| | Planifikuar r 000/lekë | Paguar 000/lekë | % e ndryshimi t | Në % ndaj totalit | Planifikuar r 000/lekë | Në % ndaj planit 2015 | Në % ndaj realizimi t 2015 |
| Familjet, bizneset, institucionet | | | | | | | |
| Shijak | 4,828 | 3,267 | 68% | 25% | 8,363 | 73% | 156% |
| Xhafzotaj | 6,043 | 9,254 | 153% | 69% | 12,512 | 107% | 35% |
| Maminas | 950 | 752 | 79% | 6% | 3,545 | 273% | 371% |
| Gjepalaj | 405 | 54 | 13% | 0% | 908 | 124% | 1582% |
| Shuma | 12,226 | 13,327 | 109% | 100% | 25,328 | 107% | 90% |
| Totali i të ardhurave të veta | 120,467 | 137,263 | 114% | | 156,844 | | |
| Të ardhurat nga tarifa në % ndaj totalit | 10% | 10% | | | 16% | | |

Burimi: Buxheti i Bashkisë 2015-2016

Të gjitha tarifat si për familjet ashtu dhe për bizneset faturohen dhe mbledhen nga autoritetet lokale nëpërmjet zyrës së taksave dhe tarifave si dhe në zyrat administrative për qytetarët. Për

të detyruar familjet të paguajnë detyrimin vjetor për pastrimin, bashkia ka aplikuar instrumente detyrues si mosofrimi apo mospërfitimi i shërbimeve të tjera administrative lokale.

Duke iu referuar performancës së deritanishme të mbulimit të kostos nga të ardhurat e mbledhura nga tarifat, rezulton se bashkia ka mbuluar në vitin 2015 vetëm 74% të kostos operative për menaxhimin e mbetjeve. Por, edhe plani i të ardhurave të vitit 2016, që dyfishohet krahasuar me atë të vitit 2015, nuk garanton mbulimin 100% të kostos operative, por vetëm 79% të saj. Pra, pritet që rreth 6,909 mije lekë nga të ardhurat e tjera të bashkisë të mbulojnë koston operative të shërbimit.

Tabela 18. Mbulimi i kostos operative nga të ardhurat

| NJA | Realizimi 2015 | | | Plani 2016 | | |
|-------------------|---|--------------------------|------------------------|-----------------------------|----------------------------|------------------------|
| | Kosto operative e shërbimit | Të ardhurat e realizuara | % e mbulimit të kostos | Kosto operative e shërbimit | Të ardhurat e planifikuara | % e mbulimit të kostos |
| Shijak | 8,183 | 3,267 | 40% | 13,081 | 8,363 | 64% |
| Xhafzotaj | 6,030 | 9,254 | 153% | 8,209 | 12,512 | 152% |
| Maminas | 3,400 | 752 | 22% | 5,977 | 3,545 | 59% |
| Gjepalaj | 400 | 54 | 14% | 4,970 | 908 | 18% |
| Totali | 18,013 | 13,327 | 74% | 32,237 | 25,328 | 79% |
| Nga familjet | | | | | 13,307 | 41% |
| Nga biznesi | Nuk ka të dhëna të sakta përpara 2015 mbi të ardhurat nga familjet dhe bizneset | | | | 12,021 | 37% |
| Nga institucionet | | | | | - | 0% |

Burimi: Dokumenti i buxhetit 2015-2016

Pamundësia ekonomike e një shtrese të gjerë të popullsisë së zonës për të paguar tarifat e pastrimit; ndërgjegjësimi i ulët për të paguar, mungesa e mekanizmave për vendosjen e sanksioneve, bën të pamundur përballimin e kostos së këtij shërbimi nga tarifat.

3.5 Performanca aktuale e administrimit të mbetjeve vendore

Për të vlerësuar performancën aktuale të menaxhimit të mbetjeve, ekspertët dhe GP, ndërmori një analizë të detajuar të sistemit por edhe perceptimin e publikut në lidhje me shërbimin e pastrimit. Analiza e sistemit është realizuar si në indikatorët e performancës ashtu edhe në identifikimin e avantazheve, dobësive, mundësive dhe rreziqeve që i gjithë sistemi apo elementët përbërës të tij shfaqin. Për këtë qëllim, analiza u bazua në të gjithë të dhënat e marra nga takimet, si dhe duke shqyrtuar të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje të drejtpërdrejtë apo indirekte me menaxhimin e mbetjeve, në drejtim të aspekteve ligjore dhe administrative, cilësore dhe efektive, ekonomik dhe mjedisor që lidhet me veprimet apo mosveprimet e bashkisë, ashtu dhe me ndikimin e faktorëve të tjerë në këtë performancë të përgjithshme.

3.5.1 Analiza e indikatorëve të performancës

Bazuar në metodologjinë e zhvilluar nga dldp që në fillim të procesit u prezantuan indikatorët e përzgjedhur për monitorimin e cilësisë së shërbimit të ofruar në nivel bashkie. Të dhënat e përftuara do të ndihmojnë në krijimin e një pasqyre të qartë të realitetit por edhe në vendosjen e objektivave të qartë dhe plotësisht të matshëm për bashkinë për një periudhë të përcaktuar. Këto indikatorë që do të përshkruhen më poshtë do të maten dhe rishihen në baza një vjeçare dhe do të jenë shumë të rëndësishme edhe gjatë periudhës së raportimit pranë këshillit bashkiak. Gjithsej do të maten dhe monitorohen 8 indikatorë të ndarë në ato që lidhen me (i) cilësinë e shërbimit, (ii) indikatorë të qëndrueshmërisë mjedisore dhe (iii) indikatorë të qëndrueshmërisë ekonomike, financiare dhe institucionale. Jemi të vetëdijshëm se për disa nga indikatorët informacioni apo të dhënat e grumbulluara janë jo zyrtare apo të dhëna që nuk janë grumbulluar ndonjëherë ndaj duke qënë se mbledhen për herë të parë krahas vlerës përkatëse do të ketë dhe një kategorizim sipas saktësisë së informacionit në tre nivele e ulët, e mesme dhe e lartë.

Indikatorët e cilësisë së shërbimit

“Efikasiteti në mbledhjen e mbetjeve” shpreh sasinë e mbetjeve të mbledhura nga autoriteti i autorizuar për këtë shërbim përkundrejt sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në NJQV si për zonën urbane dhe për atë rurale. Besimi në këtë indikator varet shumë nga metodat e përdorura për grumbullimin e të dhënave. Duke qënë se në të shkuarën nuk ka patur të dhëna të sakta në lidhje me sasinë e mbetjeve të grumbulluara dhe as të dhëna nga sasia e mbetjeve të depozituara në landfill mund të themi se besueshmëria e këtyre të dhënave është e ulët dhe mbështetur në hamëndësime. Megjithatë nga të dhënat e mbledhura shkalla e mbulimit të

mblledhjes së mbetjeve për zonën urbane është 100% dhe për atë rurale është 81% (vetëm NJA Gjepalaj nuk ka qenë në skemën e grumbullimit të mbetjeve).

“Pastërtia e qytetit” shpreh efektivitetin e mblledhjes së mbetjeve dhe fshirjes së rrugëve. Vlerësohet në tre aspekte: në efektivitetin e mblledhjes së mbetjeve, të pastrimit të rrugëve dhe në atë të zonave rurale. Për sa i takon prezencës së mbetjeve përreth kontenierëve mund të themi që në qytetin e Shijakut (ku ka PGM) viher re prezencë e moderuar e mbetjeve, ndërsa në rrugë ka prezencë të ulët të mbetjeve. Në zonat rurale ka prezencë të moderuar të mbetjeve dhe numër të vogël hot spotesh të krijuara. Në vlerësimin tonë ky indikator klasifikohet në kategorinë e mesme (65%) me saktësi të mesme pasi një pjesë e të dhënave vijnë dhe nga sondazhi i limituar i bërë përgjatë muajit mars 2016.

“Perceptimi Publik” u realizua me 200 banorë dhe 60 biznese të zonës. Të pyetur rreth cilësisë së pastrimit në lagjen/fshatin/qytetin ku banojnë 76% u përgjigjen se mjedisi i tyre është i pastër.

Indikatorët e Qëndrueshmërisë Mjedisore

“Ripërdorimi: shkalla e mblledhjes së diferencuar të mbetjeve në zonat urbane” përfaqëson shkallën e sasisë së mbetjeve të mblledhura zyrtarisht nga një cikël i mbyllur që nga pikat e grumbullimit në qendrën e trajtimit të mëtejshëm. Nuk ka të dhëna zyrtare, por as edhe një iniciativë për ndarje mbetjesh në burim. Gjithashtu sipas bisedave me mbledhësit e mbetjeve apo dhe kompaninë e riciklimit që operon në zonë mbetjet e diferencuara krahasuar me totalin e mbetjeve të mblledhura nuk kalojnë vlerat 5%.

“Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e mbetjeve të trajtuara në landfill sanitar ose vend depozitime të aprovuara”. Të gjitha mbetjet e grumbulluara përgjatë këtyre viteve (100%) janë dërguar në landfillin e Porto Romanos i cili është i njohur edhe nga qeveria shqiptare megjithëse nuk përmbush standartet e një landfili sanitar. Megjithatë shkalla e vërtetësisë është e ulët pasi nuk ka rekorde zyrtare dhe mbështeten në hamëndësime.

Indikatorët e Qëndrueshmërisë Institucionale

“Mbulimi i kostos përmes tarifës” Krahason koston totale për shërbimin dhe financimin e tij përmes tarifës së vendosur dhe nivelit të mblledhjes së saj. Nëse i referohemi tabelës së mësipërme nr.18, të ardhurat vjetore të realizuara nga tarifa e pastrimit për 2015 janë 13,377 mijë lekë, ndërsa kosto operative vjetore është 20,928 mijë lekë, pra mbulimi i kostos është vetëm 64%.

“Kontributi i qytetarëve në financimin e shërbimit: niveli i mblledhjes së tarifës” reflekton kapacitetin/dëshirën e popullsisë për të paguar tarifën. Nëse i referohemi tabelës së mësipërme

nr.17, të ardhurat vjetore të realizuara nga tarifa e pastrimit për 2015 janë 13,327 lekë, ndërsa totali i të ardhurave të planifikuara 12,226 leke, pra të ardhurat realizohen në masën 109%. Ky realizim vjen si rezultat i një planifikimi me rezervë, pra me një numër më të vogël familjesh e biznesesh të rregjistruar. Të ardhurat e realizuara nga popullsia janë mesatarisht vetëm 74%, ku në Gjejalaj dhe Shijak, ato realizohen përkatësisht 13% dhe 68%.

“Transparenca e sistemit të faturimit” Vlerëson kapacitetin e bashkisë për t’i dhënë faturë klientit. Deri më sot nuk ka patur një sistem faturimi për shërbimin e pastrimit, ndaj mund të thuhet që transparenca ka qënë e ulët.

| Indikatorët | | Klasifikim i koduar me ngjyra | | | Saktësia e të dhënave |
|------------------------------------|------|--|--------------|------------------|-----------------------|
| | | I ulët | I mesëm | I lartë | |
| Cilësia e shërbimit | C1 | zona e mbulimit të shërbimit | | | |
| | C1.1 | <i>mbulimi i shërbimit në zonën urbane dhe peri-urbane</i> | 0 – 40 % | 41 – 80% | 81 – 100% 100% |
| | C1.2 | <i>mbulimi i shërbimit në zonën rurale</i> | 0 – 30 % | 31 – 50% | 51 – 100% 81% |
| | C2 | pastërta e qytetit | 0 – 32 % | 33 - 66% 65% | > 66% |
| | C3 | perceptimi publik: shkalla e kenaqshmërisë së publikut me shërbimin | 0 – 50% | 51% - 80% 76% | 81% - 100% |
| Qendrueshmëria mjedisore | D1 | Ripërdorimi: shkalla e mbledhjes së diferencuar të mbetjeve në zonat urbane | 0 – 5% 5% | 5 – 20% | >20% |
| | D2 | Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e mbetjeve të trajtuara në landfille sanitare ose vend depozitime të aprovuara | 0 – 30% | 31 – 70% | 71 – 100% 100% |
| Institucionale finan dhe ekonomike | E1 | Mbulimi i koston: tarifa mbulon koston. | 0 – 35% | 36 – 70% | 71 – 100% 64% |
| | E2 | Si qytetarët kontribuojnë në financimin e shërbimit: niveli i mbledhjes së tarifës | 0 – 40% | 41 – 75% | 75 – 100% 109% |

| | | | | | |
|-------------------|---|---|---------|---------|--------|
| | E3 Transparenca me sistemin e faturimit | E ulët | E mesme | E lartë | E ulët |
| Kosto e shërbimit | | 962206 Lek/t ...722 Lek / banorë / vit | | | |

Tabela 19. Indikatorët e performancës

3.5.2 Vlerësimi i performancës përmes kënaqësisë së banorëve

Si pjesë e procesit përgjatë prill - maj 2016 u zhvillua një sondazh me 260 banorë dhe biznese të bashkisë Shijak për të kuptuar në mënyrë reale situatën e menaxhimit të mbetjeve, identifikuar problematikat dhe mundësitë reale të komunitetit për të ndërmarr iniciativa e kontribuar të gjithë së bashku për një mjedis më të pastër e më të shëndetshëm.

Sondazhi ishte strukturuar në 4 kategori të veçanta vlerësimi:

- Të dhënat të përgjithshme për familjen/biznesin dhe mundësinë ekonomike të tyre;
- Të dhëna për shërbimin e ofruar nga Bashkia në fushën e mbetjeve;
- Të dhëna mbi pagesën dhe tarifën e shërbimit;
- Të dhëna rreth informimit dhe komunikimit të ndërsjellë.

Po ashtu në përzgjedhjen e mostrës u mor për bazë: (i) pesha specifike e popullsisë për 4 NjA; (ii) kombinim i sondazhit në zonën rurale dhe urbane; (iii) u mbuluan gjitha llojet e bizneseve bazuar në natyrën e biznesit (iv) u ruajt dhe përpjesa gjinore për kategorinë e familjeve. Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave u realizua me progamin *google forms and analysis*.

Të pyetur rreth cilësisë së pastrimit në zonën ku banojnë 76% u përgjigjen se mjedisi i tyre është i pastër. 86.4% e bizneseve janë shprehur se koshat e ofruar nga bashkia nuk janë të mjaftueshëm.

28.8% janë shprehur se burimi kryesor i ndotjes vjen nga mbeturinat, 15.6% nuk dinin të specifikonin burimin e ndotjes ndërsa 45% nuk janë shprehur. Këto të dhëna mund të interpretohen se ka një mos njohuri të problemeve mjedisore nga ana e familjarëve.

Më shumë se gjysma e të intervistuarve (52%) nuk e dinë sesa herë tërhiqen mbetjet nga zona e tyre. 61.4% e bizneseve janë shprehur se shërbimi ofrohet 2-3 herë në javë ndërsa 27.3% janë shprehur se shërbimi ofrohet çdo ditë, ndërsa 11.4% janë shprehur se shërbimi nuk ofrohet asnjëherë. Duke e ditur që djegia e mbetjeve ka qenë një dukuri e zakonshme na shpie të mendojmë se duhet bërë më shumë punë për ndërgjegjësimin e banorëve dhe informimin mbi

oraret e lëvizjes së makinës së pastrimit. Kjo mbështetet edhe nga fakti që 6% e të intervistuarve pohojnë vetë që i djezin mbetjet, ndërsa 80% pranojnë që nuk ka kontenierë.

Vlen të theksohet se 40.9% e të intervistuarve mendojnë se përgjegjës për mjedisin është bashkia dhe më pas renditen vetë qytetarët me 22.7%, më pas renditet qeveria qendrore dhe biznesi.

Rezultatet e pyetësorit për familjarët dhe biznesin po ashtu tregojnë se ekziston një boshllëk i madh 60.6%-për familjarët dhe 84.1% për biznesin në informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe bizneseve të zonës për sjellje ndaj mjedisit. Gjithashtu 28% e familjarëve dhe 40.9% e bizneseve janë të gatshëm të pranojnë një rritje të tarifës me rritjen e cilësisë së shërbimit dhe të ndryshojnë sjelljen ndaj mjedisit.

Si përfundim, familjarët dhe bizneset janë shprehur se forma më e mirë e informimit dhe përfshirjes së tyre është përmes konsultimit publik me një nivel të ulët tek media¹² dhe faqja zyrtare e bashkisë.

Praktika e deritanishme mjedisore gjatë zbatimit të projektit dëshmon se qytetarët janë shumë të interesuar për pjesëmarrje në vendimmarrjet lokale në ato raste kur vendimi prek drejtpërdrejt interesat e ngushta të tyre, familjes dhe rrethit ku ata jetojnë. Por ata kanë një kulturë të dobët në mbrojtje të mjedisit dhe të mirës publike dhe kontributi i tyre vullnetar për tu angazhuar në ruajtjen e mbrojtjen e mjedisit është në nivel të ulët. Megjithatë është bërë shumë për ndërgjegjësimin për problematikat mjedisore në ambientin ku ata jetojnë.

¹² SHËNIM: Alternativat e lëna për informim mbase janë të limituara dhe përmes medias nuk kuptohet internet (facebook, etj) që ndoshta mund të ndryshojë rezultatin. Në një studim të bërë së fundi për “Matjen e Perceptimit të Mjedisit nga Publiku 2015”, 85% ishin për median dhe 15.7% për takime publike.

IV. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE

4.1 Vizioni

Vizioni i PVMMU të Bashkisë u formëzua si një proces i analizimit, diskutimit dhe konsultimeve me palët e interesuara të përfshira drejtpërdrejtë në përgatitjen e planit (Grupi i Punës dhe Kryetari Bashkisë, grupi i ekspertëve nga Milieukontakt dhe Inter-Cooperation).

Në fund, duke iu referuar statusit aktual të menaxhimit të mbetjeve, prioritetëve të përgjithshme dhe konkrete si dhe pritshmërive lokale për zhvillimin e këtij sektori, vlerave dhe normave qytetare, realitetëve dhe sfidave, dhe dëshirës e bindjes për ndryshim, u ra dakord që vizioni i bashkisë të jetë:

“Bashkia Shijak synon një mjedis të pastër me cilësi të lartë në vazhdimësi, falë punës dhe kontributit të përbashkët të komunitetit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke synuar ndarjen në burim në të gjithë territorin, për një jetesë të shëndetshme”.

4.2 Objektivat

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Mbetjeve kanë përcaktuar 3 periudha të rëndësishme kohore: faza e parë dhe e dytë (2010-2015 dhe 2015-2020) ku synohet përparimi drejt standardeve të BE dhe faza e tretë (2020-2025) ku synohet arritja e standardeve dhe objektivave të BE.

Në këtë kuadër ky plan synon progresin gradual drejt përmirësimit të situatës aktuale drejt standarteve kombëtare e ndërkombëtare. Plani do të adresojë nevojat lokale për periudhën 5 vjeçare 2017-2021. Fokusi në këtë fazë do të jetë në marrjen e masave emergjente gjatë vitit 2016 për të ndryshuar situatën, përmirësimin e performancës bashkiake për mbledhjen, transportin dhe depozitimin e sigurt të mbetjeve, pastrimin e qytetit si dhe rritjen e eficiencës dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara. Siç rekomandohet në politikën kombëtare të mbetjeve, në 2017, *landfilli* do të jetë metoda kryesore për menaxhimin e mbetjeve urbane.

Menaxhimi në nivel lokal do të përfshijë zbatimin e skemave të minimizimit të mbetjeve në qytetin e Shijakut në Lagjen Erzen pjesën lindore të tij (kufizuar nga rrugët Brigada e 10 Sulmuese, Vesel Xhepaxhiu, e Ali Efendi Shahini) dhe shkollat e qytetit, për të reduktuar në mënyrë progresive mbetjet për groposje/djegje. Në të njëjtën kohë do të synojë rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe përmirësimin e financave bashkiake për menaxhimin e mbetjeve.

Për periudhën 2017-2021 synimet do të jenë në arritjen e objektivave strategjike kombëtarë, në përputhje me standardet e legjislacionit të Komunitetit Evropian dhe principet e mbetjeve, për të minimizuar sasinë e mbetjeve që shkojnë në *landfill*.

Në vijim të përmbushjes të vizionit të planit si dhe bazuar në objektivat kombëtarë, u përcaktuan drejtimet strategjike dhe objektivat vendore për një periudhë 5 vjecare, si më poshtë:

Infrastruktura dhe Mjedisi

- Përmirësimi i shërbimit të MM duke përdorur teknologji bashkëkohore
- Ofrimi i shërbimit cilësor, në kohë dhe në të gjithë territorin
- Reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit
- Përputhshmëria me objektivat kombëtare duke nxitur minimizimin e mbetjeve në burim
- Kontribut në Planin e Përgjithshëm Vendor lidhur me menaxhimin e mbetjeve

Ndërgjegjësimi i komunitetit

- Sensibilizimi i komunitetit dhe biznesit për t'u bërë pjesë e iniciativave të bashkisë
- Rritja e transparencës dhe e përgjegjshmërisë ndaj komunitetit të Shijakut

Forcimi Institucional

- Forcimi i kapaciteve të stafit për menaxhimin dhe monitorimin e mbetjeve
- Forcimi i zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve
- Forcimi i koordinimit ndërinstytucional për një menaxhim të integruar të mbetjeve

Ekonomia dhe financat

- Forcimi i kuadrit financiar të menaxhimit të mbetjeve (Arritja e mbledhjes së taksës së pastrimit gjatë periudhës 5 vjeçare në masën 80% për të rritur të ardhurat në funksion të menaxhimit të mbetjeve)
- Krijimi i një sistemi financiar të qëndrueshëm

4.3 Objekti i Planit

4.3.1 Rryma e mbetjeve, objekti i planit

Në bazë të legjislacionit ekzistues, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbetjeve bashkiake për të cilën Bashkia e Shijakut është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse.

Sipas përbërjes dhe mënyrës së menaxhimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen në:

- **Mbetje urbane** (ushqim, bimë, të riciklueshme, të dekompozuar, etj¹³.), dhe
- **Mbetje të veçanta bashkiake** (mbetje inerte e ndërtimore, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;
- **Mbetje të rrezikshme** që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm.

Në lidhje me burimet e gjenerimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake ndahen në dy rryma mbetjesh, sipas burimit të origjinës: (MF) mbetjet e prodhuara nga familjet; (MB) mbetjet e prodhuara nga bizneset dhe industritë, ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane. Ndërkohë, rryma të tjera mbetjesh klasifikohen si mbetje masive, mbetje të ngurta (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen ‘mbetje të veçanta’ për të cilat njësia vendore duhet t’i ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

4.3.2 Integrimi me aktet nënligjore dhe dokumentet e tjera strategjike vendore dhe rajonale, që nuk lidhen drejtpërsëdrejti me mbetjet

Me qëllim efektivitetin dhe integrimi me planet, strategjitë, aktet nënligjore apo studimet të tjera në nivel rajonal dhe vendor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit, ky plan vendor për menaxhimin e mbetjeve ka marrë parasysh përcaktimet e këtyre dokumentave, ndërkohë që përcakton objektivat, identifikon apo vlerëson mundësitë për realizimin e tyre.

Plani i Zhvillimit të komunitetit 2008-2015¹⁴: një nga qëllimet e tij ishte zhvillimi urban dhe mjedisor me objektiv *Rruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit natyror e dy programe (i) Përmirësimin e Menaxhimit të mjedisit dhe (ii) Investimet në favor të Mjedisit.*

¹³ Siç përshkruhet në “Karakteristikat e Mbetjeve”

¹⁴ Bashkia Shijak, me mbështetjen e Këshillit të Europës dhe zyrës së OSBE.

Në Planin e Zonave Funktionale hartuar me asistencë të dldp një nga projektet e identifikuar dhe të votuara si fitues nga komuniteti ishte *Menaxhimi i Mbetjeve Urbane në Bashki*.

PVMMU merr në konsideratë dhe Draft Planin Vendor të Zhvillimit të Bashkisë i cili sugjeron zgjerim të landfillit të Durrësit në vendin aktual dhe vendosjen e koshave në pjesën e bregut të Lumit Erzen që do të rikualifikohet si zonë rekreative.

4.3.3 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit

Në funksion të organizimit më të mirë të shërbimeve dhe eficiencës së sistemit që do të propozohet, rekomandohet që zona e mbetjeve ose zona brenda kufijve administrative të bashkisë të ndahen në nën-zona mbetjesh që kanë diferenca në lidhje me tipologjinë urbane, infrastrukturën rrugore apo llojin e konsumatorëve ose sipas katër njësive administrative. Kjo është e rëndësishme që sistemet dhe metodat që do të identifikohen dhe analizohen në vijim të këtij plani të përshtaten më mirë me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve. Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, si dhe shërbime të tjera të ngjashme apo organizimin e programeve për minimizimin e mbetjeve. Për këtë qëllim, zona e mbetjeve ndahet në këto nënzona:

- i. **Nën-zona e Parë:** Përcaktuar në figurën më poshtë me "1", karakterizohet si zona urbane e qendrës së Bashkisë së Shijakut, ku janë përqëndruar pjesa më e madhe e bizneseve, shkollave dhe institucioneve të tjera, si dhe zonë urbane me densitet të lartë. Në këtë zonë ndodhen pjesa më e madhe e pallateve/banesave (rreth 48 banesa të përbashkëta dhe 1,689 banesa individuale). Grumbullimi i inerteve nuk kryhet fare nga kompania, kontenerët janë të pakët rreth 26 dhe nuk janë në gjendje të mirë. Shpesh ka mbetje rreth tyre. Mbetjet depozitohen në Porto Romano 16 km larg. Shërbimet e parashkuara në këtë zonë janë largimi i mbetjeve çdo ditë, fshirja e rrugës kryesore çdo ditë si dhe larja e rrugës kryesore dy herë në ditë gjatë periudhës së verës.




Figura 11 Zonat e administrimit të mbetjeve në bashkinë e Shijakut

- ii. **Nën-zona e Dytë:** Ilustruar me “2” në figurën e mëposhtme, karakterizohet si zona gjysëm-urbane/rurale (Xhafzotaj). Zona që shtrihet në pjesën lindore dhe jugore të qytetit është zonë e pastër banimi me shtrirje lineare, me banesa private me oborre të mëdha, të cilat zenë mbi 50% të numrit të banesave në gjithë bashkinë. Ka rritje të numrit të banorëve, bizneseve. Janë krijuar 3-4 vend depozita ilegale mbetjesh, grumbullimi i inerteve dhe i të gjelbrave nuk kryhet fare nga kompania (nuk është pjesë e kontratës). Mblidhen vetëm mbetjet shtëpiake (me qese);
- iii. **Nën-zona e Tretë:** që përfshin nënzonën “3” (Maminas) në figurën e mëposhtme, karakterizohet nga një zonë industriale me dendësi mesatare, me rreth 4 banesa kolektive dhe 1,900 banesa rezidenciale dhe biznese të vendosur kryesisht përgjatë autostradës. Infrastruktura është e mirë. Në këtë zonë ofrohet shërbimi i mbledhjes dhe largimit të mbetjeve duke mbuluar totalisht këtë zonë. Ka një vend depozitim ilegal të mbetjeve. Grumbullimi i mbetjeve kryhet me kamion dhe me qese dhe depozitohen rreth 25 km larg nga Porto Romano.
- iv. **Nën-zona e Katërt:** shënuar me “4”, është një zonë rurale (Gjepalaj). Kjo njësi administrative po ofron shërbim për herë të parë vetëm në vitin 2016, banorët nuk kanë paguar ndonjëherë detyrime administrative. Nuk ekzistojnë PGM, janë krijuar rreth 3 vende ilegale mbetjesh. Banorët janë mësuar t’i djegin mbetjet, kjo del edhe nga pyetësori i punuar me qytetarët (6%).

4.4 Skenarët e administrimit të mbetjeve

Skenarët në lidhje me menaxhimin e mbetjeve është mirë të përqëndrohen në mbledhjen e mbetjeve urbane dhe elementët e tjerë si ndarja e mbetjeve, riciklimi, kompostimi etj., të lidhen drejtpërdrejt me metodën e zgjedhur të mbledhjes së mbetjeve.

Shërbimet e pastrimit dhe alternativat e depozitimit të mbetjeve urbane, riciklimi, kompostimi dhe menaxhimi i mbetjeve voluminoze janë pjesë e sistemit dhe rrjedhojë e skemës së përzgjedhur nga bashkia për grumbullimin e mbetjeve. Kështu duke marrë në konsideratë që sistemi në bashkinë Shijak bazohet në një sistem me pika të përbashkëta, iniciativat për ndarjen e mbetjeve duhet të fokusohen në sistemin e përbashkët me tre kosha, ose me 4 kosha në të ardhmen nëse do kemi ndonjë iniciativë lokale apo rajonale për riciklimin apo kompostimin e mbetjeve.

Më poshtë është një skemë e zakonshme se si mund të menaxhohen mbetjet në bashki, duke konsideruar dhe aktivitetet e mësipërme:




Figura 12 Skema idelae e mbledhjes së mbetjeve

4.4.1 Menaxhimi i mbetjeve bazuar ne objektivat rajonale dhe kombëtare

Duke u kthyer tek objektivat e përcaktuara në planin rajonal të Durrësit, të mbështetura në Strategjinë e PKMM, theksohet:

- të bëhet grumbullim i diferencuar për 20%-30% të mbetjeve brenda 7 viteve që nga miratimi i planit, pra deri në vitin 2018.
- të bëhet grumbullim i diferencuar për 50% të mbetjeve brenda 10 viteve që nga miratimi i Planit, pra deri në vitin 2021.

Nëse Bashkia do të zbatonte këto objektiva afatshkurtër deri në vitin 2018 dhe afatmesëm deri në vitin 2021, sipas skemës së mësipërme të administrimit të mbetjeve, pra do të diferenconte mbetjet në burim dhe do t'i grumbullonte në kontenierë të vecantë, atëherë sasia e mbetjeve që do të përfundonin në landfill, do të ishte si më poshtë:

Tabela 20. Politikat e PRMM

| Objektivat sipas PRMM | Njesia | v.2016 | v.2017 | v.2018 | v.2019 | v.2020 | v.2021 |
|--|----------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Politikat rajonale për grumbullim të diferencuar | Në % | 0% | 20% | 30% | 35% | 40% | 50% |
| Do të përfundojnë në landfill | ton/vit | 8,440 | 7,893 | 6,929 | 6,466 | 5,997 | 5,022 |
| Riciklohen dhe kompostohen | ton/vit | - | 1,973 | 2,970 | 3,482 | 3,998 | 5,022 |

Pra, bazuar në skenarin optimist të mësipërm do të shkonin në landfill mbetje të riciklueshme dhe të kompostueshme në sasi shumë më të vogël dhe kjo do të sillte indirekt jo vetëm përdorim eficient të landfillit, por edhe kursim të kostos së bashkisë për trajtimin e mbetjeve në landfill.

Sasia e mbetjeve që shmangen nga landfilli

Pra, bashkia nëse do të aplikonte një skenar të tillë, pra nëse banorët dhe bizneset do të ndanin një pjesë të vogël të mbetjeve që në burim dhe ato do të grumbulloheshin dhe transportoheshin në destinacionin e duhur, atëherë sasia e mbetjeve që do të përfundonin në landfill do të ulej nga viti në vit.

Tabela e mëposhtme tregon sasinë e mbetjeve sipas fraksioneve që do të shmanget nga venddepozitimi dhe mund të përdoret nga industria ricikluese apo kompostuese.

| Mbetjet që shmangen nga landfilli sipas fraksioneve | Njesia | v.2016 | v.2017 | v.2018 | v.2019 | v.2020 | v.2021 |
|---|----------------|----------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Leter&Karton | ton/vit | - | 266 | 401 | 470 | 540 | 678 |
| Plastike | ton/vit | - | 256 | 386 | 453 | 520 | 653 |
| Qelq | ton/vit | - | 118 | 178 | 209 | 240 | 301 |
| Tekstile | ton/vit | - | 104 | 157 | 185 | 212 | 266 |
| Metale | ton/vit | - | 22 | 33 | 38 | 44 | 55 |
| Të biodegradueshme | ton/vit | - | 1,207 | 1,815 | 2,127 | 2,444 | 3,069 |
| TOTALI | | 0 | 1,973 | 2,970 | 3,482 | 3,998 | 5,022 |

Tabela 21 Mbetjet sipas fraksioneve që nuk depozitohen në landfill

Kosto depozitimi që kursehet

Si rezultat i aplikimit të objektivave të PRMM, atëherë bashkia kursen:

- ✓ **Kosto depozitimi të mbetjeve në landfill** si më poshtë. Tarifa e depozitimit është konsideruar ajo që Bashkia aktualisht paguan për trajtimin e mbetjeve në Porto Romano, 200 lekë/ton.

| Kosto depozitimi që kursehet | Njësia | v.2017 | v.2018 | v.2019 | v.2020 | v.2021 |
|---|----------|----------|----------|----------|----------|------------|
| Tarifa e depozitimit në landfill | Lekë/ton | 200 | 200 | 200 | 200 | 200 |
| Sasia e mbetjeve që diferencohen sipas PRMM dhe nuk shkojnë në landfill | Ton/vit | 1,970 | 2,970 | 3,482 | 3,998 | 5,022 |
| Përfitimi i bashkisë nga kursimi i kostos së depozitimit në landfill | Lekë | -394,000 | -594,000 | -696,400 | -799,600 | -1,004,400 |

Tabela 22 kosto depozitimi të mbetjeve në landfill

✓ Kosto transporti të mbetjeve në landfill

Në Durrës dhe Shijak operojnë disa firma ricikuese, të cilat mund të hynin në partneritet me bashkinë për mbledhjen dhe trajtimin më tej të mbetjeve të riciklueshme, gjë që do të sillte dhe kursim të kostos së transportit të tyre në destinacionin e biznesit riciklues. Pra, mund të mbledhin derë më derë mbetjet e riciklueshme ose mund të marrin direkt nga kontenerët e veçantë mbetjet e riciklueshme. Në këtë rast, kompania që ofron shërbimin, shmang transportin në landfill të kësaj sasive mbetjesh.

| Kosto transporti që kursehet | Njësia | v.2017 | v.2018 | v.2019 | v.2020 | v.2021 |
|--|----------|----------|------------|------------|------------|------------|
| Kosto transporti | Lekë/ton | 469 | 468 | 466 | 463 | 461 |
| Sasia e mbetjeve që diferencohen dhe nuk shkojnë në landfill | Ton/vit | 1,970 | 2,970 | 3,482 | 3,998 | 5,022 |
| Përfitimi i bashkisë nga kursimi i kostos së transportit | Lekë/vit | -924,681 | -1,389,356 | -1,620,984 | -1,852,189 | -2,315,323 |

Tabela 23 kosto transporti që kursehet nga mosdepozitimi i mbetjeve në landfill

4.4.2 Administrimi i mbetjeve bazuar në grumbullimin miks të tyre

Duke ju referuar gjëndjes aktuale të shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve si dhe eksperiencës, arritjeve dhe problematikës të identifikuar në kapitujt e mëparshëm të këtij plani, nënvizojmë se shërbimi i ofruar mbetet brenda nivelit mesatar, të krahasueshëm me atë në nivel kombëtar, por që Bashkia Shijak është e motivuar dhe angazhuar të ndryshojë rrënjësisht këtë situatë duke synuar si përmirësimin e nivelit aktual në lidhje me cilësinë, efikasitetin dhe efektshmërinë, por gjithashtu të krijojë një bazë të qëndrueshme mbi të cilën do të mbështeten iniciativat lokale dhe rajonale për minimizimin e mbetjeve.

Në këtë kuadër minimizimi drejt zgjidhjes përfundimtare të problemeve si: numri i pamjaftueshëm i kontenerëve, depozitimi i mbetjeve jashtë kontenerëve, hedhja pa kriter e mbetjeve dhe mbulimi më i mirë i zonës më këtë shërbim, mbeten objektiva për tu zgjidhur në

një periudhë afatshkurtër, (brenda dy viteve nga zbatimi i këtij plani), por që duhen parë të lidhura me sistemet dhe masat për minimizimin e mbetjeve.

Duke kaluar në një përfaqje teknike, ekzistojnë mënyra të ndryshme për grumbullimin, ruajtjen dhe largimin e mbetjeve në funksion të tipeve të ndryshëm të konsumatorëve, të përshtatshme për tipologjinë urbane apo karakteristikave të tjera të zonës dhe konsumatorëve të tij. Sipas legjislacionit aktual dhe tipologjisë së zbatuar më së shumti për mbledhjen e mbetjeve, bashkia është përgjegjëse për të mbledhur vetëm “mbetjet urbane” sipas përcaktimeve të dokumentave ligjorë dhe të këtij plani. Mbetje të tjera që ndryshojnë në përmbajtje (përbërje) nga mbetjet urbane nuk pranohen nga sistemi i bashkiak për mbledhjen e mbetjeve.

Për disa mbetje të ashtuquajtura “të veçanta” që prodhohen nga banorët mund të organizohen metoda për mbledhjen e tyre në mënyrë të diferencuar nga sistemi publik (bazë) bashkiak. Ekzistojnë kufizime të tjera për përdorimin e sistemit bazë bashkiak të grumbullimit të mbetjeve që lidhet me madhësinë dhe sasinë e mbetjeve veçanërisht nga konsumatorët jo-banorë. Duke iu referuar përcaktimeve ligjore (Neni 12 i Ligjit Nr. 8094/1996), mbetjet e konsumatorëve jo-banorë që prodhojnë mbi $\frac{1}{4}$ e sasisë që mund të vendosen në një kontenjer mbetjesh (zakonisht 1.1 m^3) nuk lejohen të përdorin sistemin publik të mbledhjes së mbetjeve. Autoritetet vendore apo personat përgjegjës për mbledhjen e mbetjeve duhet të ofrojnë mundësi dhe metoda të tjera për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve, në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të konsumatorëve, shoqëruar me një sistem të ndryshëm tarifash.

Në funksion të përcaktimeve të mësipërme, ekzistojnë disa alternativa të mundshme për mënyrën e organizimit të shërbimit të mbledhjes dhe largimit (transportit) të mbetjeve. Këto alternativa lidhen me organizimin, infrastrukturën e nevojshme, rregullsinë dhe specifikime të tjera. Për secilën alternativë Bashkia nënvizon avantazhet dhe disavantazhet në lidhje me zbatueshmërinë, efektivitetin, mjedisin dhe burimet natyrore si dhe pranueshmërinë shoqërore. Ka edhe ndryshime mes alternativave për sa i përket përfshirjes së konsumatorit (qëndrimi pasiv apo aktiv).

Skema e grumbullimit mix të mbetjeve

Mbledhja dhe largimi/transporti i mbetjeve bazohet në përfaqjen e zakonshme të organizimit të menaxhimit të mbetjeve. Kjo skemë e mbledhjes dhe largimit të mbetjeve është një vazhdim i skemës aktuale të mbledhjes së mbetjeve (grumbullimit¹⁵ të mbetjeve në anë të rrugës) dhe mbështetet në një sistem të përbashkët të grumbullimit të mbetjeve, ku konsumatorët janë të detyruar të nxjerrin jashtë dhe depozitojnë mbetjet urbane ditore ose të një periudhe të caktuar, pranë pikave të miratuara (PGM), ndërsa operatori i shërbimit mundëson mbledhjen

¹⁵ “Grumbullimi i mbetjeve”: nënkupton mbledhjen dhe largimin e mbetjeve

dhe largimin e mbetjeve urbane për në vendin e përcaktuar për trajtimin apo depozitimin final të tyre.

Më poshtë paraqitet skema e thjeshtë e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shijak.




Figura 13 "Skema e menaxhimit miqs të mbetjeve "

Pra, sipas skemës, familjet, bizneset dhe institucionet çojnë në pikat e grumbullimit ku janë vendosur kontenierët të gjitha mbetjet e gjeneruara dhe më pas nëpërmjet mjeteve të transportit ato destinohen në venddepozitimin/ landfillin më të afërt, ku realizohet dhe trajtimi i mëtejshëm i tyre.

Vendodhja e PGM

Duke iu referuar sistemit aktual të PGM-ve dhe problematikës që lidhet me to, çështjet për tu marrë në konsideratë janë:

- ✓ Eshtë e rëndësishme që shpërndarja e PGM të mbulojë sa më shumë zonën e mbetjeve në mënyrë që konsumatorët të kenë mundësi dhe lehtësi për t'i përdorur për hedhjen e mbetjeve, por që njëkohësisht duhet të mundësohet infrastruktura rrugore e nevojshme për vendosjen e PGM-ve dhe lëvizjen e makinës teknologjike.
- ✓ Vendodhja dhe dendësia e tyre lidhet drejtpërsëdrejti me vendodhjet e zonave urbane dhe rezidenciale si dhe dendësinë e tyre si dhe kushtin e infrastrukturës dhe disponueshmërisë së hapësirës së nevojshme. Kështu për zona të ndryshme brenda

qytetit (sipas klasifikimit të bërë me siper) kemi distanca të ndryshme midis PGM-ve apo largësi të ndryshme të tyre nga konsumatorët.

Në tabelën e mëposhtme rekomandohen disa standarde të largësisë mesatare mes llojeve të ndryshme të zonave urbane ku respektimi i tyre varet nga infrastruktura e përshtatshme dhe hapësirat e nevojshme për vendosjen e PGM.

| Tipet e zonave | Shumë të dendura | Të dendura | Mesatar | Të rralla |
|-----------------------|------------------|------------|---------|-----------|
| Distanca mesatare (m) | 50-100 | 100-150 | 150-200 | 200-250 |

Tabela 24 Dendësia e PGM-ve

Mbështetur dhe në standardet e mësipërme, pikat për grumbullimin e mbetjeve do të respektojnë standartin dhe sipas çdo zone mbetjesh pasqyrohen në tabelën e mëposhtme. Në çdo pikë Bashkia do të vendosë në zonë të paktën 1-2 kontenierë në çdo pikë. Në zonat me densitetit të familjeve dhe bizneseve mund të vendosen edhe tre kontenierë.



Figura 14. Harta e pikave të grumbullimit në zonën e mbetjeve Shijak




Figura 15. Harta e pikave të grumbullimit në zonën e mbetjeve Xhafzotaj




Figura 16. Harta e pikave të grumbullimit në zonën e mbetjeve Maminas



Figura 17. Harta e pikave të grumbullimit në zonën e mbetjeve Gjejalaj

Kapaciteti dhe infrastruktura

Për të përcaktuar infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e skemës së përbashkët për grumbullimin e mbetjeve duke marrë parasysh nevojat reale të zonës së mbetjeve dhe synim përmbushjen e objektivave për përmirësimin e shërbimit, u realizua analiza për llogaritjen e infrastrukturës së nevojshme: kontenierët dhe makinat teknologjike. Për të konkluduar me analizën e mësipërme, më parë përcaktohet kapaciteti i përshtatshëm i kontenierëve si dhe frekuenca e dëshirueshme e shërbimit. Kontenierët me volum 1.1m^3 (që përdoren aktualisht në qytet si dhe gjerësisht të përdorshëm në vend dhe rajon), rekomandohen si më të përshtatshëm për këtë skemë grumbullimi mbetjesh. Gjithashtu rekomandohet që kontenierët

të jenë metalik dhe vaskë (trashësi 1.5-2 mm) dhe sistem rrotash të qëndrueshëm, për të mundësuar qëndrueshmërinë e tyre nga ndikimi i faktorëve të jashtëm.

- **Të dhëna mbi popullsinë dhe bizneset**

Për parashikimin e numrit të popullsisë për vitet 2017-2021 u konsiderua:

- Popullsia sipas RrC dhe popullsia sipas Census 2011, por e korrigjuar me të njëjtën metodë që llogaritet popullsia për çdo bashki për efekt të përfitimit të transfertës së pakushtëzuar nga qeverisja qendrore.
- Rritja mesatare me 0.5% e popullsisë për çdo vit
- Bizneset dhe Institucionet për periudhën 2017-2021, do të konsiderohen ato që janë regjistruar në vitin 2016

Tabela e mëposhtme pasqyron numrin total të banorëve, bizneseve dhe institucioneve për periudhën 2017-2021:

| Nr | Popullsia | V.2016 | | | Planifikimi 2017-2021 | | | | |
|----|---------------|------------------------|--------------------|---------------|-----------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| | | Popullsia e korrigjuar | Biznese& Instituc. | Total | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
| | | Nr | Nr | Nr | Nr | Nr | Nr | Nr | Nr |
| I | Totali | 32,906 | 888 | 33,794 | 33,958 | 34,123 | 34,290 | 34,457 | 34,624 |
| 1 | Shijak | 9,263 | 305 | 9,568 | 9,614 | 9,661 | 9,708 | 9,755 | 9,802 |
| 2 | Xhafzotaj | 14,186 | 399 | 14,585 | 14,656 | 14,727 | 14,799 | 14,871 | 14,943 |
| 3 | Maminas | 5,258 | 152 | 5,410 | 5,437 | 5,463 | 5,490 | 5,516 | 5,543 |
| 4 | Gjepalaj | 4,198 | 32 | 4,230 | 4,251 | 4,272 | 4,294 | 4,315 | 4,336 |

i. Gjenerimi i mbetjeve nga çdo zonë mbetjesh

Duke i shtuar numrit të popullsisë së korrigjuar te vitit 2016 dhe numrin e bizneseve, bazuar dhe në totalin e mbetjeve të gjeneruara prej 26.9 ton/ditë apo 9,804 ton/vit sipas normave të pranuar kombetare, rezulton një normë mesatare gjenerimi prej 0.79 kg/njësi/ditë.

Referuar shpërndarjes së bizneseve dhe institucioneve sipas çdo njësie administrative dhe gjenerimit ditor të mbetjeve nga çdo konsumator, rezulton që normat mesatare të gjenerimit të mbetjeve dhe gjenerimi ditor në çdo zonë mbetjesh të jetë si më poshtë:

| Gjeneruesit | Shijak | | | Xhafzotaj | | | Maminas | | | Gjepalaj | | |
|-----------------------|--------------|-------------|-------------|---------------|-------------|-------------|--------------|-------------|------------|--------------|-------------|------------|
| | kg/njesi/ | | | kg/njesi/ | | | kg/njesi/ | | | kg/njesi/ | | |
| | Nr | dite | Ton/ dite | Nr | dite | Ton/ dite | Nr | dite | Ton/ dite | Nr | dite | Ton/ dite |
| Banorët urbanë | 9,263 | 0.7 | 6.48 | | | | | | | | | |
| Banorët gjysëm urbane | | | | 14,186 | 0.6 | 8.5 | 5,258 | 0.6 | 3.2 | | | |
| Banorët rurale | | | | | | | | | | 4,198 | 0.4 | 1.7 |
| Bizneset (e vogla) | 250 | 6 | 1.5 | 267 | 6 | 1.6 | 109 | 6 | 0.7 | 12 | 6 | 0.1 |
| Bizneset e medha | 40 | 15 | 0.6 | 114 | 15 | 1.7 | 32 | 15 | 0 | 3 | 15 | 0.0 |
| Institucionet | 15 | 6 | 0.09 | 18 | 6 | 0.1 | 11 | 6 | 0.1 | 17 | 6 | 0.1 |
| Shuma | 9,568 | 0.91 | 8.67 | 14,585 | 0.82 | 11.9 | 5,410 | 0.80 | 4.4 | 4,230 | 0.45 | 1.9 |

Tabela 25 Konsumatorët dhe gjenerimi i mbetjeve për vitin 2017

Ndërsa gjenerimi i mbetjeve për vitet 2017-2021, bazuar në normat e mësipërme të gjenerimit, për çdo zonë mbetjesh është si më poshtë:

| Mbetje te gjeneruara | Gjenerimi vjetor 2017-2021 (ton/vit) | | | | |
|----------------------|--------------------------------------|--------------|--------------|--------------|---------------|
| | v.2017 | v.2018 | v.2019 | v.2020 | v.2021 |
| Z.1 Shijak | 3,193 | 3,197 | 3,212 | 3,228 | 3,243 |
| Z.2 Xhafzotaj | 4,387 | 4,397 | 4,419 | 4,440 | 4,462 |
| Z.3 Maminas | 1,588 | 1,605 | 1,613 | 1,621 | 1,629 |
| Z.4 Gjepale | 698 | 700 | 703 | 707 | 710 |
| TOTALI | 9,866 | 9,899 | 9,947 | 9,996 | 10,044 |

Tabela 26 Gjenerimi i mbetjeve për vitet 2017-2021

Pjesa më e madhe e mbetjeve gjenerohen nga Zona Xhafzotaj, rreth 45%.

ii. Llogaritja e numrit të nevojshëm të kontenierëve

Llogaritja e kontenierëve të domosdoshëm për grumbullimin e mbetjeve është në funksion të tre faktorëve të domosdoshëm që janë gjenerimi i mbetjeve nga familjet, biznesi dhe institucionet, frekuenca e mbledhjes s tyre dhe kapaciteti i kontenierit. Lloje të tjera mbetjesh si ato bujqësore, inertet apo ndonjë lloj tjetër mbetjesh “të mëdha” duhet të përjashtohen dhe eliminohen nga vetë prodhuesit.

Një kontenier tipik ka një vëllim $1.1m^3$, i cili ka një kapacitet maksimal mbajtës prej rreth 0,1 ton mbetjesh të ngurta, në qoftë se konsiderojmë një dendësi të përgjithshme prej $0.11 \text{ ton}/m^3$ për mbetjet. Kjo dendësi është matur në disa njësi vendore gjatë një fushate peshimi, por që është subjekt i ndryshimeve sipas përbërjes së mbetjeve.

Tabelat e mëposhtme përmbledhin nevojat aktuale për kontenerë ne vitin 2017, në zbatim të skemës së përbashkët të grumbullimit miks të mbetjeve:

| | Sasia e mbetjeve 2017 | Sasia mesatare ditore | Frekuenca e propozuar | Densiteti mesatar I mbetjeve | Kapaciteti konteniereve | Koeficienti mbushjes | Nevoja per konteniere |
|-------------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|------------------------------|-------------------------|----------------------|-----------------------|
| | ton/vit | ton/ ditë | Ditë/ javë | ton/m ³ | m ³ | % | v.2017 |
| Zona 1 Shijak | 3,181 | 8.7 | 7 | 0.125 | 1.1 | 85% | 75 |
| Zona 2 Xhafzotaj | 4,376 | 12.0 | 7 | 0.125 | 1.1 | 85% | 103 |
| Zona 3 Maminas | 1,597 | 4.4 | 7 | 0.125 | 1.1 | 85% | 37 |
| Zona 4 Gjepalaj | 696 | 1.9 | 2 | 0.125 | 1.1 | 85% | 57 |
| Total | 9,850 | 27.0 | | 0.125 | 1.1 | 85% | 272 |

Tabela 27 Llogaritja e numrit të konteniervë për vitin 2017

Pra, për mbledhjen mix të mbetjeve sipas frekuencave të propozuara, bashkia duhet të shpërndajë në vitin 2017 në territorin e saj 272 kontenerë në pikat e përcaktuara sipas hartës së mësipërme (ose tabelës).

Për vitet e tjera, bashkia duhet të shtojë numrin e konteniervë në funksion të rritjes së gjenerimit të mbetjeve. Pra, sipas tabelës së mëposhtme numri i konteniervë në vitin 2021 do të jetë 277 kontenerë ose 245 kontenerë më shumë se në vitin 2016 dhe më pas 5 kontenerë më shumë se në vitin 2017. Duke patur parasysh edhe amortizimin sidomos të konteniervë ekzistues gjatë vitit, ky numër patjetër që duhet të jetë më i madh.

| Numri i konteniervë sipas zonave | v.2016 | Parashikimi I kontinerëve 2017-2021 | | | | |
|----------------------------------|-----------|-------------------------------------|------------|------------|------------|------------|
| | | v.2017 | v.2018 | v.2019 | v,2020 | v.2021 |
| Zona 1 Shijak | 26 | 75 | 75 | 75 | 76 | 76 |
| Zona 2 Xhafzotaj | | 103 | 103 | 104 | 104 | 105 |
| Zona 3 Maminas | | 37 | 38 | 38 | 38 | 38 |
| Zona 4 Gjepalaj | 6 | 57 | 57 | 58 | 58 | 58 |
| Total | 32 | 272 | 273 | 275 | 276 | 277 |

Tabela 28 Numri i nevojshëm i konteniervë për vitet 2017-2021

iii. Makinat për grumbullimin e mbetjeve

Kamionët tipikë për grumbullimin e mbetjeve janë zakonisht vetëngjeshës me kapacitet 5 dhe 10 ton. Këta kamionë sugjerohen për t'u përdorur në varësi të tipit dhe popullsinë së njësisë.

Normalisht një zonë rurale përdor kamionë me kapacitet 5 ton, ndërsa një zonë urbane kamionë me kapacitet 10 ton. Numri i kamionëve varion bazuar në sasinë e mbetjeve për t'u mbledhur dhe numrin e turneve të nevojshme për çdo kamion. Kapaciteti aktual i ngarkimit për një përbërje tipike mbetjesh është rreth 85% të kapacitetit total mbajtës të kamionit.

Bashkia Shijak për specifikën e zonës, do të përdorë për zonën e Shijakut kamion 10 ton, ndërsa për zonën Xhafzotaj Maminas dhe Gjepalaj do të përdorë kamion 5 ton. Në funksion të variablave të mësipërm, pra të sasisë ditore të mbejeve të gjeneruara, punës me dy turne dhe kapacitetit mbushës, bashkisë i nevojiten rreth 2 kamionë (një kamion 10 ton dhe një kamion 5 ton).

| Zonat e Mbetjeve | Sasia e mbetjeve 2017 | Sasia mesatare ditore | Numri i rrugëve/dite | Kapaciteti i mjeteve | Kapaciteti i mbushjes | Nevoja per makina |
|-------------------------|-----------------------|-----------------------|----------------------|----------------------|-----------------------|-------------------|
| | (ton/vit) | (ton/dite) | Rruge/dite | ton | % | Nr. |
| Zona 1 Shijak | 3,181 | 8.7 | 2 | 10 | 85% | 0.51 |
| Zona 2 Xhafzotaj | 4,376 | 12.0 | 2 | 10 | 85% | 0.71 |
| Zona 3 Maminas | 1,597 | 4.4 | 2 | 5 | 85% | 0.51 |
| Zona 4 Gjepalaj | 696 | 1.9 | 2 | 5 | 85% | 0.22 |
| Totali | 9,851 | 27.0 | | | | 2.0 |

Tabela 29 Nevojat aktuale për makina teknologjike

Deri në fund të vitit 2021 dy makinat teknologjike 5 ton dhe 10 ton janë të mjaftueshme për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në landfillin e Porto Romanos.

Ndonëse kjo analizë, ende nuk merr parasysh depozitimin e mbetjeve urbane në landfillin rajonal të Manzës (nëse do të mund të jetë një alternativë), makinat ekzistuese janë të mjaftueshme për të siguruar transportin e tyre me efikasitet.

- Intenerari i grumbullimit të mbetjeve dhe transporti i tyre

Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të aktiviteteve të grumbullimit dhe transportimit lidhen drejtpërsëdrejti me intinerarin e përzgjedhur të lëvizjes së makinës si dhe me kohën efektive të punës gjatë ndalesave në çdo PGM. Ulja e kohës së përgjithshme të mbledhjes, më saktë – kohës së ngarkimit, shmangies së rrugëve me gjysmë ngarkesë apo përdorimi i kamionëve të mirë me kapacitet më të mirë ngarkimi do të rrisin efektivitetin dhe efikasitetin e mbledhjes së mbetjeve¹⁶.

¹⁶ Koha e grumbullimit të mbetjeve për një pikë me 2 kontenierë të shkojë nga 2.5-3 min.

Për të përmirësuar kohën e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, duhet të merren në shqyrtim itinerarët aktualë në zbatim të parimeve të listuara më poshtë:

- Itinerarët nuk duhet të copëtohen apo të mbivendosen. Secili itinerar duhet të jetë kompakt, i përbërë nga segmentet e mbledhura në të njëjtën zonë gjeografike;
- Itinerari i mbledhjes duhet të nisë sa më pranë autoparkut që të jetë e mundur, duke marrë parasysh rrugët me trafik të madh dhe ato me një kalim;
- Rrugët me trafik të madh nuk duhet të bëhen gjatë orëve të pikut;
- Në rastin e rrugëve me një kalim, është më mirë të fillohet itinerari në fundin e sipërm të rrugës, duke kaluar poshtë saj në kahun e rregullt;
- Shërbimet në rrugët pa krye mund të konsiderohen si shërbime për segmente rruge që mund të ndërpriten, përderisa ato mund të mblidhen vetëm duke kaluar poshtë segmentit të rrugës. Për të mbajtur kthesat djathtas në minimum, (në vendet ku automjetet lëvizin në krahun e majtë), mbledhja e mbetjeve nga rrugët pa krye bëhet kur ato janë në të majtë të kamionit. Këto mbetje duhet të mblidhen duke ecur për poshtë, mbrapsht apo duke bërë një kthesë në formë U;
- Mbetjet në kodra të pjerrëta duhet të mblidhen, aty ku është praktike, në të dy krahët e rrugës kur kamioni po zbret për poshtë. Kjo lehtëson mbledhje të sigurt, të lehtë dhe të shpejtë. Kjo ul edhe amortizimin e automjetit si dhe kursen karburant.
- Për mbledhjen nga të dy krahët e rrugës në të njëjtën kohë, në përgjithësi është më mirë të bëhet itinerari në rrugë të drejtë sipas planit para se të kalohet në itinerarin në krahun e kundërt.

Pas verifikimit të plotësimit të parimeve të mësipërme, është e rëndësishme të bëhet matja/testimi i kohës reale të grumbullimit të mbetjeve.

4.4.3 Buxhetimi në bazë aktiviteti

Metodologjia e përdorur është buxhetimi në bazë të programit, mbështetur në ligjin 9936/2008 “Për menaxhimin financiar në RSH” dhe në ligjin organik 139/2015: “Për vetëqeverisjen vendore” ku sipas nenit 23 (pika 10) *Shërbimi i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve përfshihet në programin e shërbimeve publike.*

Llogaritja e kostos për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në Bashkinë e Shijakut, është bazuar në modelin e përgatitur nga dldp.

Përlllogaritja është bazuar në blloqet vijuese:

- a. Të dhënat përmbledhëse për zonën administrative,
- b. Investime kapitale (kamionë dhe kontenierët e nevojshëm),

- c. Kostot operative (mirëmbajtje, transport dhe personel),
- d. Kostoja për largimin në "landfill" (tarifa e depozitimit),
- e. Kostot e amortizimit (ri investimit),
- f. Kostot administrative

A. Fshirja dhe larja e rrugëve

Bashkia tashmë është duke përfunduar inventarizimin e rrugëve rurale, të cilat janë funksione të reja të saj. Bashkia synon përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar si dhe rritjen e zonës të mbuluar me shërbimet e pastrimit të rrugëve dhe shesheve, duke përfshirë gjithë zonën urbane dhe një pjesë të zonës rurale.

Aktualisht, mbulohet me shërbim fshirje sipërfaqja prej 65,490 m² rrugë, trotuare dhe sheshe ku 6% janë rrugët rurale të NjA Maminas-zonë industriale. Gjithashtu lahen çdo ditë gjatë periudhës së verës korrik-shtator 47,370 m² sipërfaqe.

Sipas objektivave të programit buxhetor afatmesëm, Bashkia Shijak do të krijojë një infrastrukturë më bashkëkohore, pra do të rritë sipërfaqet e rrugëve të asfaltuara, duke tentuar drejt përmirësimit të standartit jo vetëm të rrjetit rrugor të qytetit, por edhe në zonat rurale.

Metodologjia e pastrimit të rrugëve është jo shumë efikase (nuk përdoren makina fshesë) dhe kjo metodologji do të përdoret dhe për 5 vitet e ardhshme, pra do të vazhdohet të fshihet me punëtorë (në mënyrë manuale).

Politikat, objektivat dhe kostot e shërbimit

Politikat 2017-2021

i. Shërbimi i fshirjes së sipërfaqeve

- Bashkia do të përfshijë në shërbimin e fshirjes NjA Xhafzotaj dhe Gjepalaj, të cilat aktualisht nuk e përfitojnë këtë shërbim
- Do të vazhdojë fshirja e të njëjtës sipërfaqe në NjA Shijak dhe do të përfshihen në shërbimin e pastrimit sipërfaqet e reja të NjA të tjera që do të rikonstruktohen apo asfaltohen, sipas programit buxhetor afatmesëm të miratuar nga Bashkia dhe objektivave më afatgjatë në këtë sektor.

| NjA | Njësia | Sipërfaqet që do të fshihen | | | | | |
|-----|--------|-----------------------------|--------|--------|--------|--------|--------|
| | | v.2016 | v.2017 | v.2018 | v.2019 | v.2020 | v.2021 |
| | | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|----------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Shijak | m ² | 61,490 | 61,490 | 61,490 | 61,490 | 61,490 | 61,490 |
| Xhafzotaj | m ² | - | 6,000 | 8,500 | 11,000 | 11,000 | 16,000 |
| Maminas | m ² | 4,000 | 5,000 | 6,000 | 7,000 | 10,000 | 10,000 |
| Gjepalaj | m ² | - | - | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 |
| Gjithsej | m² | 65,490 | 72,490 | 80,990 | 84,490 | 87,490 | 92,490 |
| % e sipërfaqeve që fshihen ndaj totalit të sipërfaqeve gjithsej | | 26% | 28% | 32% | 33% | 34% | 36% |

Tabela 30 Sipërfaqet që do të fshihen në 5 vitet e ardhshme

ii. Shërbimi i larjes së sipërfaqeve

- Bashkia do të përfshijë në shërbimin e larjes për herë të parë sipërfaqet që do të fshihen në NjA Xhafzotaj dhe Gjepalaj
- Do të vazhdojë të lahet e njëjta sipërfaqe që fshihet në NjA Shijak dhe në vazhdim do të përfshihen në këtë aktivitet dhe sipërfaqet e reja që do të fshihen (në përgjithësi lahen ato rrugë që fshihen).

| Sipërfaqet që do të lahen | | | | | | | |
|---|----------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| NjA | Njësia | v.2016 | v.2017 | v.2018 | v.2019 | v.2020 | v.2021 |
| Shijak | m ² | 43,370 | 43,370 | 43,370 | 43,370 | 43,370 | 43,370 |
| Xhafzotaj | m ² | - | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 |
| Maminas | m ² | 4,000 | 5,000 | 6,000 | 7,000 | 7,000 | 7,000 |
| Gjepalaj | m ² | - | - | - | - | - | - |
| Totali | m² | 47,370 | 54,370 | 55,370 | 56,370 | 56,370 | 56,370 |
| % e sipërfaqeve që lahen ndaj totalit të sipërfaqeve që fshihen | | 72% | 75% | 68% | 67% | 64% | 61% |
| % e sipërfaqeve që lahen ndaj totalit të sipërfaqeve gjithsej | | 19% | 21% | 22% | 22% | 22% | 22% |

Tabela 31 Sipërfaqet që do të lahen në 5 vitet e ardhshme

Objektivat

a) Objektivat për rezultatet

- Rritja me 10% e sipërfaqeve që do të fshihen me fshesë ndaj totalit (nga 26 % në vitin 2016 në 36 % në vitin 2021) ose rritje në vitin 2021 me 41% e sipërfaqeve që fshihen.
- Rritjen me 3% të sipërfaqeve që do të lahen ndaj totalit (nga 19 % në vitin 2016 në 22 % në vitin 2021) ose rritje në vitin 2021 me 19% e sipërfaqeve që lahen.
- Rritja me 15 % të qytetareve të kënaqur me pastrimin e rrugëve të lagjeve (nga 76% në vitin 2016 në 95% në vitin 2021).

b) Objektivat për produktet

- Në 5 vite do të shtohen sipërfaqet e reja që do të fshihen me 27,000 m² (nga 65,490 m² në vitin 2016 në 92,490 m² në vitin 2021), konkretisht sipas tabelës më poshte;
- Në vitin e parë 2017, shtohen rreth 6,000 m² në Xhafzotaj pjesë e rrethrotullimit tek 4 rrugët e Shijakut deri në NjA Xhafzotaj dhe 1000 m² shtesë nga zgjerimi rrethrotullimit përkatës në Maminas.
- Në vitin 2018 Bashkia do të fusë në skemë fshirje 2,500 m² në Xhafzotaj, 1,000 m² në Maminas dhe për herë të parë do të përfshihen 5,000 m² në Gjepale rruga për tek bioferma.
- Në vitet 2019-2021 Bashkia do të fusë në skemë fshirje 7,500 m² në Xhafzotaj, ku 5,000 m² do të jenë të fshatit Rreth dhe 4,000 m² në Maminas, ku 3,000 m² do të jenë tek rruga e Gjirit të Lalzit.
- Sipërfaqet e reja që do të lahen me autobot shtohen me 9,000 m² (nga 47,370 m² në vitin 2016 në 56,370 m² në vitin 2021) dhe janë kryesisht sipërfaqet që do të fshihen, përkatësisht 7,000 m² në vitin 2017 dhe 2,000 m² në vitet 2018-2019.

Kosto për çdo aktivitet

Kur flasim për aktivitete të pastrimit të rrugëve, trotuareve dhe shesheve , ato përfshijnë:

- fshirje me fshesë çdo ditë e 54,490 m² rrugë, trotuare dhe sheshe për të tre NjA Shijak, Xhafzotaj dhe Maminas, ndërsa në 18,000 m² rrugë (përkatësisht 10,000 m² rrugë në Xhafzotaj; 3,000 m² rrugë në Maminas dhe 5,000 m² rrugë Gjepale) do të fshihen dy herë në javë.
- mbledhje e mbetjeve nga fshirja dhe nga koshat e vegjël të mbetjeve;
- depozitimi i këtyre mbetjeve në pikat e afërta të grumbullimit (kontenierët);

- larja e përditshme e sipërfaqeve prej 54,370 m², të përcaktuara si më sipër në sezonin përkatës;

Standarti i shërbimit

- Fshirje me fshesë çdo ditë e 54,490 m² dhe 18,000 m² dy herë në javë
- Larje çdo ditë për periudhën 1 maj-30 shtator e 54,370 m² sipërfaqe
- Norma e fshirjes rreth 8,000 m²/punëtor
- Norma e larjes 150 ditë pune në vit

Llogaritja e qendrave të kostos për çdo aktivitet

- ✓ Fillimisht , mbi bazën e standardit aktual të shërbimit të ofruar, aktiviteteve, normave të shërbimit, çmimeve aktuale të tregut, llogaritet kosto operative për çdo qendër kostoje për vitin 2017.
- ✓ Llogaritjet e fuqisë punëtore janë bërë sipas kodit të punës për 40 orë në javë, pra shtohen puntorë rezervë për të zëvendësuar ditët e pushimit, festave, lejes së zakonshme dhe të ndonjë raporti mjekësor.
- ✓ Kosto për njësi shërbimi për çdo aktivitet për vitin 2016, u përdor si referencë për llogaritjen e koston operative në vitet 2017-2021, me disa korigjime të rastit. Shpenzimet krahasuar me vitin 2016 rriten mbi bazën e sipërfaqeve të reja që shtohen.

Tabela 32 e koston së fshirjes dhe larjes së rrugëve

| Kosto Fshirje dhe larje e rrugëve (000/Leke) | v.2016 | v.2017 | v.2018 | v.2019 | v.2020 | v.2021 |
|--|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| NjA Shijak | 4,621 | 5,234 | 5,276 | 5,290 | 5,313 | 5,346 |
| NjA Xhafzotaaj | 0 | 564 | 730 | 895 | 890 | 1,239 |
| NjA Maminas | 4,62 | 470 | 566 | 662 | 863 | 868 |
| NjA Gjepalaj | 0 | 0 | 326 | 329 | 330 | 333 |
| Shuma | 5,083 | 6,268 | 6,898 | 7,176 | 7,406 | 7,786 |
| Lekë për m ² fshirje | 77.6 | 64.1 | 65.1 | 65.7 | 66.1 | 66.6 |
| Lekë për m ² larje | 25.5 | 29.9 | 29.3 | 28.8 | 28.8 | 28.8 |

B. Mbledhja, largimi¹⁷ dhe transporti miks i mbetjeve

Mbledhja dhe llogaritja e të dhënave për periudhën 2017-2021, shërbeu për kuptimin dhe vlerësimin e situatës aktuale që lidhet me investime kapitale, shpenzimet operative, shpenzimet e personelit dhe shpenzime të tjera administrative. Informacioni u siguroi nëpërmjet intervistave me personat përgjegjës për NJQV-të, si dhe bazat e të dhënave duke shfrytëzuar hartat, dokumentet strategjike, planet kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, dhe referencat e raporteve të ndryshme.

Supozimet:

- ✓ Supozohet se Zonat Shijak, Xhafzotaj dhe Maminas do t'i largojnë mbetjet nga kontenerët çdo ditë, ndërsa Zona Gjepale 2 herë në javë.
- ✓ Normalisht një kamion që grumbullon mbetjet duhet të vizitojë të gjithë zonën administrative (pikat e grumbullimit), duke udhëtuar përreth derisa kamioni të mbushet plot. Më tej, ai drejtohet në fushën e depozitimit 'landfill' dhe kthehet përsëri, gjë që mund të përkohet me një turn ose përfundimin e shërbimit të grumbullimit për një ekip. Gjendja e rrugëve është shumë e rëndësishme pasi kjo lidhet kryesisht me konsumin dhe kostot e amortizimit dhe, për më tepër me kohën e shpenzuar për grumbullimin. Rrugët e shtruara përmirësojnë shumë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve. Distancat të cilat u morrën në konsideratë janë:
 - Distanca për grumbullimin, për të mbushur një kamion
 - Distanca për transportin, për të shkuar dhe kthyer nga fusha e depozitimit 'landfill'.

Rezultatet e mbetjeve të gjeneruara, për qëllime të llogaritjes së kostos, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

¹⁷ Per termin "mbledhje dhe largim" sipas ligjit 139/2015, mund te perdoret fjala permbledhese "grumbullim"

| TE DHENAT BAZE | | | | | |
|--|---------------|--------|-----------|----------|---------|
| Emri i Zonës së Mbetjeve (NjA) | Njësia | Shijak | Xhafzotaj | Maminas | Gjepale |
| Frekuenca e grumbullimit të mbetjeve | Nr. | 7 | 7 | 7 | 2 |
| Kategoria | | Urban | Gj.Urban | Gj.Urban | Rural |
| Popullsia dhe biznesi i shërbyer në këtë zonë | Nr. | 9,614 | 14,656 | 5,437 | 4,251 |
| % e popullsisë që përjashtohen (të regjistruar, por jetojnë jashtë) | % | - | - | - | - |
| Popullsia shërbyer (merr/konsiderohet për shërbimin) | Nr. | 9,614 | 14,656 | 5,437 | 4,251.0 |
| Rrugët (distanca nga Landfilli në një kah) | Km | 16 | 14 | 22 | 21 |
| Rrugët (distanca e përshkruar gjatë grumbullimit/turn për një kamion) | Km | 6 | 9 | 5 | 3 |
| Mbetjet e gjeneruara për njësi (banor, biznes, institucion) | kg/njési/ditë | 0.9 | 0.8 | 0.8 | 0.5 |
| Totali i mbetjeve të gjeneruara | ton/dite | 8.7 | 12 | 4.3 | 1.9 |
| Totali i mbetjeve të gjeneruara ndërmjet dy grumbullimeve sipas frekuencës | ton/dite | 8.7 | 12 | 4.3 | 6.7 |
| Totali i mbetjeve të gjeneruar | ton/vit | 3,193 | 4,387 | 1,588 | 698 |

Tabela 33 Të dhëna bazë për çdo zonë mbetjesh

Të gjitha shifrat e mësipërme kanë të bëjnë me mbetjet e ngurta urbane, duke mos përfshirë mbetjet e rrezikshme, bujqësore, inertet dhe mbetjet voluminoze, të cilat duhet të trajtohen veçmas në bazë të standardeve për menaxhimin e tyre.

Politikat, objektivat dhe kostot

Sipas skemës mix të prezantuar më sipër familjet, bizneset dhe institucionet çojnë në pikat e grumbullimit ku janë vendosur kontenerët të gjitha mbetjet e gjeneruara dhe më pas nëpërmjet mjeteve të transportit ato destinohen në venddepozitimin/ landfillin më të afërt, ku realizohet dhe trajtimi i mëtejshëm i tyre. Politikë e veçuar është ajo e zonës pilot në Lagjen Erzen ku do të fillojë ndarja në burim e mbetjeve dhe më pas objektivat sipas PKMM.

Politikat 2017-2021

Mbi plotësimin e bashkise me kontenerët e nevojshëm

- ✓ Vitin e parë të planit (v.2017) Bashkia do të plotësojë në masen 88% të bashkisë me kontenerë të rinj të domosdoshëm sipas gjenerimit të mbetjeve
- ✓ Nëpërmjet riparimit të 32 kontenerëve ekzistues, e gjithë bashkia plotësohet në vitin 2017 në masën 100% me kontenerët e nevojshëm.
- ✓ Duke filluar nga viti i dytë dhe në vazhdim e gjithë bashkia do të sigurojë numrin e nevojshëm të kontenerëve sipas llogaritjeve të bëra dhe gjenerimit të mbetjeve.

PLANI VENDOR I MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE - BASHKIA SHIJAK

| Numri i kontenierëve sipas zonave | Viti 2016 | Parashikimi I kontenierëve 2017-2021 | | | | |
|-----------------------------------|-----------|--------------------------------------|------------|------------|------------|------------|
| | | v.2017 | v.2018 | v.2019 | v.2020 | v.2021 |
| Z.1 Shijak | 26 | 75 | 75 | 75 | 76 | 76 |
| Z.2 Xhafzotaj | | 103 | 103 | 104 | 104 | 105 |
| Z.3 Maminas | | 37 | 38 | 38 | 38 | 38 |
| Z.4 Gjepalaj | 6 | 57 | 57 | 58 | 58 | 58 |
| Total | 32 | 272 | 273 | 275 | 276 | 277 |
| Kontenierë Shtesë | 0 | + 237 | + 1 | + 2 | + 1 | + 1 |

Tabela 34 Parashikimi i kontenierëve në 5 vitet e ardhshme

Mbi organizimin e pikave të vendosjes së kontenierëve

Përcaktimi i pikave për vendosjen e kontenierëve do të jetë në funksion të grumbullimit miks të mbetjeve dhe në çdo pikë do të vendosen 1-2 kontenierë, pra mesatarisht bashkia do të ketë sipas numrit të kontenierëve 150 pika.

- ✓ Nga 19 pika aktuale për grumbullimin e mbetjeve, do të shtohen dhe 130 pika. Pra, standarti është mesatarisht 1 pikë për 100 familje.

Objektivat

a) Objektivat për rezultatet

- Mbulimi 100% i familjeve, bizneseve, institucioneve me shërbimin e mbledhjes dhe transportit të mbetjeve (nga 84% e familjeve, 94% e bizneseve dhe 69% e institucioneve që përfitonin shërbim në vitin 2016 do të përfitojnë 100% e tyre në vitin 2017 e në vazhdim).
- Rritja me 76% e plotësimit të qytetit me kontenierët e nevojshëm (nga 12% në vitin 2006 në 88% në vitin 2017 dhe 100% në vitin 2021).

b) Objektivat për produktet

- 12,376 familje të bashkisë përfitojnë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve (nga 10,391 familje në vitin 2016 në 12,376 familje në vitin 2017).

Llogaritja e qendrave të kostos për çdo aktivitet

- ✓ Fillimisht, mbi bazën e standardit aktual të shërbimit të ofruar, aktiviteve, normave të shërbimit, çmimeve aktuale të tregut, llogaritet kosto operative për çdo qendër kostoje për vitin 2017.
- ✓ Kosto për njësi shërbimi për çdo aktivitet të vitit 2017, u përdor si referencë për llogaritjen e kosto operative në vitet 2018-2021, me disa korigjime të rastit. Shpenzimet krahasuar me vitin 2017 rriten mbi bazën e gjenerimit të mbetjeve.

Aktiviteti i mbedhjes dhe transportit të mbetjeve sipas skemës së mësipërme përfshin:

- Grumbullimin mix të mbetjeve urbane në të gjitha pikat publike me kontenierë
- Pastrimin e vendit rreth kontenierëve
- Transportin e mbetjeve në landfillin e Porto Romanos

Standarti i shërbimit

Bashkia do të largojë mbetjet çdo ditë për të gjitha zonat urbane dhe gjysëm urbane dhe 2 herë në javë për zonat rurale. Pra, këto frekuenca rezultojnë si më të përshtatshme për të garantuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve. Për më tepër konsumatorët dhe operatori i shërbimit janë më të familjarizuar më këto frekuenca shërbimesh.

- ✓ Çdo ditë nga bashkia do të largohen të gjitha mbetjet e gjeneruara nga Zona e Shijakut, Xhafzotaj dhe Maminas, ndërsa 2 herë në javë nga Zona Gjepale.

C. Kostot e Mbledhjes dhe Transportit të Mbetjeve

C.1 Kostot Kapitale

Bashkia është e domosdoshme të krijojë infrastrukturën bazë fizike të menaxhimit të mbetjeve. Si hap i parë, duhet llogaritur sa kamionë dhe konteniere nevojiten për të menaxhuar mbetjet në mënyrën e duhur. Blerja e këtyre mjeteve përfaqëson investimin kapital. Përdorimi nga ana jonë i numrit të popullsisë së rregjistrit Civil të korigjuar ofron koston më të ulët kapitale.

C.1.1 Kosto kapitale për Kamionët

Kamionët tipikë për grumbullimin e mbetjeve janë vetëngjeshës me kapacitet 5 dhe 10 ton. Këta kamionë sugjerohen për t'u përdorur në varësi të tipit dhe popullsinë e njësisë. Normalisht

në zonë rurale dhe gjysëm urbane mirë është të përdoret kamioni me kapacitet 5 ton, ndërsa një zonë urbane kamioni me kapacitet 10 ton.

Sipas tabelës së mëposhtme kosto kapitale për blerjen e 2 kamionëve të përdorur është 9,565,000 lekë, për një kamion 10 ton 5,977,000 lekë dhe për kamion 5 ton 3, 588,000 lekë.

| Kosto blerje kamioni ¹⁸ | 10 Ton | 5 Ton |
|--|------------------|------------------|
| Kosto kamionit (cmimi i referohet tregut aktual per kamion te perdorur) | 5,977,000 | 3,588,000 |
| Numri i kamioneve | 1 | 1 |
| Totali i kostove te investimit (kamione) (Leke) | 5,977,000 | 3,588,000 |


Tabela 35 Nevojat kapitale për makina teknologjike

Deri në fund të vitit 2021 dy makinat teknologjike, një e kapacitetit 10 ton dhe një e kapacitetit 5 ton, janë të mjaftueshme për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në landfillin e Porto Romanos.

C.1.2 Kosto kapitale për Kontenierët

Një kontenier tipik ka një vëllim $1.1m^3$, i cili ka një kapacitet maksimal mbajtës prej rreth 0,1 ton mbetjesh të ngurta, në qoftë se konsiderojmë një dendësi të përgjithshme prej $0.11 \text{ ton}/m^3$ për mbetjet. Kjo dendësi është mirë të matet nga bashkia nëpërmjet peshimit, sepse është subjekt i ndryshimeve sipas përbërjes së mbetjeve. Kapaciteti i një kontenieri është në varësi të madhësisë së tij (vëllimi, m^3) dhe dendësisë specifike të mbetjeve në kontenier. Shifrat e dhëna mund të përdoren si vlerësim paraprak.

Numri i kontenierëve të nevojshëm llogaritet duke marrë në konsideratë një tipologji të kufizuar të mbetjeve, kryesisht shtëpiake. Lloje të tjera mbetjesh si ato bujqësore, inertet apo ndonjë lloj tjetër mbetjesh “të mëdha” duhet të përjashtohen dhe eliminohen nga vetë prodhuesit.



Sipas grafikut numri i kontenierëve të nevojshëm për grumbullimin e mbetjeve është 272.

¹⁸ Modeli Dldp i konsideron zonat si zona mbetjesh dhe llogarit 4 kamionë, pra 1 kamion për çdo zonë, pavarësisht gjenerimit ditor të mbetjeve.

Në funksion të rritjes së gjenerimit të mbetjeve në vite, bashkia do të plotësojë dhe numrin e nevojshëm të kontenierëve për vitet 2018-2021. Pra, kontenierët në vitin 2021 rriten me 5 copë krahasuar me vitin 2017.

Për vitin 2017, Bashkia duhet të buxhetojë kosto kapitale 9,520,000 lekë për blerjen e kontenierëve të nevojshëm.

| | | | Kosto e Kontenierëve | | | | |
|-----------------------|----------------|------------|----------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| | | | v.2017 | v.2018 | v.2019 | v.2020 | v.2021 |
| | Lekë/ Njësi | numri | Vlefte/Lekë | Vlefte/Lekë | Vlefte/Lekë | Vlefte/Lekë | Vlefte/Lekë |
| Z. 1 Shijak | 35,000 | 75 | 2,625,000 | | | 35,000 | |
| Z. 2 Xhafzotaj | 35,000 | 103 | 3,605,000 | | 35,000 | | 35,000 |
| Z.3 Maminas | 35,000 | 37 | 1,295,000 | 35,000 | | | |
| Z.4 Gjepalaj | 35,000 | 57 | 1,995,000 | | 35,000 | | |
| Total | 35,000 | 272 | 9,520,000 | 35,000 | 70,000 | 35,000 | 35,000 |

Tabela 36 kosto e kontenierëve në 5 vitet e ardhshme

C.2 Kostot Operative

Kostot operative që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e infrastrukturës (në lidhje me kamionët dhe kontenierët) dhe me transportin e mbetjeve, duke përfshirë koston e personelit. Këto kosto vjetore duhen mbajtur të ndara, sepse janë të lidhura ngushtë me ndryshimet e tregut dhe inflacionin.

Llogaritja e kostos operative varet nga disa variabla:

- i. Ditët në vit gjatë të cilave kryhet shërbimi, të cilat lidhen ngushtë me:
 - frekuencën e grumbullimit të mbetjeve (pra 2 herë apo 7 herë në javë), pra me sasinë e mbetjeve që grumbullohen. Nëse ka një gjenerim mbetjesh prej rreth 3.5 ton/ditë, ka nevojë për shërbime të përditshme, ndërsa për një gjenerim më pak se 3 ton/ditë organizohet grumbullimi një herë në 2 ose 3 ditë. Në rast se shërbimi nuk kryhet çdo ditë ka nevojë për shtim të numrit të kontenierëve.
- ii. Kostoja e karburantit- Konsumi i karburantit varet nga një planifikim i mirë i itinerarit, grumbullimit dhe transportit eficient dhe ndikon shumë në kostot e përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve. Administratorët duhet të llogarisin ndryshimet gjatë viteve të planit të çmimit të karburanteve dhe ta adresojnë atë në mënyrën e duhur.

C.2.1 Kostot e Mirëmbajtjes

- i. Mirëmbajtja e kamionëve

Kostot që lidhen me kamionët janë të larta dhe mirëmbajtja e tyre është kërkesë e legjislacionit. Mirëmbajtja e kamionëve është e lidhur me ndërrimin vajit dhe filtrave, të gomave dhe punëve të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen. Kostot që lidhen me kamionët janë shumë të larta dhe kërkon një plan të mirë administrativ për mirëmbajtjen. Për më tepër, kostot e sigurimeve dhe taksave duhet të llogariten çdo vit.

Shifrat për sigurimet dhe taksat i referohen taksave kombëtare për tipin e kamionit të përdorur. Për shkak të ndarjes të bashkisë në katër zona mbetjesh, kostot e mirëmbajtjes së kamionit 10 ton, që i shërben zonës Shijak dhe Xhafzotaj, ndahen në mënyrë të barabartë. E njëjta gjë edhe për kostot e mirëmbajtjes së kamionit 5 ton që shërben në zonat Maminas dhe Gjepale.

ii. Mirëmbajtja mekanike (shërbimet)

Mirëmbajtja mekanike lidhet me orët e punës së kamionit, me kushtet e rrugëve, përdorimin e kamionit. Këto kosto duhet të mbikqyren për t'i mbajtur sa të jetë e mundur në nivele të ulta. Sasia e parave të kërkuar për mirëmbajtjen vjen nga përvoja dhe nga përdorimi i mjeteve.

iii. Parkimi

Sugjerohet të përdoret për parkim të mjeteve toka e vet bashkisë, se në rast të kundërt mund të ketë kosto të tjera që lidhen me qeranë, me mirëmbajtjen e parkimit, rojet, shpenzime të tjera etj. Sasia e parave të kërkuara për parkimin bazohet në realitetin e njësisë. Nëse NJQV ka tokën e saj, mund të ulë kostot e parkimit duke ndërtuar një park për të gjithë mjetet.

Tabela më poshtë tregon kostot totale të mirëmbajtjes¹⁹ për çdo zonë mbetjesh, e llogaritur vetëm për dy kamionët dhe e ndarë për çdo zonë:

| KOSTOT E MIREMBAJTJES | Njësia | Shijak | Xhafzotaj | Maminas | Gjepale |
|--------------------------------------|------------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| Sigurimi i kamionit + taksat | Lekë/kamion/vit | 75,000 | 75,000 | 50,000 | 50,000 |
| Vaj + filtra | Lekë/kamion/vit | 45,000 | 45,000 | 37,500 | 37,500 |
| Goma | Lekë/kamion/vit | 80,000 | 80,000 | 80,000 | 80,000 |
| Mirëmbajtja mekanike | Lekë/kamion/vit | 100,000 | 100,000 | 100,000 | 100,000 |
| Parkim | Lekë/kamion/vit | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 25,000 |
| Kostot totale të mirëmbajtjes | Lekë/kamion/vit | 325,000 | 325,000 | 292,500 | 292,500 |

Tabela 37 kosto e mirëmbajtjes

¹⁹ Kostot e mirembajtjes jane llogaritur per 2 kamione dhe jane ndare ne menyre te barabarte per zonat.

C.2.2 Kostot e Mbledhjes dhe Transportit

Kostoja e mbledhjes dhe transportit varet nga:

- i. **Koha e shpenzuar (orë)** - ka të bëjë me kohën për mbledhjen e mbetjeve në kohë për transportin e tyre në landfill. Kjo shifër varet nga lloji i automjetit dhe llojit të zonës (urban, gjysëm urban, rural). Zakonisht për kohën e grumbullimit një kamion 5t do t'i duhen 3 orë për të përfunduar ndërsa një kamioni 10t do t'i duhen 4 orë (keto mund të maten nga vetë bashkia).
Koha gjithashtu ndryshon në varësi të distancës në landfill dhe shpejtësisë të kamionit. Në landfill, kamionët kanë nevojë për një kohë shtesë për të shkarkuar që është mesatarisht 0,3 orë/turn.
- ii. **Distancat e përgjithshme (km)** - llogaritur si distanca për grumbullimin e mbetjeve dhe distanca në landfill. Një sistem rrugor i mirë i brendshëm do të rezultojë shumë eficient për të zvogëluar distancat e përgjithshme, pra, më pak kohë dhe më pak karburant. Itinerari i rrugëve të brendshme të kamionëve sugjerohet të studiohet më përpara, për të mos përshkuar (nëse është e mundur) të njëjtat rrugë dy herë.
- iii. **Konsumi i karburantit (l)** - Varet nga lloji i automjetit dhe numri i shërbimeve. Nga përvoja konsumi për kamionë për grumbullimin e mbetjeve është përkatësisht: për kamionin 5t = 3litra/orë, për atë 10t = 5litra/orë.
Konsumi për kamionë gjatë transportit është konsideruar përkatësisht: për llojin 5t = 0.4litra/km, për llojin 10t = 0.5litra/km.
Për të qenë sa më të saktë dhe për të përcaktuar ku janë kostot kryesore (dhe kursimet e mundshme), këshillohet të ndahen kostot për grumbullimin (kur kamioni është duke u mbushur) nga kostot e transportit (kur kamioni është e plot dhe rrugës për në 'landfill').

C.2.2/a Kosto e grumbullimit të mbetjeve

Tabela e mëposhtme përcakton koston e grumbullimit të mbetjeve:

| Kostot e grumbullimit | Njësia | Shijak | Xhafzotaj | Maminas | Gjepale |
|---|------------|--------|-----------|---------|---------|
| Ditë pune në vit (nëse më pak se 2ton/ditë, grumbullimi 2herë/javë) | Dite/vit | 365 | 365 | 365 | 104 |
| Kosto e karburantit | Leke/liter | 190 | 190 | 190 | 190 |
| Koha për të ngarkuar një kamion një herë - koha e grumbullimit | ore | 4 | 4 | 3 | 3 |
| Koha totale për grumbullim ²⁰ | ore/dite | 4 | 8 | 3 | 6 |
| Koha për të shkarkuar në "landfill" | ore | 0.3 | 0.3 | 0.3 | 0.3 |
| Proporcioni i kohës totale për grumbullim | % | 0.83 | 0.84 | 0.7 | 0.8 |

²⁰ Llogaritur: nr. kamionëve * kohë/kamion * nr. i turneve

| | | | | | |
|---|-----------------|------------------|------------------|----------------|----------------|
| Karburanti i konsumuar gjatë grumbullimit ²¹ | litra/vit | 21.5 | 43.0 | 9.9 | 9.8 |
| Karburant total i konsumuar për grumbullim | litra/vit | 7,848 | 15,695 | 3,614 | 2,059 |
| Kostot totale për grumbullim | leke/vit | 1,491,025 | 2,982,050 | 686,565 | 391,248 |

Tabela 37 kosto e grumbullimit të mbetjeve

C.2.2/b Kosto e transportit të mbetjeve

Tabela e mëposhtme përcakton koston e transportit të mbetjeve:

| Kostot e transportit | Njësia | Shijak | Xhafzotaj | Maminas | Gjepale |
|--|-----------------|----------------|------------------|------------------|----------------|
| Kosto e karburantit | Lekë/litër | 190 | 190 | 190 | 190 |
| Shpejtësia e lëvizjes | km/orë | 60 | 60 | 60 | 60 |
| Koha e transportimit për në "landfill" ²² | Orë | 0.5 | 0.5 | 0.7 | 0.7 |
| Koha totale e harxhuar për transportim (një ditë/të gjithë kamionët) ²³ | orë/ditë | 0.8 | 1.5 | 1.0 | 2.0 |
| Proporcioni i kohës totale për transport | % | 17% | 16% | 26% | 25% |
| Totali i km për transport për dit, të gjithë kamionat ²⁴ | km/ditë | 32.0 | 56.0 | 44.0 | 84.0 |
| Karburant i konsumuar gjatë transportit | litra/ditë | 14.4 | 25.2 | 17.6 | 33.6 |
| Totali i karburantit të konsumuar për transport | litra/vit | 5,256 | 9,198 | 6,424 | 3,494 |
| Kostot totale për transport | lekë/vit | 998,640 | 1,747,620 | 1,220,560 | 663,936 |

Tabela 38 kosto e transportit të mbetjeve

C.2.2/c Kosto e personelit për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve

Llogaritja e koston së personelit është një komponent menaxhues i përgjegjshëm që duhet të adresojë edhe aspektet sociale.

Fokuset tek kostot operative të personelit, por duke u kufizuar tek shoferët dhe operatorët e kamionëve. Pavarësisht se shërbimi mund të ofrohet nga vetë njësia ose kontraktohet së jashtmi, personeli i punësuar duhet të mbikqyret gjithmonë nga administratorët e shërbimeve të bashkise, për të siguruar që kompania punon me eficiencë shërbimi (kohë, siguri, performancë të detyrës, etj.)

Kjo kosto kushtëzohet nga:

i. Personeli (Numri)

²¹ Llogaritur: numri i turneve per kamion * numrin (koha per mbledhje + koha per shkarkim) * shkalla e konsumit per kamion

²² Llogaritur: Distanca nga landfilli * Numri 2 (vajtje-ardhje) / shpejtësia e kamionit

²³ Llogaritur: (numri i kamionëve * Numri i turneve) * (koha për transportin në landfilli + koha për shkarkim në landfill)

²⁴ Llogaritur: (largësia nga landfilli * Numri i kamionëve * Numri i turneve) * 2 (vajtje-ardhje)

Një kombinim i mirë është 1 shofer për makinë dhe dy operatorë gjatë grumbullimit të mbetjeve. Operatorët nuk është e nevojshme të shoqërojnë kamionin në landfill.

Numri i shoferëve dhe punëtorëve llogaritet duke marrë parasysh numrin e turneve për/kamion dhe kufizimin ligjor të orëve të punës në ditë dhe javë. Pra një kamion mund të përdoret nga 2 shoferë, (1 e përdor paradite dhe një mbasdite).

Personeli duhet mbështetur me uniforma, mjete për grumbullim, pastrues kimike etj.

ii. Orari i punës

Sipas kodit të punës 1 punëtor nuk mund të punojë më shumë se 48 orë në javë. Në rast të orareve të zgjatura mbi 8 orë, orët shtesë konsiderohen me pagesë, dhe nuk mund të punohet mbi 12 orë në ditë. Kur është e mundur, orët jashtë orarit të punës duhet të shmangen. Duhet të vendoset një ekuilibër i mirë mes numrit të turneve, orëve për turn dhe orët e totale të punës për çdo staf. Nëse është e pashmangshme, duhet të llogariten kostot shtesë për orët shtesë, ose, në qoftë se është vërtet e nevojshme, të pajtohet në punë më shumë personel.

Dita e punës së personelit përbëhet nga koha për grumbullimin, transportin, mirëmbajtjen (pastrimin e kamionit), raportimin (ditari) dhe takimet/trajnimet. Për llogaritjen e kostos duhet të kryhet një shpërndarje mes shërbimit të kamionit dhe mirëmbajtjes.

a) Llogaritja jonë: maksimumi 8 orë në ditë dhe 40 orë një javë - kohë të përfshira këtu për grumbullimin, transportin, mirëmbajtjen (pastrimin e kamionit), raportimin, takime etj.

b) Llogaritja jonë: 7.3% e kohës e harxhuar me punët e mirëmbajtjes dhe 7.7% e kohës për ditë pushime

Paga - është llogaritur në bazë të Kodit të Punës duke respektuar pagën minimale (22,000 lekë/muaj) dhe pjesën tjetër në varësi të punës dhe kapacitetit. Paga përfshin pagesën dhe për detyra të tjera. Në pagesën mujore ligjore përfshihen dhe kritere të tjera si puna natën apo dhe vjetërsia në punë si dhe taksat ndaj shtetit.

Tabela e mëposhtme llogarit koston e shoferave dhe operatorëve:

| Kostot e shoferëve dhe operatorëve | Njësia | Shijak | Xhafzotaj | Maminas | Gjepale |
|--|----------|--------|-----------|---------|---------|
| Orët e punës për javë / shofer (pa mirëmbajtjen dhe fundjavat) | Orë | 33.9 | 33.4 | 28.3 | 16.0 |
| Koha javore e nevojshme për mirëmbajtje | Orë/javë | 2.47 | 2.44 | 2.06 | 1.17 |
| Koha javore e nevojshme për pushim fundjave | Orë/javë | 2.61 | 2.57 | 2.18 | 1.23 |
| | Orë/javë | 36.3 | 35.83 | 30.32 | 17.13 |

| | | | | | |
|---|-----------------|----------------|------------------|----------------|----------------|
| Orët e punës për javë / shofer (me mirëmbajtjen) ²⁵ | | | | | |
| Numri total i shoferave të nevojshëm (duke konsideruar orët maksimale të punës në javë) ²⁶ | numri | 1 | 2 | 1 | 1 |
| Paga mujore e shoferave ²⁷ | Lekë/muaj | 27,000 | 27,000 | 27,000 | 27,000 |
| Taksat (ne % ndaj pagës) | % | 0.48% | 0.48% | 0.48% | 0.48% |
| Kosto vjetore për shoferët | Lekë/vit | 479,520 | 959,040 | 479,520 | 479,520 |
| Numri i punonjësve/operatorëve për ekip (1 shofer X 2 operatorë) | numri | 2 | 4 | 2 | 2 |
| Orë pune në javë/operator (përfshijnë mirëmbajtjen) | Orë/javë | 28.0 | 28.0 | 21.0 | 12.0 |
| Koha e mbetur për detyra të tjera në javë / operator | Orë/javë | 11.9 | 11.9 | 18.95 | 28.0 |
| Paga mujore e punonjësve/operatorëve ²⁸ | Lekë/muaj | 25,000 | 25,000 | 25,000 | 25,000 |
| Taksat (në % ndaj pagës) | % | 0.48% | 0.48% | 0.48% | 0.48% |
| Kosto vjetore për operatorët | Lekë/vit | 888,000 | 1,776,000 | 888,000 | 888,000 |

Tabela 39 kosto e shoferëve dhe operatorëve

C.2.3 Kostot e Depozitimit të mbetjeve në landfill

Sipas legjislacionit për “mbetjet” çdo NJQV duhet t’i depozitohet mbetjet në një mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt. Kosto për depozitim mbetjesh është vendosur si tarifë hyrjeje dhe zakonisht paguhet për ton.

Kostot e depozitimit mund të jenë subjekt i ndryshimit, bazuar në sasinë e mbetjeve që shkon përditë në ‘landfill’ dhe sipas shërbimeve që kryhen në të. Si pasojë duhet të nënshkruhet një marrëveshje e qartë, e cila do ta adresojë tarifën bazuar në një plan biznesi të përshtatshëm dhe të shtrirë në kohë.

Bashkia i depoziton mbetjet në landfillin e Porto Romanos, ku për çdo ton mbetje të depozituar paguan tarifën e trajtimit të mbetjeve. Sipas kontratës së fundit kjo tarifë është 200 lekë/ton.²⁹

Tabela e mëposhtme pasqyron koston e depozitimit të mbetjeve në landfill:

| Kostot e depozitimit (Landfill) | Njësia | Shijak | Xhafzotaj | Maminas | Gjepale |
|--|-----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| Tarifa e depozitimit | Lekë/ton | 200 | 200 | 200 | 200 |
| Kostot totale për depozitim (ton total * kosto/ton) | lekë/vit | 638,658 | 877,308 | 317,521 | 139,645 |

Tabela 40 kosto e depozitimit në landfill

²⁵ Llogaritjet: Koha totale për mbledhjen dhe largimin në ditë * ditë pune në vit / nr. Shoferëve / (52 * (1 - (% e kohës së mirëmbajtjes +% e kohës për pushimet) / 100))

²⁶ Llogaritjet duke pasur parasysh kohën totale të shpenzuar nga një shofer, i kufizuar nga numri i turneve dhe të kodit të punës për kohë maksimale të punës dhe të kohës së pushimeve

²⁷ Llogaritjet: paga bruto për shoferin së bashku me pagesat mujore * 12 muaj * Numri i shoferëve të kamionëve

²⁸ Llogaritjet: paga bruto për operatorin së bashku me pagesat mujore * 12 muaj * Numri i shoferëve të kamionëve

²⁹ Tarifa është supozuar, sepse Bashkia paguan tarifë 101 lek/m³, por mund të ndryshojë venddepozitimi

C.2.4 Kostot e Amortizimit

Në mënyrë që sistemi të mbahet në punë për një kohë të gjatë rëndësi ka llogaritja e kostove të nevojshme për riinvestim. Pra, konsiderimi i kostos së amortizimit është çështje e qëndrueshmërisë të sistemit dhe siguron një sistem funksional.

Llogaritja bazohet në legjislacionin shqiptar për amortizimin e pajisjeve, e cila parashikon një kohëzgjatje 6 vjeçare dhe lidhen direkt me koston vjetore për amortizimin për kamionët dhe kontenierët. Kjo i shtohet sistemit si një përqindje për vitin, që praktikisht paraqet 15% të shumës totale të kostos për kamionë dhe kontenierë në vit.

Kjo nuk lidhet detyrimisht me amortizimin e vërtetë. Përdorimi i papërshtatshëm mund të shkurtojë jetën e pajisjeve dhe për këtë arsye të ndikojë ndjeshëm në koston për mirëmbajtjen, investimet, dhe eficiencën e shërbimit (koha, karburanti). Për kontenieret kjo llogaritje është subjekt verifikimi në bazë të përdorimit të tyre.

Tabela e mëposhtme parashikon koston e amortizimit për dy kamionët³⁰ dhe 272 kontenierët, pra vetëm për kontenierët e rinj. Kontenierët ekzistues, deri në fund të vitit 2017 do të zëvendësohen me të rinj, për shkak të gjendjes së tyre shumë të keqe, prandaj nuk është llogaritur kosto amortizimi.

| Kostot e amortizimit | Njësia | Shijak | Xhafzotaj | Maminas | Gjepale |
|------------------------------------|-----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| Kamionë | | | | | |
| Amortizimi i kamionit në vit | %/vit | 15% | 15% | 15% | 15% |
| Kosto amortizimi për kamionët | lekë/vit | 358,688 | 358,688 | 358,688 | 358,688 |
| Kontenierë | | | | | |
| Amortizimi i kontenierit në vit | %/vit | 15% | 15% | 15% | 15% |
| Kosto amortizimi kontenierë | lekë/vit | 392,992 | 539,842 | 195,383 | 300,753 |
| Totali i koston amortizimit | Lekë/vit | 751,679 | 898,530 | 554,071 | 659,440 |

Tabela 41 kosto e amortizimit

C. Kostot Administrative dhe e Ardhura Neto

Kostot administrative mund të përfshijnë koston e nevojshme për rikuperimin e kostove dhe për fushatat e ndërgjegjësimit publik. Ajo mund të paraqitet e veçantë, ose të jetë pjesë e kostove të përgjithshme administrative. Ky vendim merret në bazë të kapaciteteve dhe nevojave të bashkisë.

³⁰ Kosto e dy kamionëve është ndarë në mënyrë të barabartë për të gjitha zonat, sepse modeli dldp kalkulon kosto amortizimi për 4 kamionë (zonat konsiderohen zona mbetjesh të veçuara)

Përveç kësaj, duhen llogaritur të ardhurat neto, të cilat kërkohen për teknologji të reja, zgjerimin e shërbimit dhe çështje të tjera të paplanifikuara dhe të nevojshme. Shifra përcaktohet nga administratori vendor bazuar në kapacitetin financiar. Shifra është vendosur si përqindje e kostove totale.

Përvoja sugjeron se këto përqindje janë përkatësisht: 9% për kostot administrative dhe 4% të ardhura neto.

D. PERMBLEDHESE E KOSTOS OPERATIVE DHE KAPITALE

E.1 Kosto e vitit 2017

Tabela e mëposhtme është një përmbledhje e kostos totale për vitin e parë të planit (2017), dhe informon drejtorinë përkatëse mbi nevojat për investime, personel, operacione, amortizimin e mjeteve dhe kosto të tjera, në mënyrë që të jetë në gjendje të paraqesë vlerësimin e kostos në nivelin e duhur tek kryetari i bashkisë dhe këshilli i njësisë.

| Kosto e Aktiviteteve të Kostos (lekë) | % | Bashkia Shijak | | | | TOTALI |
|--|----------------|-------------------|-------------------|------------------|------------------|-------------------|
| | | Shijak | Xhafzotaj | Maminas | Gjepale | |
| | | Lekë | Lekë | Lekë | Lekë | |
| TOTALI I KOSTOS (A+B) | Lekë/vit | 17,444,698 | 17,644,792 | 9,330,932 | 8,427,683 | 52,848,105 |
| A.Kosto Operacionale | Lekë/vit | 12,428,448 | 11,648,542 | 5,644,682 | 4,041,433 | 33,763,105 |
| <i>Shpenzime për banor</i> | <i>L/banor</i> | <i>1,293</i> | <i>795</i> | <i>1,038</i> | <i>951</i> | <i>994</i> |
| Fshirje rruge | 16% | 3,939,149 | 384,370 | 320,308 | - | 4,643,827 |
| Larje rruge | 6% | 1,295,675 | 179,250 | 149,375 | - | 1,624,300 |
| Mirëmbajtje mjete | 4% | 325,000 | 325,000 | 292,500 | 292,500 | 1,235,000 |
| Grumbullim mbetje | 19% | 1,491,025 | 2,982,050 | 686,565 | 391,248 | 5,550,888 |
| Transport mbetje | 16% | 998,640 | 1,747,620 | 1,220,560 | 663,936 | 4,630,756 |
| Personel | 23% | 1,367,520 | 2,735,040 | 1,367,520 | 1,367,520 | 6,837,600 |
| Depozitim mbetje | 7% | 638,658 | 877,308 | 317,521 | 139,645 | 1,973,132 |
| Amortizim | 10% | 751,679 | 898,530 | 554,071 | 659,440 | 2,863,720 |
| Shuma 1 | 100% | 10,807,346 | 10,129,167 | 4,908,419 | 3,514,289 | 29,359,222 |
| Kosto administrative & ndërgjegjësim (11%) | | 1,188,808 | 1,114,208 | 539,926 | 386,572 | 3,229,514 |
| E ardhur neto (4%) | | 432,294 | 405,167 | 196,337 | 140,572 | 1,174,369 |
| Shuma 2 | | 1,621,102 | 1,519,375 | 736,263 | 527,143 | 4,403,883 |
| B. Kosto Kapitale | | 5,016,250 | 5,996,250 | 3,686,250 | 4,386,250 | 19,085,000 |
| Makina | | 2,391,250 | 2,391,250 | 2,391,250 | 2,391,250 | 9,565,000 |

| | | | | | | |
|------------|--|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Kontenierë | | 2,625,000 | 3,605,000 | 1,295,000 | 1,995,000 | 9,520,000 |
|------------|--|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|

Tabela 42 Kosto e totale e shërbimit




Figura 18. Struktura e kostos operacionale




Figura 19. Kosto për njësi

E.2 Kosto e viteve 2017-2021

Bazuar në normat për njësi të kostos së vitit 2017 dhe disa shtesave të tjera u llogarit dhe kosto për periudhën 2017-2021.

| Kosto e Aktiviteteve (lekë) | KOSTO V. 2017-2021 (Lekë) | | | | |
|-------------------------------------|---------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| | v.2017 | v.2018 | v.2019 | v.2020 | v.2021 |
| Lekë/banor | 994 | 1,011 | 1,016 | 1,019 | 1,028 |
| TOTALI I KOSTOS OPERACIONALE | 33,763,105 | 34,500,408 | 34,843,589 | 35,124,663 | 35,578,595 |
| Fshirje rruge | 5,340,401 | 6,065,095 | 6,385,127 | 6,649,035 | 7,085,744 |
| Larje rruge | 1,867,944 | 1,867,944 | 1,867,944 | 1,867,944 | 1,867,944 |
| Mirembajtje mjete | 1,420,250 | 1,420,250 | 1,420,250 | 1,420,250 | 1,420,250 |
| Grumbullim mbetje | 6,383,521 | 6,383,521 | 6,383,521 | 6,383,521 | 6,383,521 |
| Transport mbetje | 5,325,369 | 5,325,369 | 5,325,369 | 5,325,369 | 5,325,369 |
| Personel | 7,863,240 | 7,863,240 | 7,863,240 | 7,863,240 | 7,863,240 |
| Depozitim mbetje | 2,269,102 | 2,276,788 | 2,287,862 | 2,298,991 | 2,310,175 |
| Amortizim | 3,293,278 | 3,298,200 | 3,310,275 | 3,316,313 | 3,322,350 |

Tabela 42 kosto e totale e shërbimit

4.4.3 Administrimi i mbetjeve në zonën pilot për diferencimin e mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve në Bashkinë Shijak do të përfshijë zbatimin e skemave të minimizimit të mbetjeve dhe do të fillojë në vitin e parë të planit dhe kryesisht në lagjen Erzen (kufizuar nga rrugët Brigada e 10 Sulmuese, Vesel Xhepaxhiu dhe Ali Efendi Shahini) dhe shkollat e qytetit, për të reduktuar në mënyrë progresive mbetjet me destinacion djegjen apo depozitimin në landfill.

Në të njëjtën kohë do të synohet dhe në rritjen e ndërgjegjësimit publik për ndarjen e mbetjeve që në burim.

Skema e menaxhimit të diferencuar të mbetjeve në zonën pilot do të trajtohet brenda skemës së menaxhimit të mbetjeve të tjera dhe mund të realizohet:

- ✓ Nëpërmjet diferencimit në burim të mbetjeve dhe grumbullimit të tyre në kontenerë të veçantë në PGM



- ✓ NËPËRMJET PËRDORIMIT TË SKEMAVE INDIVIDUALE TË GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE ME TË ASHTUQUAJTURAT SKEMAT “DERË-MË-DERË”, TË CILAT GJEJNË SHUMË PAK APLIKIM NË BASHKINË SHIJAK DHE KARAKTERIZOHEN NGA NJË KOSTO E LARTË KAPITALE DHE OPERATIVE. POR KJO METODË KA NJË SËRË AVANTAZHESH SI:
 - rritja e performancës së shërbimit duke larguar mbetjet nga hapësirat publike, eliminimi i PGM-ve dhe për pasojë shmangia e mbingarkesës së këtyre pikave të grumbullimit;
 - ofrimi i një shërbimi sa më pranë konsumatorëve duke i bërë ata më të ndërgjegjshëm dhe më aktivë në shërbimet vendore të mbledhjes së mbetjeve;
 - mundësi i shërbimit më të mirë për zonat e mbetjeve ku nuk ka hapësirë të mjaftueshme për PGM;
 - ofrimi i një shërbimi të personalizuar, efikas dhe efektiv, për konsumatorët e mëdhenj, ku gjenerimi i tyre ditor tejkalon normat e pranuar për shërbimin e përbashkët; kjo mundëson edhe lehtësimin dhe mos tejmbushjen e pikave të përbashkëta PGM;
 - ofrimi i një shërbimi të personalizuar për konsumatorët e mëdhenj duke respektuar parimin e “paguaj për sa prodhon”;
 - ofrimi i një shërbimi efektiv dhe efikas për zonat e largëta (duke aplikuar shërbime javore ose më të rralla);
 - dhe më kryesorja ofrimi i një mundësie të mirë për aplikimin e skemave të sukseshme për ndarjen e mbetjeve;



Figura 20: Tabela Informuese në zonën pilot

Qëllimi i pilotimit për ndarjen në burim të mbetjeve: Do të ndihmojë jo vetëm për mbajtjen më pastër të bashkisë, por dhe në zbatimin e objektivit kombëtar për menaxhimin e mbetjeve për riciklimin 30% të mbetjeve deri në vitin 2018.

Pra thjesht, skema e menaxhimit të diferencuar të mbetjeve në zonën pilot do të jetë si më poshtë:




Figura 21: Skema e mbledhjes së diferencuar të mbetjeve në zonën pilot

Zona pilot do të veçojë disa kontenierë të veçantë me logo për grumbullimin kryesisht të mbetjeve të riciklueshme (letër, plasticë, qelq, metal). Pjesa tjetër e mbetjeve të kësaj zone do të depozitohen në pikat publike të grumbullimit të mbetjeve.

Do të ketë një bashkëpunim ndërmjet firmës kryesore të kontraktuar të menaxhimit të mbetjeve dhe kompanive ricikluese për organizimin e mbledhjes së pastër të kësaj kategorie mbetjesh. Edhe angazhimi i komunitetit egjiptian do të jetë një mundësi e mirë për mbledhjen e mbetjeve që riciklohen.

Zona e projektit pilot shtrihet në qendër të qytetit dhe ka një përbërje interesante që pasqyron njëkohësisht dhe përbërjen e NjA Shijak. Zona ka 9 pallate 4 katëshe (ku katet e para janë dyqane dhe biznese dhe rreth 60 banesa private. Nga një përlllogaritje e shpejtë i bie që në

zonën në fjalë të banojnë rreth 114 familje ose 400 banorë dhe rreth 50 biznese të vogla e pika shitje. Ndërkohë brenda në zonë gjendet dhe kopshti i fëmijëve.

Eshtë menduar që të vendosen 3 qendra ndarje mbetjesh ne tre pika të ndryshme duke mbuluar të gjithë territorin e zones pilot. Koshat do të jenë plastikë, të madhësisë 240 litra dhe me ngjyrë të verdhe, jeshile e blu. Në secilin prej tyre do të grumbullohet plastika, letra/kartoni dhe qelq/kanaçe. Pranë secilit pre tyre janë dhe kontenierët publik të bashkisë ku qytetarët dhe bizneset të kenë mundësi të hedhin mbetjet mikse. Të gjitha familjet dhe bizneset do të njoftohen derë më derë mbi vendosjen e pikes së grumbullimit të ndarë të mbetjeve nga grupi i të rinjve (pjesë e grupit ekologjik të gjimnazit të qytetit). Atyre do tu shpërndahen dhe fletë informative mbi rëndësinë e ndarjes në burim të mbetjeve dhe sidomos mbi rrymat që do të mblidhen në zonën e tyre. Pjesë e paketës së ndërgjegjësimit do të jetë dhe shpërndarja e qeseve me ngjyra të ndryshme për të ndihmuar qytetarët në ndryshimin e sjelljes dhe krijimin e shembujve pozitiv të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Zona e projektit pilot do të shënojë një ndryshim cilësor jo vetëm sepse është një zone e vjetër e qytetit, por edhe për shkak të investimeve të vazhdueshme të bashkisë Shijak në fushën e menaxhimit të mbetjeve (vendosja së fundmi dhe e koshave të vegjël buzë shëtitorës së qytetit).

Firma që merret me pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve në Shijak do të jetë përgjegjëse për tërheqjen e veçuar të mbetjeve në një frekuencë në varësi të mbetjeve që do të grumbullohen. Javët e para do të monitorohen edhe kontenierët për të përcaktuar dhe strategjinë e informim komunikimit me qytetarët dhe bizneset e zonës. Firma do ti tërheqë mbetjet me kamionë të vecantë dhe do ti grumbullojë përkohësisht në një pjesë të parkingut të makinave derisa të zgjidhë dhe marrëveshjen me firma ricikluese vendase. Kjo do të jetë dhe një testim përpara se të përgatitet kontrata e ardhshme e pastrimit për një periudhë 5 vjeçare dhe ku do të përcaktohen më saktësisht detyrat për arritjen e synimeve dhe objektivave për riciklimin në vitet e ardhshme.

Në fund të vitit 2017 pritet që banorët e zonës pilot të jenë ndërgjegjësuar dhe ndajnë mbetjet në burim në cilësi të lartë. Ndaj për gjithë 2017 pritet që për zonën në fjalë pritet të gjenerohen rreth 166 ton mbetje (duke marrë në konsideratë që për Shijakun koeficienti për gjenerimin e mbetjeve është 0.9 kg/banoë/dit). Sipas përqindjes së përcaktuar dhe më lart pritet që do të diferencohen rreth 18 ton letër dhe karton, 17 ton plastikë dhe 1.2 ton qelq dhe metale. Ndërkohë që firma e pastrimit do të punësojë banorë të zonës që janë në skemën e asistencës sociale për të ndihmuar në procesin e monitorimit të ndarjes në burim të mbetjeve dhe sidomos në një ndarje edhe më cilësore të tyre pasi të grumbullohen në territorin e parkimit të automjeteve të firmës.

Politikat për Administrimin e diferencuar të mbetjeve

Deri në fund të vitit 2017 konsolidohet skema e ndarjes në burim të mbetjeve në zonën pilot;

- Deri në fund të vitit 2018 Bashkia Shijak synon të shtrijë skemën e ndarjes në burim të mbetjeve në të gjithë qytetin e Shijakut;
- Deri në fund të 2021 Bashkia do të ketë përcaktuar vendin e grumbullimit të materialeve voluminoze dhe do t'u kërkojë qytetarëve t'i cojnë vetë në këtë vend, ose një here në vit të nxirren (sipas një grafiku të përcaktuar) në hapësirën përreth kontenierit dhe më pas ato të tërhiqen nga firma e pastrimit.

Objektivat për rezultat

- Ulja me 1% e sasisë së mbetjeve që grumbullohen në qytetin e Shijakut si rezultat i ndarjes së diferencuar të mbetjeve (letër, karton, plastikë, qelq dhe kanaçe) në zonën pilot, në fund të 2017;
- Ulja me 20% e sasisë së mbetjeve që grumbullohen në qytetin e Shijakut si rezultat i ndarjes së diferencuar të mbetjeve (letër, karton, plastikë, qelq dhe kanaçe) që në fund të 2018

Objektivat për produkt

- Në vitin e parë 2017, do të përdoren për qëllim riciklimi rreth 36.2 ton mbetje në vit (18 ton letër, 17 ton plastikë dhe 1.2 ton (qelq dhe kanaçe);
- Në 5 vite e ardhshme do të ulet sasia e mbetjeve, nga qyteti i Shijakut, që shkojnë në landfill si rezultat i ndarjes së diferencuar të mbetjeve në shifrën 204 ton në vit;

V. PERSPEKTIVA FINANCIARE

5.1. ÇËSHTJA E FINANCIMIT DHE STRATEGJIA E “MBULIMIT TË KOSTOS”

Investimet kapitale

Sipas vlerësimit paraprak të prezantuar më lart, investimet kapitale duhet të rriten në mënyrë progresive në 5 vitet e ardhshme sipas nevojave për përmirësimin dhe modernizimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve. Investimet do të kërkohen të mbulojnë nga burimet financiare vendore (nga të ardhurat e vetë bashkisë) të kombinuara me programet e huaja të donatorëve që janë të pranishëm në rajon (p.sh., Programi DLDP) për pajisje dhe makineri, si dhe nga burimet kombëtare, nga donatorët e huaj dhe bankat e zhvillimit, sektori privat apo kombinimi i tyre për investimet e tjera.

Strategjia e mbulimit të kostos dhe niveli i tarifave

Sipas legjislacionit ekzistues, autoritetet vendore kanë përgjegjësinë të kontrollojnë caktimin dhe përshtatjen e tarifave të mbetjeve në përputhje me politikat e tarifave të përcaktuara nga këshilli bashkiak dhe të bazuara në principet e mëposhtme:

- Parimin “kush ndot paguan”
- Rakordimin me buxhetin vjetor
- Prioritetet lokale dhe politike
- Mundësia e pagesës

Shqyrtimi paraprak i strukturës aktuale financiare të sektorit të menaxhimit të mbetjeve në Bashki tregon se ajo nuk ka një performancë të mirë në realizimin e të ardhurave nga mbetjet duke mbuluar deri 74% të shpenzimeve aktuale për shërbimet e pastrimit dhe largimit të mbetjeve, por edhe buxheti aktual është i pamjaftueshëm për modernizimin e shërbimeve të pastrimit dhe përmbushjen e standarteve kombëtare për depozitimin mjedisor të mbetjeve.

Gjithashtu vihet re dhe një planifikim me rezerva i të ardhurave, sepse në vitin 2015 të ardhurat realizohen 109%, por familjet realizojnë vetëm 74% të planit dhe NjA Gjepalaj dhe NjA Shijak, realizojnë përkatësisht vetëm 13% dhe 68% të të ardhurave të planifikuara.

Baza e përmirësimit të mëtejshëm të sistemit aktual të tarifave dhe të të ardhurave nga mbetjet duhet të mbështet në parimin “ndotësi paguan” apo mbi “përgjegjësia e prodhuesit të mbetjeve” si dhe në elasticitetin e sistemit në mbështetje të iniciativave për minimizimin e mbetjeve. Qëllimi i bashkisë është të zbatojë sistemin e mbulimit të kostos që lidhet me

objektivat e saj. Prandaj, nëse bashkia synon të përmbushë objektivin menjëherë, plani rekomandon rritjen e nivelit të tarifave në mënyrë progresive drejt mbulimit të kostos operative, kostos së mirëmbajtjes dhe amortizimit si dhe duke përdorur subvencione apo të ardhura të tjera të bashkisë për të mbështetur kostot administrative.

Ngritja e strategjisë për mbulimin e kostos fillon nga llogaritja totale e kostos, ku të gjitha kostot që lidhen me komponentët e sistemit të administrimit të mbetjeve në 5 vitet e ardhshme evidentohen dhe përmbledhen në tabelën e mëposhtme.

| Kosto e Aktiviteteve te Kostos (lekë) | KOSTO OPERACIONALE v.2017-2021 (Lekë) | | | | | |
|---------------------------------------|---------------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| | v.2016 | v.2017 | v.2018 | v.2019 | v.2020 | v.2021 |
| KOSTO OPERACIONALE | 32,237,000 | 33,763,105 | 34,500,408 | 34,843,589 | 35,124,663 | 35,578,595 |
| Kosto operacionale/ banor | 954 | 994 | 1,011 | 1,016 | 1,019 | 1,028 |
| KOSTO KAPIALE | - | 19,085,000 | 35,000 | 70,000 | 35,000 | 35,000 |
| TOTALI I KOSTOS | 32,237,000 | 52,848,105 | 34,535,408 | 34,913,589 | 35,159,663 | 35,613,595 |
| Nga kjo: Dldp | | 11,521,300 | | | | |
| TOTALI I KOSTOS SË BASHKISË | 32,237,000 | 41,326,805 | 34,535,408 | 34,913,589 | 35,159,663 | 35,613,595 |

Tabela 43 "Përmbledhje e evidentimit të kostove, 2011-2015"³¹

Ndarja e kostove sipas normës së prodhimit të mbetjeve

Parimi "ndotësi paguan" nënkupton që gjeneruesit e mbetjeve duhet të paguajnë koston e plotë të administrimit të mbetjeve të tyre. Duke marrë parasysh këtë parim, kostoja duhet të

³¹ Skenari i grumbullimit dhe transportit miks të mbetjeve dhe përdorimi i landfillit të Porto Romanos deri në vitin 2021.

ndahet në përputhje me prodhimin e mbetjeve për konsumatorët dhe të mbulohet nga vetë konsumatorët.

Fillimisht, tabela e mëposhtme ilustron mënyrën se si ndahen kostot mes konsumatorëve në bazë të prodhimit të mbetjeve për vitin 2017.

| Gjeneruesit e mbetjeve | Sipas sasisë së gjenerimit | | % Rekomanduar për të reduktuar peshën e familjeve | Politika |
|-------------------------------|----------------------------|-----|---|--------------|
| | Ton | % | | |
| Familjet e korrigjuara | 7,300 | 75% | 65% | - 10% |
| Bizneset e vogla | 1,397 | 14% | 17% | +3% |
| Bizneset e mëdha | 1,035 | 10% | 17% | +7% |
| Institucionet | 134 | 1% | 1% | 0% |

Tabela 44 Ndarja e kostos mes konsumatorëve në bazë të prodhimit të mbetjeve

Njëkohësisht, ndërsa zbatimi rigoroz i principit që konsumatori paguan për çfarë përfiton apo sa mbetje gjeneron, mund të kërkojë nivele të larta të tarifave për familjet dhe rrjedhimisht një stepje të tyre për të paguar. Për të minimizuar këtë problem, rekomandohet që bashkia të subvencionojnë pjesën kapitale dhe administrative të shpenzimeve për konsumatorët familjarë, duke iu alokuar këtyre vetëm koston operative të shërbimeve të pastrimit. Prandaj, duke marrë në konsideratë përcaktimet dhe rekomandimet e mësipërme, kostoja totale për shërbimet e pastrimit dhe mbledhjes së mbetjeve ndahet mes konsumatorëve familjarë, bizneseve dhe institucioneve realizohet si më poshtë:

Skenari i mbulimit të koston së plotë, duke përfshirë edhe atë kapitale³²:

| Tarifë Familjare - Kosto operative + Kosto Kapitale | | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
|---|--|------------|------------|------------|------------|------------|
| 1.1 | Nr. familjeve | 9,218 | 9,264 | 9,310 | 9,357 | 9,403 |
| 1.2 | Pjesa e Kostove operative -familjet korrigjuara | 21,946,018 | 22,425,265 | 22,648,333 | 22,831,031 | 23,126,087 |

³² Per efekt te politikave te tarifave, nga kosto totale e shërbimit është shmangur financimi kapital i Dldp për blerje 237 konteniere.

| | | | | | | |
|------------|--|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| 1.3 | Tarifë Vjetore familjeve përhershme | 1,716 | 1,740 | 2,494 | 2,523 | 2,410 |
|------------|--|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|

Tabela 45 Ndarja e kostos dhe niveli paraprak për familjet

| Tarifë për Bizneset - Kosto operative | | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
|--|---|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| 2.1 | Nr. i bizneseve BV | 638 | 638 | 638 | 638 | 638 |
| 2.2 | Pjesa e kostove operative +kapitale (BV) | 5,739,728 | 5,865,069 | 5,923,410 | 5,971,193 | 6,048,361 |
| 2.3 | Tarifë vjetore (BV) | 8,996 | 9,193 | 9,284 | 9,359 | 9,480 |
| 3.1 | Nr. i bizneseve BM | 189 | 189 | 189 | 189 | 189 |
| 3.2 | Pjesa e kostove operative +kapitale (BM) | 5,739,728 | 5,865,069 | 5,923,410 | 5,971,193 | 6,048,361 |
| 3.3 | Tarifë vjetore (BM) | 30,369 | 31,032 | 31,341 | 31,594 | 32,002 |
| 4.1 | Nr. i institucioneve | 61 | 61 | 61 | 61 | 61 |
| 4.2 | Pjesa e kostove operative +kapitale institucione | 337,631 | 345,004 | 348,436 | 351,247 | 355,786 |
| 4.3 | Tarifë vjetore (institucione) | 5,535 | 5,656 | 5,712 | 5,758 | 5,833 |

Tabela 46 Ndarja e kostos dhe niveli paraprak për bizneset dhe institucionet

Politika vendore dhe planifikimi i mbetjeve

Mbledhja e mbetjeve urbane, pastrimi i rrugëve, etj, konsiderohen shërbime publike në shërbim të të gjithë qytetit nga i cili është e vështirë të përjashtojmë pa krijuar probleme urbane, mjedisore, por njëkohësisht është një shërbim me kosto të konsiderueshme për të cilën të gjithë që përfitojnë duhet të paguajnë.

Për të mundësuar një parashikim dhe strategji reale të llogaritjes së të ardhurave për periudhën 5-vjeçare, rekomandohet që bashkia të marrë në konsideratë faktorë të tjerë socialë³³ (si psh. pamundësia e disa familjeve për të paguar), apo eksperiencia dhe performanca aktuale e bashkisë për të mbledhur të ardhurat (që lidhet me nivelin aktual të pagesës së tarifave nga konsumatorët si dhe performancën aktuale të bashkisë për mbledhjen e të ardhurave). Identifikimi dhe vlerësimi i këtyre faktorëve ndihmojnë bashkinë të orientojë veprimet dhe strategjitë për modernizimin e mëtejshëm të sistemit fiskal të mbetjeve. Analiza e mëposhtme merr parasysh këta faktorë shoqërorë si dhe performancën e mëparshme të bashkisë në vjeljen e tarifave kur parashikohen të ardhurat për vitet e ardhshme.

| | | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
|-----|---|------------|------------|------------|------------|------------|
| 1 | 100% Tarifave të familjeve të përhershme | 21,946,018 | 22,425,265 | 22,648,333 | 22,831,031 | 23,126,087 |
| 1.1 | Përqindja e Konsumatorëve që janë në gjëndje të Paguajnë | 100% | 100% | 100% | 100% | 100% |
| 1.2 | Të ardhurat e planifikuara | 21,946,018 | 22,425,265 | 22,648,333 | 22,831,031 | 23,126,087 |
| 1.3 | Përqindja e konsumatorëve që do të paguajnë | 50% | 60% | 70% | 90% | 100% |
| 1.4 | Të ardhurat e planifikuara për tu mbledhura | 10,973,009 | 13,455,159 | 15,853,833 | 20,547,928 | 23,126,087 |

| | | | | | | |
|-----|---|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| 2 | 100% Tarifave të Biznesit BM+BV +ambulante | | | | | |
| 2.1 | Përqindja që janë në gjëndje të paguajnë. | 100% | 100% | 100% | 100% | 100% |
| 2.2 | Të ardhurat e planifikuara | 2,729,472Lek | 2,774,891Lek | 3,989,200Lek | 4,048,638Lek | 3,878,140Lek |
| 2.3 | Niveli i planifikuar i mbledhjes | 80% | 90% | 100% | 100% | 100% |
| 2.4 | Të ardhurat e planifikuara për tu mbledhur | 2,320,051Lek | 2,497,402Lek | 3,989,200Lek | 4,048,638Lek | 3,878,140Lek |

| | | | | | | |
|---|--|--|--|--|--|--|
| 3 | 100% Tarifave të institucioneve | | | | | |
|---|--|--|--|--|--|--|

³³ Në fakt sot bashkia aplikon një tarifë të reduktuar për familjet me ndihmë ekonomike

| | | | | | | |
|-----|---|------|------|------|------|------|
| 3.1 | Përqindja që janë në gjëndje të paguajnë | 100% | 100% | 100% | 100% | 100% |
| 3.2 | Të ardhurat e planifikuara | | | | | |
| 3.3 | Niveli i planifikuar i mbledhjes | 70% | 80% | 90% | 100% | 100% |
| 3.4 | Të ardhurat e planifikuara për tu mbledhur | | | | | |

Tabela 47 Analizë e përmbledhur e planifikimit të të ardhurave

Për të vlerësuar efektivitetin e sistemit drejt arritjes së objektivave të mbulimit të kostos, të ardhurat e planifikuara për secilin konsumator përmbledhen së bashku dhe krahasohen me koston totale operative kapitale. Në rastin tonë, përqindjet e mbulimit të kostos për vitet në vazhdim paraqitet e lartë dhe në progres drejt mbulimit të plotë në vitin 2021, nëse analiza nuk i kthehet rivlerësimit të nivelit të tarifave apo nëse politika vendore nuk subvencionon tarifat.

VI. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

6.1 RREGULLORJA VENDORE

Në plotësim të kuadrit ligjor të administrimit të mbetjeve, Bashkia Shijak duhet të përgatisë dhe miratojë rregulloren e vet lokale, ku të përcaktojë qartë rolin dhe përgjegjësitë e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve, për të siguruar administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të vet administrativ.

Ky dokument duhet të përcaktojë rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbetjeve dhe pastrimit e qytetit duke saktësuar rregullat, teknikat e metodat e administrimit të tyre në çdo fazë të këtij administrimi, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Rregullorja duhet të jetë në përputhje me pjesën më të madhe të Direktivave të BE për Mbetjet dhe legjislacionin Shqiptar në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.

Qëllimi i rregullores është mbajtja pastër dhe siguri i një mjedisi të shëndetshëm për banorët e bashkisë.

Duke detajuar të drejtat dhe detyrat e të gjithë palëve që marrin pjesë në procesin e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane, rregullorja do të lehtësojë zbatimin e kërkesave të legjislacionit të kësaj fushe dhe të mundësojë një kontroll efektiv e të vazhdueshëm në zbatimin e tyre.

Më konkretisht kjo rregullore duhet të përfshijë:

a) Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, procedurat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve;

b) Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve, si:

- Të mos dëmtohen kontenierët, të mos ndryshohet destinacionit i tyre, të mos dëmtohet dhe ndryshohet destinacionit i pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
- Të mos depozitohen mbetjet, të mos digjen mbetjet në kazanë, të mos hidhen mbetjet në rrymat ujore dhe kanalizimet, të mos hidhen mbetjet në territore publike;
- Të shmangët dhe parandalohet hedhja abuzive e mbetjeve voluminoze dhe atyre të rrezikshme, të mos depozitohen kafshët e ngordhura dhe materialet helmuese;
- Të shmangët parkimi i automjeteve përballë apo pranë pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
- Të pastrohet hapësira rreth dyqaneve dhe pikave ambulate të shitjes; të mbahet higjienë dhe të dezinfektohen kontenierët dhe koshat e hedhurinave;
- Të paguhën taksat dhe tarifat vendore për mbetjet;

- Çështje të tjera të shëndetit publik.

c) Të drejtat dhe detyrimet e administruesve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve) si:

- Proçedurat administrative për dhënien dhe heqjen e licencave;
- Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor;
- Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
- Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit;
- Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi;
- Mbajtja e të dhënave për mbetjet;
- Parandalimi i problemeve për shëndetin publik;
- Çështje të tjera të shëndetit publik, të tilla si procedurat e shëndetit, sigurisë dhe urgjencës;
-

Synimi i rregullores duhet të përfshijë të gjitha organizatat qendrore e lokale me seli në territorin e bashkisë, të gjithë individët, të gjithë operatorët socio-ekonomikë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë territor, si edhe të gjithë operatorët publikë e privatë, vendas e të huaj të angazhuar në aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve urbane (grumbullimi, depozitimi, transportimi, ndarja, riciklimi, trajtimi dhe asgjësimi). Rregullorja duhet të përfshijë edhe një seksion për marrëdhëniet me publikun, aktivitetet e ndaluara, sanksionet dhe masat ndëshkimore.

Një nga rregullat synuese më të rëndësishme që duhet përcaktuar në rregullore është grumbullimi i diferencuar dhe trajtimi i mbetjeve në të gjitha fazat e menaxhimit të tyre, si edhe ndalimi i përzierjes së tyre me mbetjet e rrezikshme.

6.2 DETYRIMI DHE SANKSIONET

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve duhet të parashikojë dhe sanksionojë një listë sa më gjithëpërfshirëse ndalimesh dhe detyrimesh. Në këtë listë mund të përfshihen ndalimet dhe detyrimet si më poshtë:

- është e ndaluar hedhja, derdhja dhe depozitimi në hapësirat publike, në të gjithë territorin e bashkisë, në tregjet publike të hapura apo të mbuluara, çdo lloj mbetje, papastërti, hedhurinë e ngurta, gjysëm e ngurta, e lëngët dhe në përgjithësi materiale mbetjesh dhe hedhurinash të çdo lloji, natyre dhe dimensionit, edhe pse e mbyllur me qese. Ky ndalim është në fuqi për sipërfaqet ujore, lumenjt, kanalet, burimet e ujit, gropat, brigjet, anët e rrugëve, etj.
- është e ndaluar dorëzimi i mbeturinave në vendet e zbuluara të hapësirave private, në trojet e sheshet, prona të rikthyera, të rrethuara ose jo, në të cilat nuk ka filluar ndonjë

veprimtari ndërtimore apo e çdo natyre tjetër. Pronarët e tyre janë të detyruar të kujdesen për mbajtjen pastër të tyre dhe të mos lejojnë kthimin e tyre në vende të depozitimit të mbeturinave.

- cilido shkel ndalimet e përmendura më sipër është i detyruar të kryej largimin e mbetjeve. Ky veprim duhet të kryhet nga pronari apo personi me të drejta të deleguara mbi hapësirën e ndotur. Kryetari i bashkisë cakton nëpërmjet një urdhërese, operacionet e nevojshme dhe afatet brenda të cilave duhet të veprohet, si dhe periudhën kohore për shlyerjen e dëmit monetar;
- në rastet e shërbimit të grumbullimit “derë më derë” është i ndaluar ekspozimi i qeseve dhe/ose kontenierëve shtëpiak që kanë mbetje, përgjatë rrugës së grumbullimit, në ditë të ndryshme dhe jashtë orareve të përcaktuara nga Bashkia;
- është e ndaluar hedhja në kontenierë apo në pajisjet e përdorura për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, të mbetjeve të lëngta, me qese të zgjidhura apo të palidhura mirë, të substancave të ngrohta apo ndezëse, për më tepër mbetje të forta që mund të dëmtojnë kontenierin ose përbëjnë rrezik;
- është e ndaluar hedhja e mbetjeve të ndryshme nga ato për të cilat janë vendosur kontenierët ose është caktuar shërbimi i grumbullimit;
- është i ndaluar dorëzimi i mbetjeve voluminoze që nuk janë reduktuar më parë, si për nga dimensionimi, përbërja dhe karakteristika të tjera që mund t’i shkaktojnë dëmtime kontenierit ose mjeteve të grumbullimit, për më tepër mund të shkaktojnë rreziqe për qytetarët apo personat përgjegjës për shërbimin;
- është e detyrueshme për të gjithë llojet e prodhuesve dhe mbajtësve të mbetjeve urbane, objekt i grumbullimit të ndarë me qëllim rekuperimin e materialeve dhe energjisë, të dorëzojnë këto materiale në përputhje me mënyrat e caktuara në shërbimet respektive;
- është i ndaluar spostimi i kontenierëve apo pikave të grumbullimit, pajisjeve të përdorura për shërbimin e grumbullimit, dëmtimi apo pëmbysja,
- janë të ndaluara sjelljet që shkaktojnë pengesa apo vonesa në kryerjen e shërbimit, duke përfshirë edhe parkimin e mjeteve pranë kontenierëve apo në hapësirat e manovrimit të mjeteve për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve apo shërbimit të fshirjes;
- është e ndaluar hedhja e mbetjeve të vogla në hapësira publike apo për përdorim publik (lëkura frutash, letra apo copa letrash, cigare, kuti, shishe dhe të ngjashme);
- është i ndaluar dorëzimi, tek shërbimi i grumbullimit, i kafshëve të ngordhura;
- është i ndaluar dorëzimi tek shërbimi i grumbullimit të mbetjeve speciale për të cilat nuk është lidhur një marrëveshje e përshtatshme;
- djegia e mbeturinave në kontenierë, rreth tyre dhe në çdo ambient tjetër, është kategorikisht e ndaluar dhe ndëshkohet si shkelje e rëndë sepse gazrat e tymrat e djegies rrezikojnë shëndetin e njeriut.

- ndalohet kullotja e kafshëve barngrënëse në mbeturinat e kontenierëve e në pikat e grumbullimit të tyre.
- nuk pranohet e drejta për kërkuar përjashtimin nga shërbimi i zakonshëm pa miratimin e bashkisë.

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve të shoqërohet me një sërë gjobash dhe sanksione që duhet të caktohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin “ndotësi paguan” ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbetjeve, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijojë një sistem të drejtë dhe të shkurajojë dhe parandalojë ndotësit.

Gjobat lokale duhet të vendosen nga inspektorët bashkiakë që janë nën juridiksionin e bashkisë. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbetjeve lokale (Neni 61, 62 i Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve), sipas rregullores së ardhshme të administrimit të mbetjeve dhe listës së gjobave dhe shkeljeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

6.3 LIÇENCIMI MJEDISOR

Një element i domosdoshëm i menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve në Shqipëri, në të ardhmen, është përputhshmëria me ligjin. Legjislacioni Shqiptar mbi mbetjet vjen kryesisht nga Direktivat e Bashkimit Evropian – Kuadri Udhëzues për mbetjet i vitit 2008 dhe direktiva të tjera të ndryshme përfshirë, në veçanti Direktivën e Landfilleve të vitit 1999.

Çështjet që duhen patur parasysh lidhur me menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve në Bashkinë Shijak përfshijnë (lista nuk është shteruese): Kontrollin e Ndikimeve Mjedisore të Menaxhimit të Mbetjeve, Planifikimin e Përdorimit të Tokës, Zhvillimin e Tregut të Riciklimit, etj.

Zbatimi me sukses i kuadrit ligjor vendor do të kërkojë përmirësime në sistemin e licencimit mjedisor, i cili përbën mekanizmin kryesor të kontrollit. Sipas legjislacionit kombëtar:

- (i) Bashkitë duhet të bashkëpunojnë me ARM (Agjencia Rajonale e Mjedisit) kur japim miratime për aktivitete që ushtrojnë veprimtari apo projekte për administrimin e mbetjeve (Neni 25 i ligjit për Administrimin e Mbetjeve të Ngurta)
- (ii) Të japin miratimin për vendet e depozitimit të mbetjeve të rrezikshme për qëllime të marrjes së lejeve mjedisore (Neni 13 i Ligjit për Mbetjet e Rrezikshme)

- (iii) Të kontrollojnë vazhdimisht përmbushjen e detyrimeve ligjore në veprimtaritë e administrimit të mbetjeve (përfshirë jo vetëm mbetjet urbane por edhe mbetje ndërtimore dhe të tjera jo-urbane). Në këtë aspekt, ajo duhet të marrë herë pas here raporte nga personat e përfshirë në këto veprimtari.
- (iv) Të shikohet mundësia për një mekanizëm kontrolli jo vetëm për shërbimin e pastrimit nga vetë Bashkia, por edhe nga të tretë (auditues të pavarur) apo dhe kur të bëhen vlerësime për ndonjë vendepozitim lokal, apo rehabilitim hotspoti.
- (v) Të stimulohen bizneset për t'u certifikuar me standartet e sistemeve të menaxhimit të mjedisit ISO 14001 të cilat do të rrisin pjesëmarrjen e bizneseve në zinxhirin e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

6.4 PJESËMARRJA E SEKTORIT PRIVAT

Kontraktimi i shërbimeve të largimit të mbetjeve voluminoze, mbetjeve të riciklueshme apo dhënia me koncension i impianteve apo aktiviteteve për trajtimin mbetjeve (përfshirë edhe landfillin e ardhshëm), duhet të shihet si një mundësi për të tërhequr investime nga sektori privat në infrastrukturën e mbetjeve. Përfshirja e sektorit privat me anë të koncesionit apo partneritetit publik-privat duhet të nxitet si një mekanizëm për të ofruar një zgjidhje më të mirë ekonomike dhe që mund të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore.

Duke iu referuar eksperiencës ndërkombëtare dhe në disa raste kombëtare, ekzistojnë një sërë përfitimesh dhe avantazhesh lidhur me përfshirjen e sektorit privat në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, ku disa prej tyre mund të jenë:

- sektori privat zotëron një ekspertizë më të mirë teknike dhe akses më të madh ndaj kapitaleve financiare sesa sektori publik;
- administrata e sektorit privat është më efektive se ajo e sektorit publik;
- aty ku sektori privat mund të realizojë shërbimet me standarde të njëjta apo më të mira dhe me kosto më të ulët për njësi, atëherë dhënia me kontratë e shërbimeve është një mundësi mjaft e mirë për të përmirësuar performancën e përgjithshme të shërbimeve;
- i orientuar drejt fitimit, sektori privat ofron kontroll më të mirë të standarteve operative dhe teknike, etj.

Aktualisht bashkia e realizon pastrimin përmes kontratës me një kompani private. Firma e pastrimit mund të shihet dhe si partner në arritjen e objektivave të riciklimit. Pra mund t'u ngarkohet në kontratën e ardhshme dhe ky detyrim, duke qënë se bashkia vetë nuk mund ta realizojë këtë dhe ka nevojë për buxhet shtesë.

Duke dashur të arrijë përfitimet maksimale nga përfshirja e sektorit privat në aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve, bashkia duhet të ketë në vëmendje rekomandimet e mëposhtme:

- a. **Konkurrenca:** Duhet të sigurojë një konkurrencë të vërtetë mes kompanive të sektorit privat dhe madje, nëse është e mundur, midis kompanive private dhe ndërmarrjeve publike të komercializuara që operojnë në fushën e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane.
- b. **Kërkesa e llogarisë:** për të siguruar se kontrata funksionon: Me qëllim që kontrata me sektorin privat të japë përmirësimet e duhura dhe të matshme në efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimit, duhet të përmbushen një sërë kriteresh bazë:
 - Masat e mirë-përcaktuara të performancës;
 - Sanksione të zbatueshme për punën e dobët;
 - Monitorim vigjilent dhe
 - Kërkesa e llogarisë për kostot.
- c. **Transparenca:** Marrëveshjet financiare dhe marrja e vendimeve duhet të jenë transparente. Arsyet për vendimet, veçanërisht për zgjedhjen e ofruesve të shërbimeve nga sektori privat, si dhe administrimi i fondeve publike duhet të jenë të hapura për publikun;
- d. **Kohëzgjatja e duhur e marrëveshjes dhe ofrimi i pajisjeve:** kontratat që përfshijnë edhe investime në makineri duhet të kenë të paktën një kohëzgjatje prej 5 vjetësh, ndërsa investimet në prona të patundshme kërkojnë të paktën një kohëzgjatje prej 10 vjetësh për marrëveshjet dhe kontratat.

6.5 MBËSHTETJA POLITIKE

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve paraqet sfida reale për të gjitha palët e interesuara për të mbajtur një qasje të koordinuar të menaxhimit të tranzicionit drejt një sistemi modern të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shijak. Në këtë kuadër do të jetë thelbësor komunikimi i vazhdueshëm ndërmjet palëve të interesuara dhe një mënyrë efektive për të vijuar progresin e zbatimit të PVMM.

Menaxhimi i mbetjeve dhe pastërtia duhet të konsiderohen të një rëndësie të veçantë për banorët e bashkisë dhe do të kërkojë një mbështetje dhe inkurajim të fortë nga Këshilli Bashkiak për të arritur objektivat e tij. Në këtë kuadër, nga njëra anë Këshilli Bashkiak duhet të shikojë me prioritet mbështetjen e projekteve, iniciativave lokale për modernizimin e këtij sektori ashtu si masat për përmirësimin e buxhetit, investimet dhe përmirësimin e paketës fiskale, nga ana tjetër bashkia duhet të sigurojë transparencën maksimale ndaj këshillit dhe

publikut. Kjo marrëdhënie reciproke do të mundësojë paanësinë politike për çështjet që lidhen me mjedisin dhe pastërtinë e qytetit.

Bashkia në bashkëpunim me kompaninë e pastrimit duhet të përcaktojë dhe publikojë grafikun për pastrimin e qytetit (çdo ditë, herët në mëngjes ose vonë në mbrëmje), dhe grafikun për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve (gjatë ditës).

Me ndryshimet administrative të territorit, vetëm një supervizore nuk e adreson dot gjithë elementët që kërkon të arrijë ky plan ambicioz për menaxhimin e mbetjeve urbane në 5 vitet e ardhshme. Ndaj rishikimi i strukturës duhet të jetë prioritet për bashkinë që të sigurojë një shërbim sa më cilësor. Kjo strukturë, që në rastin e progresit duhet të konceptohet të paktën si sektor për menaxhimin e mbetjeve brenda Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike duhet të përmbajë ne organikë të paktën një staf prej 2 personash (dy ekspertë të fushës). Objektivi kryesor i ketij sektori do të jetë:

- mbulimi me shërbimin e pastrimit të të gjithë territorit,
- mbulimin 100% të kostos nga tarifa,
- rishikimin e kontratave të pastrimit dhe
- monitorimin e vazhdueshëm të PVMMU.

Pra nëse njëri ekspert do të merret me supervizimin dhe monitorimin e kontratës së shërbimit dhe tjetri duhet të merret me kosto tariffën (personalizimin e të dhënave, hedhjen e tyre në sistem, përgatitjen e faturës mbledhjen e saj brenda sektorit që edhe 100% e tariffës të shkojë për mbulimin e kostos).

Nga eksperiencat e aplikuara në disa bashki, përmes asistencës së dldp, mund të adoptohen përshkrimet e punës për të paktën supervizorin dhe një specialist tjetër (shtojca 1).

VII. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Nëse duam që PVMMU të funksionojë dhe zbatohet me sukses në Shijak, është mjaft e rëndësishme që publiku ta kuptojë dhe mbështesë atë në çdo hallkë të tij. Po ashtu, sukcesi i skemave që propozohen, nismave që do të ndërmerren varen tërësisht nga shkalla e angazhimit nga vetë përdoruesit si: familjarët, bizneset, etj.

Menaxhimi i mbetjeve është sa problem teknik dhe kërkon organizim të mirë dhe përdorim të teknologjive moderne, por është dhe problem komunikimi me zbatuesit e saj, qofshin këta banorë, biznese apo institucione publike. Ndërsa incentivat ligjore dhe ato ekonomike mund të ndryshojnë sjelljen e qytetarëve, krijimi i ndërgjegjjes së duhur të publikut dhe dëshira për të menaxhuar sa më mirë mbetjet është po aq e rëndësishme.

Ndërsa në fillim të procesit zhvilluam anketimin me qytetarët vumë re se ata kishin shumë pak informacion në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, perceptim të ulët të përpjekjeve të bashkisë për të ndryshuar situatën dhe përgjigje të ulët në lidhje me pagimin e taksës.

Promovimi i ndërgjegjësimit publik mbi problemet që lidhen me menaxhimin e mbetjeve, dhe inkurajimi i individëve dhe komuniteteve për të marrë më tepër përgjegjësi për mbetjet që ata vetë prodhojnë, është një aspekt i rëndësishëm i informimit qytetar por edhe i mirë artikulluar nga vetë bashkia në Vizionin e PVMMU. Ndaj bashkia duhet të fokusohet në:

- I. **Informimin e publikut mbi shërbimin e ri të menaxhimit të mbetjeve** – duke i mundësuar publikut të bashkëpunojë në mënyrë konstruktive me një skemë të re. Publiku duhet të njoftohet mbi vendet e përcaktuara si VGM, oraret e zbrazjes së kontenerëve, frekuencën e tërheqjes së mbetjeve, standartin e shërbimit të pastrimit. Informacioni duhet të komunikohet në mënyrë të qartë për t'i mundësuar ata të koordinohen me rregullat e shërbimit dhe t'u tregohen dhe mjetet që do të përdoren për mbledhjen e mendimeve dhe ankesave të tyre. Ky proces duhet të përfshijë gjithashtu edhe informacion mbi rregulloren, penalitetet dhe sanksionet, strategjinë e mbulimit të kostos dhe nivelin e tarifës, mbi mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.
- II. **Rritja e ndërgjësimit ndaj praktikave të mira në menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane** – duke nisur nga identifikimi i grupeve të interesit dhe hartimi së bashku me to i programeve për zbatimin e skemave të ndarjes në burim të mbetjeve, riciklimit, apo kompostimit. Në grupet e interesit duhet të përfshihen familjet, bizneset, institucionet, grupet në nevojë, të rinjtë dhe fëmijët si pjesë e grupeve të fokusuar të cilat do të përfitojnë nga shërbimi i pastrimit. Ata do të marrin një rol të rëndësishëm në promovimin, kryerjen dhe zbatimin e fushatës së ndërgjegjësimit publik.

- III. **Edukimi i brezit të ri** përmes një programi të detajuar edukues brenda dhe jashtë ambjentëve të shkollës për të rritur njohuritë e tyre mbi shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe për të inkurajuar minimizimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin. Praktikët apo aksionet konkrete të pastrimit janë një metodë shumë e mirë edukimi duke bashkëpunuar me grupet rinore ekologjike të krijuara rishtas apo dhe me stafet pedagogjike të shkollave.
- IV. **Forcimi dhe rritja e përfshirjes publike dhe biznesit** – duke rritur bashkëpunimin me grupe të ndryshme interesi në sigurimin e mbështetjes publike për iniciativat e menaxhimit të mbetjeve, alternativat e shërbimit, kostot, buxhetin, mobilizimin e publikut dhe grupeve të tjera të interesit në mbështetjen e zbatimit të tyre, futjen e pagesës së rregullt të tarifës duke vlerësuar kërkesën, vullnetin dhe mundësinë e tyre për të paguar. Një çështje e cila ka nevojë të merret në konsideratë, është siguri i angazhimit privat në menaxhimin e mbetjeve urbane, për të krijuar mundësi për krijimin e partneritetit publik-privat (PPP).

Metodat që mund të përdoren

Bashkia Shijak duhet të diversifikojë sa më shumë mjetet e komunikimit që edhe qytetarët të kuptojnë sfidat dhe ecurinë e bashkisë në ofrimin e një shërbimi cilësor dhe në të gjithë territorin. Drejtoritë përkatëse në bashki duhet të promovojnë sipas rastit në bashkëpunim me personat juridik të përfshirë, fushata edukimi dhe informimi drejtuar qytetarëve. Synimi i fushatave duhet të jetë ofrimi i informacionit të përgjithshëm dhe të veçantë për publikun në lidhje me nismat vendore të mbledhjes, riciklimit të mbetjeve, pastërtisë së qytetit, rritja e ndërgjegjësimit qytetar për detyrimet ligjore, rregullat dhe detyrimet vendore dhe nxitja e qëndrimit miqësor ndaj mjedisit.

Metodat më të përdorura të komunikimit të informacionit janë broshurat, artikujt në gazeta me qarkullim kombëtar dhe rajonal, njoftimet, tabelat informuese dhe reklamat në TV dhe radio lokale, dhe fletëpalosje që shpërndahen në shkolla. Duhet të përdoren materiale komunikimi për të ndihmuar banorët të kuptojnë sfidat për administrimin e mbetjeve të komunitetit si dhe përparimin për trajtimin e këtyre sfidave. Po ashtu tabelat e informimit dhe ekrani në qendër të qytetit mund të përdoren për dhënie të mesazheve ndërgjegjësues, informative dhe kontakteve për informim të mëtejshëm apo ankesa. Nga bashkia mund të shpërndahet falas një broshurë me orientime për përdorimin e kontenierëve dhe vendndodhjen e tyre; orientime mbi fraksionet që grumbullohen, udhëzues për dorëzimin e duhur të materialeve të ndryshme sipas fraksioneve, detyrimet dhe detyrat për dorëzimin në mënyrën e duhur të mbetjeve, nevojat dhe pretendimet e bashkëpunimit të qytetarëve, etj.

Metoda e komunikimit *derë më derë* rekomandohet si mjaft efektive për të ftuar qytetarët të bëhen pjesë e nismave të ndryshme, sic është ajo e riciklimit dhe kompostimit, për të përmirësuar qëndrimin e tyre ndaj ndarjes së mbetjeve, për të zbatuar rregullat dhe respektuar oraret por edhe të mbështesin bashkinë në zbatimin e skemave të përzgjedhura. Banorëve dhe bizneseve duhet t'u shpërndahen fletë informative për llojet e mbetjeve që mund të riciklohen, për metodologjinë e kompostimit, etj.

Të përdoren kamionët dhe kontenierët për informim: Tek të gjithë kamionët dhe nëse është e mundur tek kontenierët e mbetjeve duhet të shkruhet qartë dhe lehtësisht e lexueshme (me germa të paktën 10 cm të mëdha) parrulla "Mbani pastër qytetin tuaj " apo ndonjë parullë tjetër, numrin e telefonit të ofruesit të shërbimit si dhe numrin e telefonit falas që caktohet nga autoritetet vendore, sipas një formati të miratuar paraprakisht. Këto detyrime duhen përcaktuar në kontratat e pastrimit.

Në mënyrë periodike mund të kryhet një reklamim në masë të gjërë, nëpërmjet materialeve gjithëpërfshirëse, i rezultateve cilësore dhe sasiore të arritura gjatë viteve paraardhës, në veçanti për grumbullimin në mënyrë të diferencuar të mbetjeve, me qëllim pjesmarrjen aktive të publikut në këtë proces.

Mekanizmat e marrjes së mendimit dhe reagimit qytetar – Autoritetet lokale kanë identifikuar ndërgjegjen e ulët qytetare një nga faktorët kryesorë që ndikojnë negativisht në pastërtinë e qytetit dhe më konkretisht në papastërtinë e disa PGM, (hedhjen pa kriter të mbetjeve urbane dhe voluminoze jashte kontenierëve) si dhe ekzistencën e pikave informale ku hidhen pa kriter mbetje. Për këtë qëllim, ndërgjegjësimi publik ndaj çështjeve të mbetjeve dhe pastërtisë së qytetit, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar krahas objektivave të tjerë që lidhen me infrastrukturën apo me depozitimin e sigurtë të mbetjeve.

Bashkia duhet që përmes njoftimeve publike të ftojë qytetarët të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak edhe kur diskutohen çështje të menaxhimit të mbetjeve. Institucionalizimi i një mekanizmi të tillë do të rrisë besimin tek banorët se bashkia i merr parasysh mendimet, idetë dhe sugjerimet e tyre. Kjo realizohet duke ngritur zyrën e informacionit për të mundësuar marrjen e mendimit nëpërmjet:

- Mbledhjes së ankesave të qytetarëve.
- Sondazheve të herëpashershme si një mjet i mirë monitorimi të shërbimit dhe standarteve që ai ofron. Për secilën zonë të komunitetit apo zonë për t'u përfshirë në sondazh, mostra që duhet të realizohet është midis 250 dhe 300 të intervistuar.

VIII. PLANI AKTIVITETEVE

Vizioni

“BASHKIA SHIJAK SYNON NJË MJEDIS TË PASTËR ME CILËSI TË LARTË NË VAZHDIMËSI, FALË PUNËS DHE KONTRIBUTIT TË PËRBASHKËT TË KOMUNITETIT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE, DUKE SYNUAR NDARJEN NË BURIM NË TË GJITHË TERRITORIN, PËR NJË JETESË TË SHËNDETSHME.”

| Drejtimi Strategjik | Objektivi | Aktivitetet | Rolet Përgjegjëse | Aktor mbështetës | Afatet kohore | Buxheti |
|-------------------------------|---|---|---------------------------|---|---------------|-----------------------------------|
| I. Infrastruktura dhe Mjedisi | 1.1 Përmirësimi i shërbimit të MM duke përdorur teknologji bashkëkohore | 1.1.1 Investimi në kosha dhe makina teknologjike | Bashkia Shijak | Dldp, MiA, Firma e pastrimit | Afat shkurtër | 82.295 EUR 960.000 ALL |
| | | 1.1.2 Sigurimi i një vend depozitimi në nivel bashkie | DPTSHIP | GP i PVMMU, Firma e pastrimit | Afat shkurtër | Planifikim të mëtejshëm ne buxhet |
| | 1.2 Ofrimi i shërbimit cilësor, në kohë dhe në të gjithë territorin | 1.2.1 Konsultim me publikun i PVMMU | Bashkia Shijak | GP i PVMMU, MiA | Afat shkurtër | 400 EUR |
| | | 1.2.2 Miratimi i PVMMU | Këshilli Bashkiak | Kryetari Bashkise, GP i PVMMU, MiA, Dldp, | Afat shkurtër | Pa kosto |
| | | 1.2.3 Krijimi i një ekipi zbatimi dhe monitorimi (EZM) të PVMMU me shtrirje në të 4 njësitë administrative; | Kryetari i Bashkisë | DPTSHIP , GP i PVMMU, MiA | Afat shkurtër | Pa kosto |
| | | 1.2.4 Hartimi i një skeme funksionale të shërbimit të grumbullimit dhe largimit të mbetjeve urbane | EZM dhe Firma e pastrimit | Kryetari Bashkisë, DPTSHIP, MiA, Dldp, | Afat shkurtër | Pa kosto |
| | 1.3 Reduktimi i ndotjes | 1.3.1 Mbyllja dhe pastrimi i | EZM | Kryetari Bashkisë, | Afat | Planifikim të |

| | | | | | | | |
|-------------------------------------|---|---|---|--|---|----------------------|---|
| II. Forcimi Institucion al | dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit | | hotspoteve; | | DPTSHIP, Firma e pastrimit | mesëm | mëtejshëm në buxhet |
| | | 1.3.2 | Reduktimi i venddepozitimeve legale të mbetjeve voluminoze | EZM | Kryetari Bashkisë, DPTSHIP, Firma e pastrimit | Afat mesëm | Planifikim të mëtejshëm në buxhet |
| | | 1.3.3 | Krijimi i zonave rekreative përgjatë Lumit Erzen | EZM | Kryetari Bashkisë DPTSHIP, Këshilli bashkiak, Firma e pastrimit, biznese, donator | Afat mesëm | Kërkon analizim të mëtejshëm |
| | 1.4 Përputhshmëria me objektivat kombëtare duke nxitur minimizimin e mbetjeve në burim | 1.4.1 | Projekte pilot për ndarjen e mbetjeve në burim dhe nxitjen e riciklimit | EZM | Kryetari Bashkisë, DPTSHIP, Firma e pastrimit, biznese, donator | Afat shkurtër /mesëm | 5000 EUR; Planifikim te metejshem ne buxhet |
| | | 1.4.2 | Nisma kompostimi te shoqëruara me trainime teknologjike | EZM | Kryetari Bashkisë, DPTSHIP, Firma e pastrimit, biznese, donator | Afat shkurtër /mesëm | Planifikim të mëtejshëm në buxhet |
| | 1.5 Input ne Planin e Pergjithshem Lokal lidhur me menaxhimin e mbetjeve | 1.5.1 | Pjesëmarrje ne takimet e hapura te organizuara ne kuadër të Planit vendor | EZM | Kryetari Bashkisë, DPTSHIP, Firma e pastrimit, komunitet | Afat shkurter | Pa kosto |
| | | 2.1 Forcimi i kapaciteve të stafit për menaxhimin dhe monitorimin e mbetjeve | 2.1.1 | Trajnime të vazhdueshme të për menaxhimin e mbetjeve (kuadri ligjor) | Kryetari Bashkisë | DPTSHIP, donator | Afat mesëm |
| | 2.1.2 | | Hartimi i përshkrimit të punës të stafit që merret me menaxhimin e mbetjeve | MiA | DPTSHIP, Dldp, EZM | Afat shkurtër | Pa kosto |

| | | | | | | | |
|----------------------------|---|-------|--|-------------------|----------------------------|---------------------------|-----------------------------------|
| III. Ekonomia dhe financat | 2.2 Forcimi i koordinimit ndërinstytucional për një menaxhim të integruar të mbetjeve | 2.1.3 | Përmirësimin e kontratës së shërbimit të pastrimit | MiA, dldp | Dldp, EZM | Afat mesëm/ afat gjatë | Pa kosto |
| | | 2.2.1 | Takime periodike mes njërive administrative dhe institucioneve të tjera për koordinim më të mirë të menaxhimit të mbetjeve | EZM | Kryetari Bashkise, DPTSHIP | Afat mesëm | Pa kosto |
| | | 2.2.2 | Vizita studimore në bashki të tjera për shkëmbim eksperiencash | Kryetari Bashkise | EZM, Donors | Afat mesëm | Planifikim te metejshem ne buxhet |
| | | 2.2.3 | Memo bashkëpunimi (bashki-institucione shtetërore-kombëtare- ndërkombëtare, OJF-grupe interesi) | Kryetari Bashkise | EZM, Donors | Afat mesëm | Pa kosto |
| | 2.3 Forcimi i zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve | 2.3.1 | Hartimi i rregullores për menaxhimin e mbetjeve | MIA | GP i PVMMU | Afat shkurtër | Pa kosto |
| | | 2.3.2 | Hartimi i rregullores së Kosto – Tarifës | MIA | GP i PVMMU | Afat shkurtër | Pa kosto |
| | | 2.3.3 | Hartimi dhe zbatimi i një plani monitorimi për menaxhimin e mbetjeve | MiA | Dldp, GP i PVMMU | Afat mesëm | Pa kosto |
| | 3.1 Forcimi i kuadrit financiar të menaxhimit të mbetjeve (Arritja e mbledhjes së taksës së pastrimit gjatë periudhës 5 vjeçare në masën 80% për të rritur të ardhurat] | 3.1.1 | Hartimi i dokumentacionit standard si marrëveshje, kontrata tip për menaxhimin e mbetjeve (p.sh me firmat e riciklimit për kthimin e mbetjeve në burim të ardhurash) | Kryetari Bashkise | EZM | Afat mesëm | Pa kosto |

| | | | | | | | |
|----------------------------------|---|-------|---|---------------------------------|---|---------------|-----------------------------------|
| IV. Ndërgjegjësimi i komunitetit | 3.2 Krijimi i një sistemi financiar të qëndrueshëm | 3.2.1 | Krijimi i një sistemi të ri të mbledhjes së tarifës | EZM, Drejtoria Ekonomike | Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak, DPTSHIP Ndërmarrja e Ujësjetës | Afat mesëm | Pa kosto |
| | | 3.2.2 | Sistem i ri për ofrimin e shërbimit të pastrimit të ndarë nga shërbimet e tjera komunale | EZM , Drejtoria Ekonomike | Kryetari Bashkise, Keshilli Bashkiak, DPTSHIP | Afat mesëm | Pa kosto |
| | 4.1 Sensibilizimi i komunitit dhe biznesit për t'u bërë pjesë e iniciativave të bashkisë | 4.1.1 | Hartimi i një programi për informimin e qytetarëve (materiale ndërgjegjësuese specifike sipas grupeve të synuara, oraret e grumbullimit të mbetjeve, tarifa e pastrimit, aktivitete, etj) | EZM | MiA dhe dldp | Afat shkurtër | 1800 EUR |
| | | 4.1.2 | Nisma të bashkisë për ndarje në burim (shkollat, bizneset e komuniteti i Shijakut) | EZM | DPTSHIP, Kryetari Bashkise, Klubi rinor mjedisor | Afat shkurtër | Planifikim të mëtejshëm në buxhet |
| | | 4.1.3 | Zhvillimi i orëve të edukimit mjedisor në shkolla | EZM | DPTSHIP | Afat shkurtër | Planifikim të mëtejshëm në buxhet |

| | | | | | | |
|---|-------|--|-----|------------------------------|---------------|-----------------------------------|
| 4.2 Rritja e transparencës dhe e përgjegjshmërisë ndaj komunitetit të Shijakut | 4.1.4 | Organizmi i ditëve të pastrimit me pjesëmarrjen e komunitetit | EZM | DPTSHIP | Afat shkurtër | Planifikim të mëtejshëm në buxhet |
| | 4.2.1 | Ftimi i komunitetit në takimet e këshillit bashkiak dhe bashkisë | EZM | DPTSHIP | Afat mesëm | Pa kosto |
| | 4.2.2 | Emisione në radio e TV | EZM | DPTSHIP | Afat mesëm | Planifikim të mëtejshëm në buxhet |
| | 4.2.3 | Bërja publike në bill board, media sociale të raporteve, kontratave, rregulloreve, etj | EZM | DPTSHIP | Afat mëm | Planifikim të mëtejshëm në buxhet |
| | 4.2.4 | Hartimi i një raporti periodik për menaxhimin e mbetjeve | EZM | DPTSHIP, Drejtoria Ekonomike | Afat mesëm | Pa kosto |

Për Planin e Menaxhimit të mbetjeve urbane për Bashkinë Shijak 2017-2021:

**Afat shkurtër – përfshin periudhën 2017- 2018*

**Afat mesëm – përfshin periudhën 2018 - 2020*

**Afat gjatë – 2020 - 2021*

IX. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE NË BASHKINË SHIJAK.

Është e rëndësishme të monitorohet progresi i PVMMU, efektiviteti i masave që janë marrë dhe të identifikohen nevojat e reja.

Në punën për zbatimin e PVMMU, Kryetari i Bashkisë dhe stafi i tij duhet të mbështeten nga komuniteti dhe aktorët e tjerë institucional.

Koordinator i përgjithshëm për zbatimin e monitorimit duhet të jetë “Drejtoria e planifikimit të territorit shërbimeve dhe infrastrukturës publike” me përfshirjen edhe të anëtarëve të GP për hartimin e tij. Ekipi do të fillojë të punojë menjëherë. Njerëzit e ngarkuar me këtë detyrë duhet të (i) kenë njohuritë e duhura në fushë për të realizuar monitorimin si dhe (ii) në numër të mjaftueshëm për të siguruar që janë matur të gjithë treguesit e monitorimit në të gjithë territorin, që janë përpunuar të dhënat dhe që në fund janë arritur konkluzionet. Ekipi i zbatimit duhet të siguroj informacion të saktë në lidhje me ecurinë e zbatimit të planit me të gjithë elementet e tij nëpërmjet:

- Organizimit të vizitave në terren gjatë orareve të punës sipas grafikut javor përgjatë gjithë vitit.
- Organizimit të takimeve të hapura me grupe qytetarësh.
- Monitorimit të dokumentacionit.

Detyra e parë e këtij ekipi do të jetë hartimi i planit të detajuar të monitorimit, i cili duhet të konsistojë në indikatorët e performancës që vijojnë:

- Indikatorët e performancës mjedisore
- Indikatorët financiarë
- Indikatorët administrativ

Grupi i punës në bazë të informacionit të mbledhur do të raportojë tek Kryetari i Bashkisë mbi ecurinë e planit çdo vit.

Në të njëjtën kohë, të gjitha palëve të interes në menaxhimin e mbetjeve, do t’u ofrohen informacione të rregullta mbi zbatimin e planit dhe fletë informative mbi gjendjen e mjedisit, duke përfshirë edhe një raport vjetor.

SHTOJCA 1

Përshkrimet e punës për specialistët e sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve

Supervizorja:

Roli: Të kontrollojë respektimin e kontratës, verifikimin dhe çertifikimin e faturave dhe propozimin e pagesave të operatorit si dhe gjobat dhe penaltetet kur cilësia dhe sasia e punës nuk janë në termat e përcaktuara në kontratë. Ndërkohë po ky person duhet të organizojë aktivitetet e vlerësimit të shërbimit nga ana e qytetarëve dhe bizneseve, duke bërë të mundur monitorimin në plan të gjerë të këtij aktiviteti sensitiv.

Punon: në zyrën e bashkisë nën përgjegjësinë e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike. Përcakton prioritet dhe bën porosi për nevojat e veçanta që duhet të kryhen nga operatori (inerte, evente, zhvendosje të kontenierëve, etj.) në kuadër të buxhetit.

Harton: statistikën dhe kontrollet e sasive. Verifikon dhe raporton të dhënat e operatorit (mirëmbajtja e kontenierëve, oraret e grumbullimit, rrugët, km, punonjësit, etj.) si edhe të dhënat nga drejtuesit e njësive administrative dhe nga kontrollori që ndodhet në lëndfill.

Raporton në mënyrë të përvajshme dhe të përmuajshme për bashkinë, duke u bazuar tek të dhënat nga njësitë administrative, dhe statistikën. Raportet do të përmbajnë por nuk do të kufizohen në informacionin si më poshtë:

- Sasitë e shërbimeve: kontrollin dhe miratimin e faturave
- Mungesa e cilësisë: mos mbledhja e kontenierëve, vendet e grumbullimit të pa pastruara, kazanët e dëmtuar, mbetjet e depozituara jashtë vend-depozitimit
- Propozime bashkisë për gjobat, kur është e nevojshme, duke u bazuar në kontratën, raportet e njësive administrative/lagjeve dhe statistikën e mbledhura.
- Vendos reduktimin ose zhvendosjen e kontenierave dhe propozon rritje të numrit, nëse është e nevojshme.
- Zhvillon sondazhe dhe anketime me qytetarët dhe bizneset në lidhje me vlerësimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe mbi këtë bazë propozon ndryshimet në strukturat përkatese.

Specialistja e menaxhimit të mbetjeve:

Roli: Të personalizojë dhe krijojë sistemin e të dhënave të abonentëve që marrin shërbimin e pastrimit. Të llogarisë koston dhe të përcaktojë tarifën sipas modelit që do të bëhet i detyruar nga qeveria.

Punon: në zyrën e bashkisë nën përgjegjësinë e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike. Hedh në sistem të dhënat dhe përcakton prioritet.

Përgatit: faturën e shërbimit; bën shpërndarjen e saj në baza vjetore (ose trimestrale) dhe realizon mbledhjen e saj

Raporton: në mënyrë të përmuajshme dhe një vjeçare për bashkinë informacion në lidhje me tarifën e mbledhur;

Harton: propozime për shpenzime të veçanta, dhe ndihmon në përgatitjen e buxhetit vjetor për Bashkinë;

Propozon për politika subvencionimi, kontrata paralele për 3R, analiza dhe sugjerime për të arritur objektivat e menaxhimit të mbetjeve në lidhje me kosto/tarifën, Shpenzime të veçanta jashtë buxhetit (inerte, pika të hapura, etj), Blerjen e kontenierëve të rinj, Modifikimin e buxhetit vjetor.

